



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU"
FAKULTETI I BIZNESIT
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE EKONOMIKE**

**TEMA: DINAMIKA E PRIRJEVE TË TREGTISË SË
SHQIPËRISË ME VENDET E EUROPËS**

Përgatitur nga MSc. Llambi PRENDI

Udhëheqësi: Prof. Dr. Kristaq KUME

Shkurt/2016

Copyright
©
Llambi Prendi
2016

Udhëheqësi i Llambi Prendit vërteton se ky është version i miratuar i disertacionit të mëposhtëm:

DINAMIKA E PRIRJEVE TË TREGTISË SË SHQIPËRISË ME VENDET E EUROPËS.

Prof. Dr. Kristaq KUME

DINAMIKA E PRIRJEVE TË TREGTISË SË SHQIPËRISË ME VENDET E EUROPËS.

Përgatitur nga MSc. Llambi PRENDI

Disertacioni i paraqitur në
Fakultetin e Biznesit
Universiteti “Aleksander Moisiu”, Durrës
Në përputhje të plotë
me kërkesat
për Gradën “Doktor”

Universiteti “Aleksander Moisiu”, Durrës
Shkurt/2016

Dedikim:

Familjes sine....

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Ky punim ka qënë një sfidë për mua, për të përfunduar me sukses përpjekjen time drejt ngritjes akademike. Realizimi i një punimi të tillë kërkon mbështetje dhe inkurajim të vazhdueshëm të miqve dhe kolegëve. Prandaj është kënaqësi të falenderoj disa prej tyre.

Mirënjohja ime e pakursyer dhe shumë e sinqertë shkon për udhëheqësin tim shkencor Prof. Dr. Kristaq Kume. Kam patur fatin të punoj me profesorin i cili më mësoi se cila është shëmbëlltyra e integritetit akademik, profesionalizmit dhe drejtimit shkencor. Këshillat, kritikën, durimin dhe dashamirësinë e tij më kanë nxitur të eci përpara.

Dua të shpreh mirënjohjen time për Prof. Dr. Mit'hat Mema i cili më ka mbështetur në veprimtarinë time akademike. Falenderime për Prof. Dr. Shkëlqim Cani i cili më ka këshilluar në rrugën e formimit tim profesional.

Shpreh falenderimet më të sinqerta për miqtë dhe kolegët e mi të cilët më kanë mbështetur në rrugëtimin tim, e veçanërisht, Prof. As. Dr. Azeta Tartaraj, Prof. As. Dr. Ervin Myftaraj, Dr. Daniel Borakaj, Phd cand. Entela VELAJ dhe Dr. Hysen Hoda që nuk u lodhën kurrë së dëgjuari e diskutuari me mua për pikëpyetjet e punimit.

Falenderoj të gjithë profesorët e shkollës së doktoraturës për njohuritë që na kanë trasmetuar e veçanërisht Prof. As. Dr. Ermira Hoxha, e cila me këshillat e saj më ka ndihmuar në përmirësimin e punimit.

Së fundi dua të falenderoj familjen time, forcen time. Prinderit e mi të cilët më kanë mbështetur pa kursim dhe bashkëshorten time Klarida, e cila më ka qëndruar pranë duke kontribuar me këshillat e saj në këtë punim.

Faleminderit!

Llambi

Deklaratë mbi origjinalitetin

Emri Mbiemri _____

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të shkruajtura nëpërmjet citimeve.

Të gjitha të dhënat, tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë edhe internetin, janë pranuar në mënyrë eksplicite si të tilla.

Jam i vetëdijshëm se në rast të mospërputhjeve, Këshilli i Profesorëve UAMD-së është i ngarkuar të më revokojë gradën “Doktor”, që më është dhënë mbi bazën e kësaj teze, në përputhje me “Rregulloren e programeve të studimit të ciklit të tretë (Doktoratë) të UAMD-së, neni 33, miratuar prej Senatit Akademik të UAMD-së me Vendimin nr. _____, datë _____

Durrës, më _____

Firma _____

PËRMBLEDHJE

Zhvillimet e tregtisë së jashtme përbëjnë një komponent të rëndësishëm të zhvillimeve të përgjithshme ekonomike në tërësi dhe të sektorit të jashtëm në veçanti. Tregtia e jashtme është, veçanërisht, me rëndësi kritike për ekonominë e dimensioneve të vogla si vendi ynë.

Modelet e gravitetit për tregtinë janë shndërruar në modelet më të përdorura për vlerësimin e tregtisë dypalëshe ndërmjet shteteve.

Analiza e këtij materiali bazohet në një model të thjeshtuar të gravitetit, të propozuar nga Kaminski dhe de la Rocha (2003), dhe Frankel, Stein dhe Wei (1997), për të matur flukset tregtare potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe 32 vendeve të Europës (EUR32).

Kuadri i kësaj pune kërkimore bazohet në dy shtylla kryesore: së pari, vlerësimin e modelit bazë të gravitetit të Frankel, Stein dhe Wei (1997) duke marrë në konsideratë edhe variabla të tjerë dhe së dyti, vlerësimin e potencialit të tregut të Shqipërisë me vendet e marra në analizë.

Analiza është bazuar në modelin e gravitetit mbi tregtinë, në formën log-log. Të dhënat janë të organizuara në panel-data, duke përfshirë 32 vende të observuara në 14 vite (periudha 2001-2014).

Pasi analizohen faktorët që ndikojnë në tregtinë dypalëshe të Shqipërisë me vendet e EUR32, vlerësohet tregtia e jashtme me anë të tre metodave dhe me anë të testit hausman zgjidhet metoda më e përshtatshme.

Metoda më të përshtatshme përdoret për të rivlerësuar ekuacionin e gravitetit për tregtinë dhe zbatimi i ekuacionit të rivlerësuar do të lejojë gjenerimin e të dhënave për flukset tregtare potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj EUR32, e cila do të na ndihmojë të japim rekomandime për orientimin e ardhshëm të tregtisë së Shqipërisë.

Fjalë kyçe: Tregtia, modeli i gravitetit, liria ekonomike, importe, eksporte, potenciali i tregut, efekte fikse, efekte rastësore.

SUMMARY

Foreign trade developments constitute a significant component of the overall economic developments in general and particularly that of the external sector. Foreign trade is critically important for small dimension economies like that of our country. Trade gravity models have turned into the most common models to evaluate the bilateral trade among the countries.

The analysis of this material is based on a simplified model of gravity proposed by Kaminski and de la Rocha (2003), and Frankel, Stein and Wei (1997), to measure potential trade flows between Albania and 32 European countries (EUR32).

The framework of this research is based on two pillars: first, the evaluation of the model based on the gravity of Frankel, Stein and Wei (1997), taking into account other variables and secondly, evaluation of the market potential of Albania with the countries taken for analysis.

The analysis is based on the gravity trade model in the log-log form. The data are organized in panel-data, including 32 countries observed in 14 years (period 2001-2014). Having analyzed the factors affecting bilateral trade between Albania and the countries of EUR32, external trade is estimated by the three methods, and through the Hausman test the most appropriate method is selected.

The most appropriate methods used to reevaluate the equation of gravity for trade and the implementation of the reevaluated equation will allow the generation of data for the potential trade flows between Albania and its partners EUR32, which will help us to give recommendations for future orientation of the Albanian trade.

Key words: trade, gravity model, economic freedom, imports, exports, market potential, fixed effects, random effects.

PËRMBAJTJA E LËNDËS:

1. HYRJE.....	1
1.1. SFONDI I STUDIMEVE.....	1
1.2. PROBLEMI I KERKIMIT.....	3
1.3. KONTEKSTI I STUDIMIT.....	4
1.4. QELLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT.....	5
1.4.1. QELLIMI I STUDIMIT.....	5
1.4.2. OBJEKTIVAT E STUDIMIT.....	5
1.5. STRUKTURA E STUDIMIT.....	6
2. LITERATURA E SHQYRTUAR.....	8
2.1. EVOLUCIONI I TEORISE SE TREGTISE.....	8
2.2. DISA PIKEPAMJE MODERNE MBI TREGTINE.....	11
2.3. TEORIA E CIKLIT JETESOR TE PRODUKTIT.....	11
2.4. TEORIA E TREGTISE SE RE.....	12
2.5. KOSTOT E TREGTISE.....	13
2.5.1. FAKTORET QE NDIKOJNE NE KOSTON E TREGTIMIT.....	14
2.5.1.1. DISTANCA.....	14
2.5.1.2. POLITIKAT TREGTARE.....	14
2.5.1.3. RRJETI I LOGJISTIKES.....	15
2.5.1.4. KOSTO TE TJERA.....	16
2.6. MODELI I GRAVITETIT NE TREGTINE DYPALESHE.....	16
2.6.1. ZHVILLIMI HISTORIK.....	17
2.6.2. EKUILIBRI I PERGJITHSHEM.....	18
2.6.3. ZHVILLIMET E FUNDIT TE MODELIT TE GRAVITETIT.....	20
2.6.4. APLIKIMI I MODELIT TE GRAVITETIT.....	20
2.6.5. NDIKIMET E INTEGRIMIT.....	21
2.6.6. NDIKIMET E KURSEVE REALE TE KEMBIMIT.....	21
2.6.7. INFRASTRUKTURA.....	22
2.6.8. TREGTIA DHE RRITJA EKONOMIKE.....	22
2.6.9. TE TJERA.....	22
2.7. STUDIMET E FUNDIT TE TREGTISE SE JASHTME NE SHQIPERI DUKE PERDORUR MODELIN E GRAVITETIT.....	23
2.8. TREGTIA E JASHTME E SHQIPERISE.....	24
2.8.1. VESHTRIM I PERGJITHSHEM.....	24
2.8.2. TREGTIA E MALLRAVE PER PERIUDHEN 2000-2014.....	27
2.8.3. EKSPORTI I MALLRAVE SIPAS VENDEVE KRYESORE.....	29
2.8.4. IMPORTI I MALLRAVE SIPAS VENDEVE KRYESORE.....	30
2.8.5. GRUPMALLRAT ME TE EKSPORTUAR.....	31
2.8.6. GRUPMALLRAT ME TE IMPORTUAR.....	33

3. METODOLOGJIA E NDJEKUR DHE INSTRUMENTAT E PERDORUR.....	36
3.1. TE DHENAT PANEL.....	37
3.2. INEFICENCA	39
3.3. METODAT E VLERESIMIT.....	39
3.3.1. POOLED OLS.....	40
3.3.2. EFEKTET FIKSE.....	41
3.3.3. EFEKTET RASTESORE.....	43
3.4 TESTI HAUSMAN.....	44
3.5 VLERESIMI I POTENCIALIT TE TREGUT.....	45
3.6 METODAT E AVANCUARA TE VLERESIMIT.....	45
3.7 PERSHKRIMI I VARIABLAVE.....	46
3.8 PERFUNDIME	58
4. ANALIZA E REZULTATEVE DHE GJETJET.....	60
4.1. LINEARITETI NE PARAMETRA.....	60
4.2. MULTIKOLINEARITETI.....	63
4.3. HOMOSKEDASTICITETI DHE KORRELACIONI SERIAL NE TE DHENA.....	64
4.4. STACIONARITETI.....	65
4.5. REZULTATET SIPAS TEKNIKES POOL OLS, EFEKTE FIKSE DHE RASTESORE.....	67
4.5.1. METODA POOL OLS.....	67
4.5.2. METODA ME EFEKTE FIKSE.....	71
4.5.3. METODA ME EFEKTE TE RASTIT.....	75
4.6. TESTI HAUSTMAN.....	78
4.6.1. TESTI HAUSMAN PER TREGTINE DHE VLERESIMI I EKUACIONIT TE GRAVITETIT.....	78
4.6.2. TESTI HAUSMAN PER IMPORTET DHE VLERESIMI I EKUACIONIT TE GRAVITETIT.....	80
4.6.3. TESTI HAUSMAN PER EKSPORTET DHE VLERESIMI I EKUACIONIT TE GRAVITETIT.....	81
4.7. ANALIZIMI I POTENCIALEVE TREGTARE ME VENDET PARTNERE.....	83
4.7.1. ANALIZA E GRUPIT TE PARE.....	84
4.7.2. ANALIZA E GRUPIT TE DYTE.....	86
4.7.3. ANALIZA E GRUPIT TE TRETE.....	89
4.8. PERFUNDIME.....	92
5. DISKUTIMI I REZULTATEVE, KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET.....	94
BIBLOGRAFIA.....	100
APENDIKSET.....	104

LISTA E TABELAVE

Tabela 2.1:	Pariteti i fuqisë blerëse për periudhat 2011, 2012 dhe 2013.....	25
Tabela 2.2:	Rritja reale për periudhat 2011, 2012 dhe 2013.....	25
Tabela 2.3:	GDP per fryme për periudhat 2011, 2012 dhe 2013.....	25
Tabela 2.4:	Norma e papunësisë për periudhat 2012 dhe 2013.....	25
Tabela 2.5:	Buxheti për vitin 2013.....	25
Tabela 2.6:	Borxhi publik për periudhat 2012 dhe 2013.....	26
Tabela 2.7:	Inflacioni për periudhat 2011, 2012 dhe 2013.....	26
Tabela 2.8:	Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme në million lekë.....	28
Tabela 2.9:	Partnerët kryesorë të eksporteve shqipëtare për periudhat 2000, 2005, 2010 dhe 2014.....	29
Tabela 2.10:	Partnerët kryesorë të importeve shqipëtare për periudhat 2000, 2004, 2008 dhe 2014.....	31
Tabela 2.11:	Grupmallrat më të eksportuar për periudhat 2000, 2004, 2008 dhe 2013.....	32
Tabela 2.12:	Grupmallrat më të importuar për periudhat 2000, 2004, 2008 dhe 2013.....	34
Tabela 3.1:	Ekstrakt i tabelës së të dhënave.....	38
Tabela 3.2:	Tabela e variablave.....	56
Tabela 4.1,a:	Testimi mbi linearitetin në parametra, (Y3-X3).....	60
Tabela 4.1,b:	Testimi mbi linearitetin në parametra, (Y2-X3).....	61
Tabela 4.2:	Testimi mbi marrdhënien lineare, kuadratike apo kubike të variablave të pavarur me variablat e varur.....	62
Tabela 4.3:	Testimi i multikolinearitetit.....	63
Tabela 4.4:	Testimi për heteroskedasticitetin.....	64
Tabela 4.5:	Vlerat kritike të testit Dickey-Fuller.....	66
Tabela 4.6:	Rezultatet e testeve LLC, Breitung, Im, ADF dhe PP për stacionaritetin.	66
Tabela 4.7:	Rezultatet e vlerësimit të tregtisë me metodën pooled OLS.....	68
Tabela 4.8:	Rezultatet e vlerësimit të importeve me metodën pooled OLS.....	69
Tabela 4.9:	Rezultatet e vlerësimit të eksporteve me metodën pooled OLS.....	70
Tabela 4.10:	Rezultatet e vlerësimit të tregtisë me metodën e efekteve fikse	71
Tabela 4.11:	Rezultatet e vlerësimit të importeve me metodën e efekteve fikse.....	73
Tabela 4.12:	Rezultatet e vlerësimit të eksporteve me metodën e efekteve fikse.....	74
Tabela 4.13:	Rezultatet e vlerësimit të tregtisë me metodën e efekteve të	

	rastit.....	75
Tabela 4.14:	Rezultatet e vlerësimit të importeve me metodën e efekteve të Rastit.....	76
Tabela 4.15:	Rezultatet e vlerësimit të eksporteve me metodën e efekteve të rastit.....	77
Tabela 4.16:	Rezultatet e testit Hausman për tregtinë.....	79
Tabela 4.17:	Rezultatet e rivlerësimit të tregtisë me metodën e efekteve të rastit.....	79
Tabela 4.18:	Rezultatet e testit Hausman për importet.....	80
Tabela 4.19:	Rezultatet e rivlerësimit të importeve me metodën e efekteve të rastit.....	80
Tabela 4.20:	Rezultatet e testit Hausman për eksportet.....	81
Tabela 4.21:	Rezultatet e rivlerësimit të eksporteve me metodën e efekteve të rastit.....	82
Tabela 4.22:	Analiza e raportit të grupit të parë të shteteve për vitin 2014	84
Tabela 4.23:	Analiza e raportit për grupin dytë të shteteve.	86
Tabela 4.24:	Analiza e raportit për grupi tretë të shteteve.....	89

LISTA E FIGURAVE

Figura 1.1:	Modeli konceptual i kërkimit.....	4
Figura 2.1:	Rruga që përshkron produkti nga nisja deri në daljen nga porti.....	16
Figura 2.2:	Exuria e eksporteve, importeve dhe bilancit tregtar në million lekë për periudhën 2000-2014.....	27
Figura 2.3:	Exuria e eksporteve, importeve dhe bilancit tregtar në përqindje për periudhën 2000-2014.....	28
Figura 3.1:	Paraqitja e “algoritmit” të metodologjisë.....	59
Figura 4.1:	Lidhja lineare eksport-GDP dhe import-GDP.....	61
Figura 4.2:	Harta e Europës e ndarë në tre grup shtete.....	83
Figura 4.3:	Raporti i tregtisë aktuale dhe tregtisë potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe grupit të parë të partnerëve të saj.	86
Figura 4.4:	Raporti i tregtisë aktuale dhe tregtisë potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe grupit të dytë të partnerëve të saj.	89
Figura 4.5:	Raporti i tregtisë aktuale dhe tregtisë potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe grupit të tretë të partnerëve të saj.....	91

LISTA E SHKURTIMEVE

BB	BANKA BOTERORE
BLUE	VLERESUES ME I MIRE I PAZHVENDOSUR QENDRA PËR STUDIME TE ARDHSHE DHE
CEPII	INFORMACIONIT NDËRKOMBËTAR
CGE	MODELI I EKUILIBRIT TE PERGJITHSHEM
CPI	INDEKSI I CMIMIT TE KONSUMATORIT
EJL9	9 VENDE TE EUROPEJES JUGLINDORE
EUR32	32 VENDE TE EUROPEJES
FE	EFEKTE FIKSE
FMN	FONDI MONETAR NDERKOMBETAR
RE	EFEKTET RASTESORE MARREVESHJA E PËRGJITHSHEME PËR TARIFA DHE
GATT	TREGTI
GDP	PRODUKTI I BRENDSEME BRUTO
HF	HERITAGE FOUND
IHD	INVESTIME TE HUAJA DIREKTE
INSTAT	INSTITUTI I STATISTIKAVE SHQIPTARE
LPI	INDEKSI I PERFORMANCES SE LOGJISTIKES
MTL	MARREVESHJA E TREGTISE SE LIRE
MTP	MARREVESHJE TREGTARE PREFERENCIALE
NTB	BARRIERAT TARIFORE
OBT	ORGANIZATA BOTERORE E TREGTISE ORGANIZATA PER ZHVILLIM DHE BASHKPUNIM
OECD	EKONOMIK
OLS	METODA E KATROREVE ME TE VEGJEL
OPEC	ORGANIZATA E VENDEVE EKSPORTUESE TE NAFTES
R&D	KERKIM DHE ZHVILLIM
RER	KURSI REAL I KEMBIMIT
ZTL	ZONA E TREGTISE SE LIRE

HYRJE

1.1. Sfondi i studimeve.

Tregtia ka sjellë përfitime shumë të mëdha për shtetet dhe qytetërimet. Ajo ka ndikuar në rritjen e produktivitetit, në shpërndarjen e njohurive dhe teknologjive dhe, gjithashtu, ka pasuruar mundësitë e zgjedhjeve të konsumatorëve. Këto përfitime nga tregtia kanë nkurajuar vëndet që, jo vetëm të forcojnë lidhjet tregtare, por të kërkojnë edhe për mundësi të reja tregtare, Adeem Khan (2011)¹

Sipas Khan (2011) me të dhënat bazuar në Organizatën Botërore të Tregtisë (2014), për periudhën 1950-2013, mesatarja e eksporteve u rrit me 2.7 përqind më shpejtë sesa produkti i brendshëm bruto real.

Pse është rritur tregtia?

Në studimin e tij Adeem Khan (2011) shpjegon se dy autorë si; Baier dhe Bergstrand (2001) tentuan të provojnë një etapë empirike për këtë çështje. Ata zbuluan për një grup prej 16 OECD vëndesh (për një periudhe nga 1950 deri 1980) se rreth 68 përqind e rritjes së tregtisë së dyanshme mund të shpjegohej nga rritja e GDP reale, 24.5 përqind e uljes së normës së tarifës dhe arritjet e marrveshjeve preferenciale të tregtisë, 8.5 përqind e rënieve në kostot e transportit.

Sipas Adeem Khan (2011); kundrejt hapave të shpejtë të rritjes së tregtisë, përgjatë dekadave të shkuara, ku, duke krahasuar pritjet teorike me ato të vërtetuara, vëndet dukej se po tregtonin më pak sesa pritej duke patur të dhëna përfitimet që do të merreshin nga tregtia. Khan tregon se volumi i tregtisë qëndronte më pak se volumi potencial i mundshëm i tregtisë *hipotetike*. Sipas Khan, Helpman (2011: faqe 26), argumentonte se pengesat në tregti luanin një rol të rëndësishëm në rrjedhjet tregtare në kombe të ndryshme dhe është i këshillueshëm të përdoret në model, sepse ndihmon në shpjegimin e të dhënave.

Sipas Adeem Khan (2011); kostot e larta të tregtisë, jo vetëm që pengojnë pjesëmarrjen e më shumë vendeve (ose firmave) në tregtinë ndërkombëtare, por, gjithashtu, ulin numrin e transaksioneve të tregtisë (OBT, 2008). Nuk është surprizuese, thotë Khan, që lehtësirat tregtare janë bërë fokusi i iniciativave kombëtare dhe ndërkombëtare. Sidoqoftë, siç shkruan Wilson, Mann dhe Otsuki (2004), nuk ka pasoja në përkufizimet e lehtësirave tregtare në politikat publike. Përkufizimi i saj, vijon Khan, varion nga një kuptim i ngushtë i përpjekjeve për të lehtësuar zhdoganimin e mallrave, në një kuptim më të gjerë, i cili përfshin përpjekjet për të përmirësuar mjedisin në të cilin zhvillohen transaksionet tregtare. Vëmë re se: në nivel global OBT vendosi negociata për krijimin e lehtësirave tregtare në korrik të vitit 2004. Këto negociata të vazhdueshme kanë qëllim, jo vetëm të shpejtojnë lëvizjen e të mirave drejt kufijëve më të gjerë, por, gjithashtu, të shtyjnë vëndet anëtare me asistencë teknike dhe mbështetje për krijimin e lehtësirave në tregti.

¹ Adeem Khan, Empirical Investigation of International Trade Using Gravity Models with Gravitas, 2011: faqe 1,2

Sipas Adeem Khan², përsa i përket lehtësirave tregtare, ato kanë qënë një rigjallërim i kërkimeve empirike vitet e fundit në çështjet dhe pasojat e tregtisë.

Ky interes i ri, thotë ai, i takon kërkimeve të reja në teorinë e tregtisë dhe teknikat analitike, që kanë nxitur kërkuesit të rishikojnë rezultatet e kërkimeve empirike të mëparshme. Sidoqotë, shton Khan, siç u vu re në kërkimet empirike të Wilson, Mann, dhe Otsuki (2004), të cilat përfshijnë çështje lidhur me lehtësirat tregtare, janë përballur me tre sfida: përcaktimi i kostove tregtare, zgjedhja e një strukture teorike për vlerësimet dhe realizimi i një analize të besueshme kundërshtuese. Duket se: kërkimet e fundit në këtë fushë janë shtyrë për përcaktimin e një strukture teorike për analizat sasiore.

Një nga analizat sasiore më të hasura në fushën e tregtisë, me qëllim për plotësimin e modelit të ekuilibrit të përgjithshëm (CGE), janë modelet e gravitetit të tregtisë, Adeem Khan (2011). Vlerësimi i rrjedhjeve të tregtisë globale, duke përdorur modelin e gravitetit, është një traditë e gjatë. Sidoqoftë, ka një çështje të re interesi e përdorur për kërkime empirike në saj të përparimeve të shumta teorike. Melitz (2003), Anderson dhe Wincoop (2003), Helpman (2008), Chaney (2009), Baier dhe Bergstrand (2009), janë disa nga studiuesit më në zë, thekson Khan.

Së fundmi sipas Khan³, Helpman (2011) argumentoi se teoria e tregtisë kishte përfshirë tre faza të rëndësishme zhvillimi: Faza e parë e teorisë së tregtisë klasike ose neoklasike shpjegonte tregtinë e jashtme nga shekulli nëntëmbëdhjetë dhe njëzetë. Faza e dytë nisi në fillim të 1980, u dominua nga e ashtuquajtura teoria *e re* e tregtisë. Zhvillimi i saj u motivua dhe theksonte ekonominë e shkallës dhe modelet e tregtisë monopolistike dhe konkurrese. Faza e tretë nisi në fillim të vitit 2000 dhe u fokusua në kërkimet aktuale, u dominua nga teoria *e re* e tregtisë. Ajo u ndërtua mbi teorinë *e re* të tregtisë të përmendur më parë, por u fokusua në karakteristikat e firmave individuale dhe sesi ato angazhoheshin në tregtinë ndërkombëtare. Kjo fazë u përqëndrua në ekzistencën e kufijve tregtarë dhe në lidhjen e tyre me marrëdhëniet tregtare të vendeve.

Përkrah këtyre zhvillimeve teorike, ekuacioni i gravitetit për tregtinë ka përfshirë disa specifikime të reja të ekuacioneve teorike më të sofistikuar.

Modelet e gravitetit për tregtinë janë shndërruar në modelet më të përdorura për vlerësimin e tregtisë dypalëshe ndërmjet shteteve që nga vitet 1960

Linder (1961) dhe Linnemann (1966) njihen si themeluesit e modeleve të gravitetit për tregtinë. Ashtu si teoria origjinale e gravitetit, edhe modelet e gravitetit për tregtinë shprehin flukset e tregtisë dypalëshe ndërmjet dy shteteve si funksion të dy variablave kryesorë: pozitivisht të lidhura në përpjesëtim të drejtë me masën ekonomike të dy vendeve që tregtojnë ndërmjet tyre dhe negativisht të lidhura me distancën ndërmjet këtyre shteteve.

Analiza e këtij materiali bazohet në një model të thjeshtuar të gravitetit, të propozuar nga Kaminski dhe de la Rocha (2003), dhe Frankel, Stein dhe Wei (1997), për të matur flukset tregtare potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe 32 vendeve të Europës (EUR32) duke i shtuar disa variabla të tjerë.

Variablat që do të trajtohen për të shpjeguar tregtinë dypalëshe janë:

² Empirical Investigation of International Trade Using Gravity Models with Gravitas, 2011:faqe 3

³ Empirical Investigation of International Trade Using Gravity Models with Gravitas, 2011:faqe 4

- Distanca e ponderuar ndërmjet vendeve.
- Masat ekonomike (GDP).
- Diferenca absolute e GDP-së për frymë ndërmjet vendeve.
- Rritja ekonomike.
- Indeksi i performancës së logjistikës.
- Marrëveshjet e tregtisë së lirë.
- Vend i Bashkimit European (0/1 variabël dummy).
- Vend kufitar (0/1 variabël dummy).
- Dalje në det (0/1 variabël dummy).
- Shteti ligjor.
- Madhësia e qeverisë.
- Efikasiteti rregullator.
- Hapja e tregjeve.

1.2 Problemi i kërkimit.

Konvencionalisht, modelet e tregtisë së Shqipërisë janë shpjeguar duke përdorur teoritë klasike (Rikardiane dhe Heckscher–Ohlin.). Vërtetohet statistikisht se Shqipëria tregon më shumë me disa vende se me të tjerat. Natyrshëm lindin pyetjet:

- Pse Shqipëria tregon më shumë me disa vende dhe më pak me të tjerat?
- Cilët janë faktorët që ndikojnë në tregtinë dypalëshe?
- A luan ndonjë rol masa ekonomike (GDP) dhe distanca në tregtinë ndërkombëtare?
- A ndikojnë indekset përbërëse të lirisë ekonomike në tregtinë dypalëshe?
- A jemi duke e orientuar tregtinë në ato vende ku ne përfitojmë?

Modeli i gravitetit si një instrument që përdoret në vlerësimin e flukseve tregtare shihet modeli më i përshtatshëm për t'ju përgjigjur këtyre pyetjeve. Në këtë punim ne do të

përdorim këtë model për të shpjeguar flukset tregtare të Shqipërisë kundrejt vendeve të përzgjedhura të Europës.

1.3 Konteksti i studimit.

Kuadri i kësaj pune kërkimore bazohet në dy shtylla kryesore: së pari, vlerësimin e modelit bazë të gravitetit të Frankel, Stein dhe Wei (1997) duke marrë në konsideratë edhe variablat e treguesit e lirisë ekonomike siç janë: shteti ligjor (variabël i përbërë nga të drejtat pronësore dhe korrupsioni), madhësia e qeverisë (variabël i përbërë nga liria fiskale dhe shpenzimet qeveritare), efikasiteti rregullator (variabël i përbërë nga liria e të bërit biznes, liria e punës, dhe liria monetare) dhe hapja e tregjeve (variabël i përbërë nga liria tregtare, liria investuese dhe liria financiare), së dyti, vlerësimin e potencialit të tregut të Shqipërisë me vendet e marra në analizë. Modeli konceptuar është paraqitur në figurën 1.1.




Figura 1.1: Modeli konceptual i kërkimit

Sa më e shkurtër distanca ndërmjet vendeve dhe sa më e madhe masa ekonomike aq më shumë kemi tregti ndërmjet vendeve dhe anasjelltas.

Pasi analizohen faktorët që ndikojnë në tregtinë dypalëshe të Shqipërisë me vendet e EUR32⁴, vlerësohet tregtia e jashtme me anë të tre metodave dhe me anë të testit Hausman zgjidhet metoda më e përshtatshme.

Metoda më të përshtatshme do të përdoret për të vlerësuar ekuacionin e gravitetit për tregtinë dhe zbatimi i ekuacionit të rivlerësuar do të lejojë gjenerimin e të dhënave për flukset tregtare potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj EUR32.

⁴ 32 vende të Europës

1.4 Qëllimi dhe objektivat e studimit.

1.4.1 Qëllimi i studimit.

Të bëjme një vlerësim të modelit të gravitetit për të shpjeguar flukset tregtare të vendit, dhe të nxjerrim përfundime mbi efektin sasior që kanë variablat e pavarur të përzgjedhur, e në veçanti efektin e lirisë ekonomike mbi tregtinë drejt partnerëve tregtarë.

Të përdorë ekuacionin e vlerësuar për të llogaritur potencialin e tregut në mënyrë që të bëjmë vlerësime dhe të japim rekomandime për orientimin e ardhshëm të tregtisë së Shqipërisë.

1.4.2 Objektivat e studimit.

Në mënyrë që të përmbushë qëllimin e kësaj pune kërkimore, objektivat e këtij disertacioni janë:

- a. Rishikimi i literaturës për vlerësimin e flukseve tregtare me anë të modelit të gravitetit, me qëllim identifikimin e variablave shpjegues dhe të varur si dhe zgjedhjen e metodës më të mirë të vlerësimit për të dhënat e flukseve tregtare të Shqipërisë.
- b. Prezantimi i një përshkrimi gjithpërfshirës së importeve dhe eksporteve shqipëtare, të kostove të tregtisë dhe të faktorëve që ndikojnë në kostot e tregtisë pozitivisht dhe negativisht.
- c. Zhvillimi i teorisë *së re* të tregtisë, së pari e zhvilluar nga Krugman (1979), me modelin e gravitetit të tregtisë. Ky objektivi na ndihmon të specifikojmë një ekuacion graviteti teorik, i cili mund të vlerësohet.
- d. Vlerësimi i modelit të gravitetit si dhe identifikimi i faktorëve që ndikojnë në tregtinë dypalëshe në rastin e Shqipërisë.
- e. Nxjerrja e përfundimeve mbi efektin sasior që kanë variablat e pavarur të përzgjedhur, e në veçanti efektin e lirisë ekonomike mbi eksportet dhe importet drejt partnerëve kryesorë.
- f. Të kuptojmë se cila nga teoritë ekonomike, hipoteza linder apo H-O shpjegon më mirë tregtinë e jashtme të Shqipërisë.
- g. Të bëjë një vlerësim të potencialit tregtar të Shqipërisë me vendet e marra në analizë duke na sygjëruar drejtimin e tregtisë së jashtme.

Për arritjen e këtyre objektivave, ky punim synon t'i japë përgjigje disa pyetjeve kërkimore të cilat mund të përmbliken:

- a. Si vlerësohet modeli i gravitetit dhe si janë matur variablat kryesorë të përdorur duke u bazuar në sugjerimet e punimeve të ndryshme në vite?

- b. Sa i efektshëm është zbatimi i modelit të gravitetit në parashikimin e flukseve të ardhshme tregtare?
- c. Cilat janë rezultatet lidhur me ndikimin e lirisë ekonomike, në termat e tregtisë dhe strukturës së import-eksportit?
- d. Cilët janë faktorët që ndikojnë në parashikimin e flukseve të ardhshme tregtare?
- e. Cila nga hipotezat e shpjegon më mirë tregtinë e jashtme të Shqipërisë, ajo Linder apo Heckscher-Ohlin?
- f. Cili është drejtimi i tregtisë së sygjëruar nga llogaritja e potencialit të tregut?

1.5 Struktura e studimit.

Disertacioni përbëhet nga 5 kapituj, të grupuara në dy pjesë. Në pjesën e parë realizohet një vlerësim i literaturës ekzistuese, metodologjisë, instrumentave të përdorura dhe modeleve të ngritura (kapitujt 2 dhe 3). Në pjesën e dytë janë paraqitur dhe testuar modelet e propozuara dhe janë diskutuar konkluzionet e punimit e kontributet e saj në marrëdhëniet tregtare të Shqipërisë me vendet e BE32 (kapitujt 4, 5).

Kapitulli 2: Rishikimi i literaturës.

Në kapitullin 2 është shqyrtuar literatura e tregtisë ndërkombëtare. Janë studiuar çështjet kryesore të teorisë së tregtisë si: evolucioni i teorisë së tregtisë, pikënamjet moderne mbi tregtinë, teoria e ciklit jetësor të produktit, teoria e tregtisë së re, kostot e tregtisë, zbatimet e modelit të gravitetit në tregtinë dypalëshe dhe kostot e tregtisë. Më pas jepet një vëzhgim i shkurtër mbi studimet e fundit të tregtisë së jashtme të Shqipërisë duke përdorur modelin e gravitetit dhe së fundi një vëzhgim i përgjithshëm mbi tregtinë e jashtme në Shqipëri.

Kapitulli 3: Metodologjia e studimit dhe instrumentat e përdorura.

Kapitulli 3 prezantohet në tre seksione kryesore. Në seksionin e parë bëhet specifikimi i modelit dhe struktura teorike e studimit. Çështjet lidhur me metodologjinë ekonometrike duke përfshirë vlerësuesit pooled, atë me efekte fikse dhe me efekte rastësore, janë diskutuar në seksionin e dytë. Seksioni i fundit prezanton një përshkrim të shkurtër të variablave të përdorura në studim, si dhe vlerësimin teorik të ekuacioneve të gravitetit.

Kapitulli 4: Analiza e rezultateve dhe gjetjet.

Në këtë kapitull do të vlerësojmë modelin e gravitetit për tregtinë dypalëshe dhe më pas do të gjykojmë mbi potencialin e tregut duke dhënë sygjëime për drejtimin e tregtisë. Analiza empirike në këtë kapitull është e ndarë në dy seksione.

Në seksionin e parë do të vlerësohet nëse teknika pool OLS, me efekte fikse (FE) apo teknika me efekte rastësore (RE) është më e qëndrueshme duke u bazuar në testin Haustman.

Rezultatet e testit Haustman do të na japin metodën më të përshtatshme, të cilën do të zgjedhim për të vlerësuar ekuacionin e gravitetit për eksportet, importet dhe totalin e tregtisë.

Në seksionin e dytë do të bëjmë vlerësimin e potencialit të tregut të Shqipërisë me vendet e marra në shqyrtim duke bërë një analizë nëse jemi duke shfrytëzuar ose jo potencialin tonë tregtar.

Në mënyrë që rezultatet tona të jenë të besueshme, ne duhet të sigurohemi që të dhënat nuk na japin rezultate të deformuara, për këtë arsye në këtë kapitull do të kontrollojmë variablat tanë për: linearitetin në parametra, multikolinearitetin, heteroskedasticitetin, korrelacionin serial dhe stacionaritetin.

Nëpërmjet përdorimit të programeve statistikore SPSS 17.0, EVIEWS 8 dhe Megastat, përpunohen të dhënat dhe identifikohen treguesit e rëndësishëm statistikorë të modelit. Gjetjet konfirmojnë vlefshmërinë dhe besueshmërinë e modelit konceptual të propozuar dhe sigurojnë rezultatet e kërkimit.

Kapitulli 5: Diskutimi i rezultateve, konkluzionet dhe rekomandimet.

Ky kapitull paraqet një përmbledhje të hulumtimit në këtë mikrotezë. Diskutohen rezultatet, si dhe konkluzionet e nxjerra nga gjetjet, të cilat pasqyrohen në këtë kapitull. Rezultatet e testimit të të gjitha hipotezave të modelit janë gjithashtu objekt i këtij kapitulli. Ky kapitull vlerëson kontributet të këtij punimi, nxjerr në pah kufizimet e tij dhe diskuton potencialin për kërkime të mëtejshme.

2. LITERATURA E SHQYRTUAR

2.1 Evolucion i teorisë së tregtisë.

Pyetje kryesore që kërkon përgjigje nga teoria e tregtisë është:

Si është e lidhur tregtia me problemet bazë ekonomike të *efiçencës në alokim, efiçencës në motivim dhe efiçencës në shpërndarjen* e burimeve të rralla?

Kjo nënkupton se teoria moderne e tregtisë duhet t'i përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

- *Si të mirat janë të tregtuara ndërkombtarisht?*
- *Si kontribuon tregtia ndërkombëtare në dobinë racionale të burimeve në të gjithë botën?*
- *Me çfarë çmimi shkëmbehen të mirat dhe shërbimet ose cilat janë termat e tregtisë?*
- *Si është e lidhur tregtia ndërkombëtare me përdorimin efiçient të burimeve të rralla?*
- *Sa janë fitimet nga tregtia dhe nga vijnë këto fitime?*
- *Si janë të shpërndara këto fitime përgjatë tregtisë midis vendeve?*
- *Cili është ndikimi i tregtisë ndërkombëtare me shpërndarjen e barabartë në botë?*

Tregtia ndërkombëtare është një faktor dhe një produkt i zhvillimit të tregtisë së kombeve. Në mënyrë të ngjashme, evoluimi i teorisë së tregtisë reflekton rrugët në të cilat shtetet adresojnë problemet bazë ekonomike. Përgjatë periudhës, nga shekulli gjashtëmbëdhjetë deri në mesin e shekullit të tetëmbëdhjetë, Britania, Spanja, Franca dhe Holanda ishin vendet më të zhvilluara me një nivel të lartë ndërhyrje të qeverisë në ekonomi. Qeveritë e këtyre vendeve shqetësoheshin për mbajtjen e pushtetit dhe mirqënies. Filozofia ekonomike që reflekton këto qëllime, është njohur si *merkantilizëm*. Merkantilistët argumentonin se: rruga më e mirë për një komb, që të ketë rritje më të shpejtë ekonomike, është të eksportoje më shumë sesa të importojë. Të ardhurat duhet të jenë hyrje reale të arit.

“unë mendoj, shkruan Hel, që nga arkat tona dalin jo më pak se njëqindmijë sterlina në vit në këmbim të produkteve, të cilat nuk kanë asnjë vlerë, ashtu siç janë, por e marin vlerën falë përpunimit të tyre me shpenzimet tona.

Çfarë sjellje e trashë është kjo e jona, që vazhdojmë ta durojmë këtë gjendje, të lejojmë të na zhvatën vazhdimisht pasuritë dhe paratë tona në këtë mënyrë dhe, mbi të gjitha, të lejojmë që lëndët e para të largohen nga vendi ynë duke u bërë kështu një mundësi pune për të huajt, nga të cilët ne i blejmë përsëri ato!”⁵

⁵ Ibid, fq.95

Meqë shumë e arit ishte e fiksuar në periudha afatshkurtra, jo të gjithë kombet mund të kishin hyrje në mënyrë simultane dhe fitimet nga tregtia do të arriheshin në kurriz të vendeve të tjera. Pra treg *tregtia ndërkombëtare* sipas merkantilisteve kishte shumë zero. Kjo është arsyeja pse merkantilistët mbronin kufizimet në importe dhe promovimin e eksporteve.

Këndvështrimet e merkantilistëve u sfumuan nga **Adam Smith**, ai mbron tregtinë e lirë të bazuar në *avantazhet absolute* të vendeve.

Ai provoi se ka avantazhe nga ndarja e punës⁶ dhe specializimi do të ndahej nga të gjithë vendet dhe do të sillte përfitime.

Vendet duhet të specializoheshin në industri, ku ata do të kishin avantazh absolut dhe në këtë mënyrë do të kishin përfitime nga tregtia, jo në kurriz të vendeve të tjerë dhe kështu nuk do të kishte nevojë që qeveria të ndërhynte. Ndërhyrja e qeverisë (shkruan Smith) sjell vetëm përkeqësim në shpërndarjen e burimeve dhe të produktivitetit. Ky është kontributi më i rëndësishëm i Adam Smith në teorinë dhe politikën e tregtisë. Çfarë ai nuk shpjegoi ishte, kur një vend ka avantazh absolut në prodhimin e të gjithë të mirave.

Pikat e dobta të këndvështrimeve të Smith u zhvilluan nga **David Ricardo**, ai zhvilloi teorinë e avantazheve krahasuese⁷ për të provuar se tregtia e përfitimeve reciproke mund të ndodhi edhe kur një vend është absolutisht më eficient në prodhimin e të gjithë të mirave. Sipas Rikardos, vendet specializohen në industri, ku kanë mundësi me kosto të ulët dhe në tregtinë e bazuar në avantazhet krahasuese, ku të gjitha vendet kanë fitime nga tregtia ndërkombëtare. Ky është një nga principet më të rëndësishme dhe më të pakundërshtueshme deri tani të teorisë dhe praktikës ekonomike.

Këndvështrimet e David Ricardo bazoheshin në vlerën e teorisë së punës, e cila nënvizon rolin e punës në krijimin e vlerës. Rikardo nuk analizoi ndikimin e burimeve të dhuruara në produktivitet dhe specializimin ndërkombëtar dhe ndikimin e tregtisë në shpërndarjen e të ardhurave.

Teoria e Raporteve të Faktorëve ose Teoria Heckcher – Ohlin (H-O).

Në fillim të shekullit XIX u shfaq një teori e tregtisë ndërkombëtare, që e fokusonte vëmendjen në raportin (ofertën) e burimeve të një vendi. Kosto e çdo burimi është thjesht rezultat i kërkesës dhe ofertës. Faktorët, në rastin kur oferta është e madhe në krahasim me kërkesën, do të jenë më pak të kushtueshëm se sa faktorët kur oferta është më e ulët në raport me kërkesën.

Teoria e Raporteve të Faktorëve thekson se vendet prodhojnë dhe eksportojnë mallra që kërkojnë burime (faktorë) që janë me shumicë dhe importojnë mallra që kërkojnë burime për të cilat nuk ka ofertë.

Një kontribut shumë të rëndësishëm në analizën e problemeve teorike, që lidhen me tregtinë ndërkombëtare, kanë dhënë Eli Heckscher, një historian i shquar Suedez i ekonomisë dhe Bertil Ohlin, ish student i Heckscher, profesor në Stokholm dhe më vonë fitues i çmimit “Nobel”.

⁶ A. Smith, Kërkime mbi natyrën dhe arsyet e pasurisë së kombeve, fq. 163-164

⁷ Ndryshe, “teoria e kostove të krahasuara” Historia e mendimit ekonomik, Henri Denis, faqe 285

Fillimisht Heckscher në një artikull të shkurtër të botuar në 1919 dhe më pas Ohlin (1933), kontribuan fuqishëm në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomiksit të tregtisë ndërkombëtare në dy drejtime kryesore:

Ata shpjeguan bazën e avantazheve krahasuese, për Heckscher, në bazë të avantazheve krahasuese, qëndrojnë ndryshimet në përpjestimet e faktorëve, konkretisht ndryshimet në zotërimin relativ të faktorëve dhe në intensitetin relativ të përdorimit të tyre. Këtë ide të Heckscherit e zhvilloi më tej Ohlin. Sipas fjaleve të Ohlin:

*"Mallrat që për prodhimin e tyre kërkojnë sasi të mëdha nga faktorët që disponohen me shumicë dhe sasi të vogla nga faktoret që disponohen me pakicë, eksportohen në shkëmbim të mallrave, kërkesa e të cilëve për faktorë është në përpjestime të kundërta"*⁸.

Pra, indirekt, faktorët që disponohen me shumicë, eksportohen, ndërsa faktorët që disponohen me pakicë, importohen.

Themi se një vend zotëron me shumicë një faktor, në qoftë se raporti i këtij faktori ndaj faktorëve të tjerë është më i lartë në këtë vend se sa në pjesën tjetër të botës. Themi se një produkt është përdorues intensiv i një faktori, në qoftë se pjesa e këtij faktori në koston e produktit është më e lartë se pjesa e faktorëve të tjerë.

Heckscher dhe Ohlin, i kushtuan rëndësi analizës së efekteve të tregtisë në të ardhurat e zotëruesve të faktorëve të prodhimit (kapitalit dhe punës) në vendet partnere. Analiza e efekteve të tregtisë në të ardhurat e zotëruesve të faktorëve të prodhimit, qëndron në themel të teorive mbi politikat tregtare.

Le t'i hedhim një sy se si qëndron teoria e raporteve të faktorëve përballë testimeve shkencore.

Paradoksi Leontief.

Përveç tërheqjes konceptuale, teoria e raporteve të faktorëve nuk është mbështetur nga studime që ekzaminojnë nivelin tregtar të një vendi. Studimi i parë i rëndësishëm ishte ai i studiuesit Wassily Leontief, i cili botoi një libër me titull "*Struktura e ekonomisë amerikane 1919-1939*", me nëntitull "*Zbatimi empirik i analizës së ekuilibrit*"⁹. Në fillim të viteve 1950, Leontief testoi nëse Shtetet e Bashkuara, të cilët përdorin më shumicë paisjet kapitale, eksportojnë mallra që kërkojnë prodhim intensiv pune. Në kundërshtim me teorinë e raporteve të faktorëve, studimi i tij zbuloi se eksportet e Shteteve të Bashkuara kërkonin më shumë prodhim intensiv pune se sa importet. Ky paradoks, midis predikimeve të teorisë dhe levizjes tregtare, është quajtur paradoksi Leontief. Gjetjet e Leontief janë mbështetur nga një sërë kërkimesh mbi të dhënat e tregtisë së një numri të madh vendesh.

⁸ Historia e mendimit ekonomik, Henri Denis, Papirus 2010

⁹ The Structure of American Economy, 1919-1939, New York, 1941.

2.2 Disa pikëpamje moderne (alternative) mbi tregtinë.

Një sërë zhvillimesh në fushën e tregtisë ndërkombëtare janë paraqitur në vitet e fundit, ndër to mund të veçojmë teorinë e *ekonomizimeve të shkallës* dhe teorinë mbi *ciklin jetësor të produktit*.

Rritja e tregtisë brendadegësore nuk mund të shpjegohet thjesht dhe në mënyrë të mjaftueshme me rritjen e kërkesës. Në ndihmë vjen teoria e *ekonomizimeve të shkallës* dhe ajo e *ekonomizimeve të jashtme*. *Ekonomizimet e shkallës* dhe *ekonomizimet e jashtme* bëjnë të mundur uljen e kostos, pra dhe të çmimit të produktit, ose, të paktën zbusin presionin e rritjes së kërkesës në rritjen e çmimit për këto produkte.

2.3 Teoria e ciklit jetësor të produktit.

Teoria e ciklit jetësor të produktit shpjegon dinamikën e avantazheve krahasuese, kalimin e tyre nga një vend (kategori vendesh) në një tjetër, mbi bazën e ndryshimit të faktorëve përcaktues të vetë këtyre avantazheve (shterimit të një faktori dhe aktivizimit të një faktori tjetër).


Fazat e Ciklit të Jetës së Produktit, Raymond Vernon (1960)

Teoria ndërkombëtare e ciklit të jetës së produktit e ndjek rrugën që bën një mall gjatë të gjithë ciklit të jetës së tij për të përcaktuar nëse ai do të prodhohet apo jo.

Faza 1. Hedhja në treg,

Faza 2. Faza e maturimit të produktit,

Faza 3. Faza e standartizimit të produktit.



R.Vernon e zhvilloi teorinë e tij në një kohë, kur pjesa më e madhe e prodhimeve të reja që zhvilloheshin në botë, ishin me origjinë dhe shiteshin në Shtetet e Bashkuara të Amrikës. Një arsye, pse kompanitë amerikane ishin të forta në të gjithë botën në vitet 1960, ishte se bazat e tyre të prodhimit vendor nuk ishin shkatërruar gjatë Luftës së Dytë Botërore. Përveç kësaj, gjatë luftës prodhimi i mallrave të qëndrueshëm në SHBA, përfshirë automobilët, u spostua në prodhimin e transportit ushtarak dhe armatimeve. Kjo hodhi bazat për një kërkesë të madhe pas luftës për mallra të konsumit të gjerë.

Produktet e reja duken se po lulëzojnë kudo, ndërsa aktivitetet kërkimore dhe të zhvillimit të kompanive po vazhdojnë të globalizohen. Për më tepër, kompanitë sot projektojnë produkte të reja dhe bëjnë modifikimet e produkteve me një ritëm shumë të shpejtë. Rezultati është një vjetërim më i shpejtë i produktit dhe një situatë në të cilën kompanitë “kanibalizojnë” produktet e tyre ekzistuese me prezantimin e produkteve të reja. Kjo i ka detyruar kompanitë të prezantojnë produktet në shumë tregje në të njëjtën kohë për të kompensuar kostot e kërkimit dhe zhvillimit të produktit përpara se të bien shitjet dhe të ketë rënë nga linja e prodhimit.

2.4 Teoria e Tregtisë së Re.

Gjatë viteve 1970 – 1980 u shfaq një teori *e re* që shpjegonte modelet e tregtisë. Përfaqësuesi kryesor i kësaj teorie ishte Paul Krugman. Për shkak se teoria *e tregtisë së re* e vë theksin më shumë tek produktiviteti se sa tek burimet e vendit, ajo përputhet me teorinë *e avantazheve krahasuese*, por edhe me teorinë *e raporteve të faktorëve*.

Sipas kësaj teorie:

- Nga specializimi i ekonomisë dhe rritja e ekonomisë së shkallës ka fitime;
- Kompanitë që hyjnë të parat në treg, mund të krijojnë pengesa për hyrjen e të tjerëve në treg. Sipas teorisë *së tregtisë së re*, ndërsa një kompani e rrit shkallën e saj të specializimit në një produkt të caktuar, prodhimi rritet për shkak të rritjes së efikasitetit. Pavarësisht nga volumi i prodhimit të kompanisë, ajo ka kosto fikse. Teoria thekson se: me rritjen e specializimit të prodhimit, kompania mund të realizojë ekonominë e shkallës, duke ulur në këtë mënyrë koston për njësi të prodhimit. Kjo është arsyeja pse kompanitë zgjerohen apo ulin çmimin për blerësit dhe detyrojnë konkurrentët e rinj potencialë të prodhojnë një nivel të ngjashëm prodhimi, nëse duan të jenë konkurrenca me çmimet e tyre.
- Qeveritë mund të luajnë një rol në mbështetjen e kompanive vendase, pra të jenë proteksioniste.

Një shpjegim koherent i tregtisë moderne ndërkombëtare e jep teoria *e avantazheve konkurruese të vendeve*. Sipas teorisë konkurrenca dhe tregtia ndërkombëtare është e përkufizuar nga katër faktorë:

- Kushtet e Faktorëve,
- Kushtet e Kërkesës,
- Struktura e Firmave
- dhe Rivaliteti.

Teoria *moderne e tregtisë* hulumton efektet e një serë faktorësh mbi tregtinë, duke përfshirë këtu teknologjinë dhe ekonominë e shkallës. Kjo kërkon një përdorim të gjerë të matjeve ekonomike për të identifikuar nëpërmjet ekonometrisë kontributin e faktorëve që ndikojnë në tregtinë ndërkombëtare. Ndryshimet teknologjike vlerësohen sot si një avantazh i përkohshëm në arritjen e suksesit në tregtinë ndërkombëtare. Gjithashtu, është vënë re se shpenzimet e kërkimit dhe zhvillimit të produkteve dhe shërbimeve, regjistrimi dhe lëshimi i patentave, disponueshmëria e fuqisë punëtore të kualifikuar, etj, janë

tregues të mirë të leadershipit, që u mundëson disa vendeve të prodhojnë dhe tregtojnë me më shumë cilësi, efektivitet dhe efikasitet, se disa vende të tjera.

Teoria moderne sugjeron se: mallrat që tregtohen midis vendeve ndahen në tre kategori:

- Mallrat që prodhohen nga nxjerrja dhe përpunimi rutinor i burimeve të disponueshme natyrore, të tilla si: hidrokarbure, qymyr, drithëra, etj, për të cilat vendet në zhvillim shpesh kanë një avantazh në krahasim me llojet e tjera të prodhimit. Këto quhen "mallra Ricardo"
- Mallra që prodhohen me teknologji të ulët, të tilla si: teknologjia e tekstileve dhe çelikut, që tentojnë të kalohen në vende me faktor të përshtatshëm, që mund të quhen "mallra Heckscher-Ohlin".
- Mallra me teknologji të lartë dhe ekonomi shkalle të lartë, të tilla si: kompjuterat, aeroplanët, për të cilët avantazhi krahasues lind nga disponueshmëria e burimeve për kërkim dhe zhvillim, kombinuar me aftësi të veçanta dhe afërsinë me tregjet e mëdha dhe të sofistikuar.

Armington (1969). sugjeroi një zgjidhje të problemeve të modelimit të tregtisë, në një model me shumë vende, shumë sektorë, për të mira të caktuara le të themi një kompjuter nga Gjermania dhe një kompjuter nga Japonia të cilat tregtohen si produkte të të njëjtit lloj, por që mbeten përsëri zëvendësuese jo të plota, për shkak të karakteristikave të ndryshme në produkt.

Ajo ç'ka vihet re në literaturën e kohës së fundit, nga kritikë të ndryshëm të fushës së ekonomisë, është përpjekja për gjetjen e përfitimeve tregtare si pasojë e intensifikimit të tregtisë ndjekur nga heqja dhe eliminimi i tarifave.

2.5 Kostot e tregtisë.

Kostoja e tregtimit shpesh konsiderohen si force penguese për zhvillimin e tregtisë globale.

Kostot e tregimit përfshijnë të gjitha kostot që shërbejnë për të dërguar të mirën tek përdoruesi final, përfshirë këtu edhe kostot marginale të prodhimit të vet produktit.

Sipas këtij përkufizimi, në kostot e tregimit përfshihen, distanca, politikat tregëtare, kostot e transportit, kostot e komunikimit të ,kostot procedurale dhe kostot e infrastrukturës.

2.5.1 Faktorët që ndikojnë në koston e tregtimit.

2.5.1.1 Distanca

Roli i distancës gjeografike dhe i influencës së vendeve fqinje ka qenë gjerësisht e neglizhuar në teorinë tradicionale të rritjes, e cila mbështetet në karakterin kombëtar dhe progresin teknologjik. Ende grumbullimi i aktiviteteve ekonometrike është një fenomen që ngre pyetjen rreth zgjerimit se nga cili shtet fqinj ka ndikimet më të mëdha. Procesi i zhvillimit mund të pengohet në vendet që janë larg nga qendrat me aktivitetet ekonomik. Distanca mund të ketë efekt në prodhim dhe të ardhura të ndryshme që përfshijnë tregtinë, investimet e huaja dhe zhvillimin teknologjik. Po të përqëndrohemi tek tregtia, distanca në mënyrë të drejtpërdrejtë rrit koston e transportit, që është një pengesë për të dy vendet që kryejnë tregti. Ka një numër rrugësh të ndërlidhura, nëpërmjet të cilave kemi efekt në prodhim. Afërsitë e mëdha me tregjet në botë rrisin mundësinë të përqëndrohesh në shfrytëzimin e burimeve në mënyrë konkurruese. Mbi të gjitha, konkurenca e fortë ushtron presion mbi kompanitë që të përdorin burimet në mënyrë sa më eficiente dhe i detyron të përtërijnë dhe të mbajnë një avantazh konkurrues.

Me një popullsi të pakët në numër dhe të largët të një vendi, kompania duhet të bëjë një analizë të çmimit të transportit me atë të produktit, në mënyrë që të ngeli konkurrues në treg me kompanitë e tjera, "faktori çmim në prodhimet e një ndërmarrje varet nga vendndodhja e konsumatorit dhe përpiket t'i barazpeshojë ato". Largësia ka gjithmonë kosto, sepse ka shpenzime ekstra.

2.5.1.2 Politikat tregtare.¹⁰

Politika tregtare është korpusi i vendimeve ligjore, që ndikojnë direkt në sasinë e të mirave dhe shërbimeve që një vend importon ose eksporton. Politikat tregtare mund të marrin formë të ndryshme, më të zakonshmet janë *taksat doganore* ose taksat e aplikuara mbi të mirat e importuara dhe *kontigjenimi i importeve (kuota)* ose limite sasiore për kufizimin e importit të prodhimeve të caktuara. Politikat tregtare restriktive (shtrënguese) janë të përhapura në të gjithë botën, ndonëse ndonjëherë janë të "kamuflluara". Për shembull, qeveria e SHBA ushtron presione të vazhdueshme mbi qeverinë japoneze në mënyrë që të kufizojë numrin e makinave japoneze të eksportuara në SHBA. Këto të ashtuquajtura "*restriksione vullnetare në eksport*¹¹", realisht nuk janë vullnetare dhe në thelb janë një formë e kontigjenimit të importeve.

*Barrierat tarifore.*¹²

Një tarifë është një taksë (detyrim), që vendoset mbi një produkt, kur kalon kufijtë kombëtarë.

¹⁰ Artut Hadroi, (2005), leksione "Ekonomise Nderkombetare" prezantuar ne UAMD

¹¹ Për më shumë shiko: Berry, Steven, James Levinsohn, and Ariel Pakes. 1999. Voluntary Export Restraints on Automobiles: Evaluating a Trade Policy. American Economic Review 89(3): 400-30. - See more at: <http://www.perc.org/articles/voluntary-export-restraints-automobiles#sthash.Yy4wEbIi.dpuf>

¹² Artut Hadroi, (2005), leksione "Ekonomise Nderkombetare" prezantuar ne UAMD

Tarifa më e përhapur është *tarifa e importit*, e cila është një taksë që vendoset mbi një produkt të importuar. Një tarifë më pak e zakonshme është *tarifa e eksportit*, e cila është një taksë që i vendoset një produkti që eksportohet. Tarifat e eksportit janë përdorur shpesh nga vendet në zhvillim. Për shembull, kakao që eksportet nga Gana tarifohet, po ashtu edhe eksportet e naftës tarifohen nga OPEC¹³, në mënyrë që të rriten të ardhurat për vendin ose të nxisin pamjaftueshmëri në tregjet globale dhe rrjedhimisht të rrisin çmimin e produktit që eksportojnë.

Tarifat mund të vendosen për qëllime të mbrojtjes së prodhimit apo për rritjen e të ardhurave.

Një *tarifë mbrojtëse* është projektuar për të reduktuar sasinë e importeve që hyjnë në një vend, kështu izolimi nga konkurenca e jashtme mbron prodhuesit vendas. Kjo sjellë një rritje të prodhimit vendas, në mungesë të tarifës mbi importet do të ishte pamundur mbrojtja nga konkurenca e jashtme.

Një *tarifë për rritjen e të ardhurave* vendoset me qëllim gjenerimin e të ardhurave në buxhet dhe mund të vendosen në të dyja rastet si për eksportet ashtu edhe për importet.

Barrierat jo tarifore. ¹⁴

Në këtë pjesë të kapitullit do të shqyrtojmë politikat e tjera, që kufizojnë tregtinë ndërkombëtare. Nga viti 1960 e në vazhdim barrierat tarifore dhe ato jotarifore janë bërë temat më të diskutuara gjerësisht në raundet e negociatave të tregtisë ndërkombëtare. Edhe pse tarifat kanë zbritur në dekadat e fundit, pengesat jotarifore për tregtinë janë shumëfishuar. Kjo nuk është e habitshme, pasi të gjitha forcat politike që kërkojnë vendosjen e tarifave të larta për të mbrojtur ekonominë e vendeve të tyre, nuk do të zhduken ndonjëherë. Por, në vend të kësaj, ata duhet të kërkojnë mbrojtje nëpërmjet kanaleve të tjera e jo nga barrierat mbi tregtinë.

Barrierat jotarifore përfshijnë një shumëllojshmëri të masave. Disa nuk sjellin pasoja të rëndësishme mbi tregtinë, për shembull, kërkesat në lidhje me etiketimin dhe paketimin e produktit nuk mund të kufizojnë tregtinë. Barrierat e tjera jotarifore ndikojnë dukshëm në modelet e tregtisë, siç janë: kuotat e importit, kufizimet vullnetare të eksportit, subvencionet e ndryshme, etj. Këto lloj barrierash janë të destinuara për të reduktuar importet dhe kështu përfitojnë prodhuesit e brendshëm.

2.5.1.3 Rrjeti i logjistikës.

Rrjeti i logjistikës tregtare është një kombinim i disa aktiviteteve, si: transporti, magazinimi, dhe shpërndarja. Tregtarët, që të jenë sa më kompetitiv në tregun global, duhet të jenë të aftë të lëvizin mallrat dhe shërbimet me kosto transaksioni sa më të ulta të mundshme.

Indeksi që përdoret për të matur kostot e logjistikës është indeksi LPI që do ta sqarojmë në kapitujt në vijim.

Kostot e logjistikës i klasifikojmë në kosto direkte dhe indirekte sipas, Adeem Khan, (2011)

¹³OPEC -Organization of Petroleum Exporting Countries

¹⁴ Artut Hadroi, (2005), leksione “Ekonomise Nderkombetare” prezantuar ne UAMD

- *Kostot direkte* i referohen kostos që lidhen me transportin dhe më së shumti kanë si faktor kryesor distancën midis vendeve.
- Ndërsa *kostot indirekte* janë në përgjithësi më komplekse e që nuk kanë të bëjnë me aktivitetin direkt, si për shembull: kosto e procedurave të zgjatura në doganë ose infrastruktura e pazhvilluara.

2.5.1.4 Kosto të tjera.

Adeem Khan¹⁵ argumenton se pasja e një gjuhe dhe historie zhvillimi të njëjtë ndihmon në praktikën e të bërit biznes duke reduktuar kostot. Firmat që operojnë në vendet që kanë gjuhë dhe histori pothuajse të njëjtë, dinë më shumë rreth njëri-tjetrit, pasi e kryejnë aktivitetin operativ në mjedise pothuajse të njëjta, pra është më e lehtë lidhja e kontratave dhe kryerja e shkëmbimeve tregtare në mjedise familjare. Nuk është e vështirë të vihet re se vendet e izoluara kanë një disavantazh, pasi ato nuk mund të kontrollojnë kushtet e transportit jashtë kufijve të tyre.




Figura 2.1: Rruga që përshkron produkti nga nisja deri në daljen nga porti
Burimi: Adeem Khan, (2011)

Këto vende duhet të kontribojnë në ndërtimin e korridoreve tregtare për të pasur akses në portet dhe rajonet tregtare të partnerëve. Banka Botërore raporton se vendet e izoluara kanë një disavantazh të theksuar në kohë dhe kosto. Gjithashtu, raportohet se këto vende duhet të përballojnë një zinxhir më të zgjeruar të aktiviteteve për transportin e të mirave.

2.6 Modeli i gravitetit në tregtinë dypalëshe.

Kjo teori lindi për të shpjeguar statistikisht tregtinë dypalëshe ndërmjet vendeve. Studiuesit vënë re se marrëdhëniet tregtare dypalëshe ndërmjet dy vendeve mund të shpjegohen nga masa ekonomike¹⁶ dhe distanca ndërmjet vendeve. Specifikisht, kjo lidhje ngre hipotezat e para për këtë punim.

a. A ndikohet tregtia dypalëshe nga masa ekonomike?

¹⁵ Empirical Investigation of International Trade Using Gravity Models with Gravitass, 2011

¹⁶ Shih: Measuring the economic mass, the Albanian case, Prendi Llambi, Velaj Entela. 2014

- b. A ndikohet tregtia dypalëshe nga faktorët gjeografikë, në rastin tonë nga distanca?

Kjo hipotezë e ngritur nga studiuesit e rinj tregon se:

Ekuacioni 2.1

$$\ln X_{ij} = \ln \alpha_0 + \alpha_1 \ln GDP_i + \alpha_2 \ln GDP_j + \alpha_3 \ln dis_{ij} + \ln \varepsilon_{ij}$$

ku x_{ij} përfaqëson tregtinë dypalëshe nga vendi "i" drejt vendit "j", GDP_{ij} përfaqëson masën ekonomike që në rastin tonë GDP-në e vendeve respektive, d_{ij} përfaqëson distancën ndërmjet vendeve të përfshira në model dhe ε_{ij} përfaqëson termin e gabimit.

Ky ekuacion u quajt modeli i gravitetit, që duke e parë, ngjan me ligjin e gravitetit të Njutonit.

- Ky ekuacion ka një forcë të lartë shpjeguese për tregëtinë e jashtëme.
- Tregtia ndërmjet vendeve ndikohet shumë nga distanca ndërmjet vendeve

Ekonomistët, avarësisht rezultateve, nguronin të mbështeteshin tek ky model, ata i besonin më shumë teorive klasike apo kensianiste të aplikuara deri në atë kohë. Ky model është gjykuar negativisht në të shkuarën, ndersa sot ky model është provuar statistikisht që jep rezultate të qenësishme.

Në këtë kapitull ne do të shohim literaturën e lidhur me këtë model, pra disa teori dhe aplikime.

2.6.1 Zhvillimi historik.

Fillimet e modelit të gravitetit datojnë në mes të viteve 1950, kur Isard dhe Peck (1954), përpunuan efektet negative të distancës, strukturat tregtare dhe politike, si dhe pabarazitë në tregtinë bilaterale, tregon Lucie Davidová,(2011), në punimin e tij,

Sipas Davidová¹⁷ ekuacioni i modelit të gravitetit u realizua nga Tinbergen (1962). Ky model bazohej në përafrimin Njutonian të interpretimit të flukseve të tregtisë bilaterale.

Që në përdorimet e para të modeleve të gravitetit ato kanë reaguar shumë mirë në aplikimet empirike. Sidoqoftë, ekzistonte problemi i mungesës së bazës teorike të këtij koncepti për një kohë të gjatë. Disa ekonomistë ngritën dyshime mbi bazën teorike të modelit të gravitetit, Lucie Davidová,(2011),

Në atë kohë u publikuan shumë punime nga teori ekonomike të njohura, të cilat derivojnë konceptin e modelit të gravitetit.

Lucie Davidová¹⁸ në punimin e tij tregon se si autorët:

- Anderson dhe Van Wincoop 2001 shmangën dobësitë dhe zhvilluan një teori të re të mikrobazës. Në punimin e tyre të përbashkët autorët argumentojnë se tregtia bilaterale përcaktohet nga kostot relative të tregtisë dhe rezistenca e tregtisë

¹⁷ Lucie Davidová,(2011), Determinants of Austrian International Trade, faqe 5

¹⁸ Lucie Davidová,(2011), Determinants of Austrian International Trade, faqe 6

multilaterale mund të zgjidhet duke përdorur efektet fikse për importet dhe eksportet.

- Bergstrand (1985, 1989) vazhdoi të zhvillonte derivimin teorik të modeleve të gravitetit bazuar në modelin e konkurrencës monopolistike.
- Helpman dhe Krugman (1985, 1990) derivuan ekuacionin e gravitetit bazuar në qasjen e rritjes së të ardhurave të shkallës.
- Deardorff (1998), provoi koherencën e tij me teori të përbashkëta tregtare dhe përafrimin e faktorit ndihmës bazuar në modelin Heckscher-Ohlin.
- Cieslik (2009) përpunoi modelet e specializimeve të papërfunduara dhe Novy (2010) punoi në kuadër të mikrobazës së ekuilibrit të përgjithshëm.

Ekuacioni i gravitetit mund të provohet nga teoria e Heckscher-Ohlin e cila lidhë teorinë e gravitetit me teorinë ekonomike

Popullaritetin me të lartë modeli i gravitetit e ka pasur në vitet 1990. Modeli i gravitetit u bë shumë i përdorshëm dhe një mjet i besueshëm për tregtinë e jashtme në vitet 1990. Për më tepër, modeli i gravitetit u përdorej për të vlerësuar impaktin antarësimit në një organizatë

2.6.2 Ekuilibri i përgjithshëm.

Adeem Khan¹⁹ shkruan: kontributet e hershme që u ndoqën nga studiues të rinj, të cilët tentonin të derivonin ekuacionin e gravitetit nga modelet ekzistuese ishin, Anderson (1979) në kontekstin e modelit ku produktet janë të diferencuara dhe konsumatorët kanë preferenca të shfaqura për të gjithë llojet e produkteve, zhvilloi një teori që mbështetej tek modeli i gravitetit. Ai supozoi preferencat Coob Dauglas, me elasticitet konstant të zëvendësimit (CES)²⁰ dhe me supozimin se distanca është e vetmja kosto e tregtisë në keto kushte ekuacioni i gravitetit të Anderson ishte:

Ekuacioni 2.2

$$X_{ij} = \left[\frac{GDP_i * GDP_j}{\sum_{j=i}^N GDP_j} \right] * \frac{1}{f(dis\ tan\ ce_{ij})} * \left[\left(\sum_{j=i}^N \frac{GDP_j}{GDP_w} \right) \left(\frac{1}{f(dis\ tan\ ce_{ij})} \right) \right]^{-1}$$

Ku: $f(distanca)_{ij}$ përfaqëson koston e tregtisë dhe GDP_w përfaqëson GDP-në botërore. Ekuacioni 2.2 duket njësoj si ekuacioni 2.1, përveç faktit se ekuacioni 2.2 ndërlikohet se përfshin preferencat CES. Struktura e mësipërme jep një përfundim i cili komenton se: sado që të jenë çmimet, një vend do të konsumojë disa nga të mirat dhe shërbimet e çdo shteti, që do të thotë se kemi tregti dypalëshe me çdo vend të botës.

¹⁹ Adeem Khan, Empirical Investigation of International Trade Using Gravity Models with Gravitass, 2011, faqe 14

²⁰ CES, mat përqindjen e ndryshimit të faktorëve të prodhimit për shkak të ndryshimit në përqindje të normës teknike të zëvendësimit (MRTS).

Të gjitha të mirat do të tregtoheshin, të gjithë vendet tregtojnë dhe në ekuilibër të ardhurat nacionale llogariten si shumë e kërkesës agregate të brendëshme dhe të jashtme për çdo produkt unik që vendet prodhojnë.

Për këtë arsye, sipas kësaj teorie, vendet e mëdha importojnë dhe eksportojnë më shumë. Por sipas Khan (2011) teoria e Anderson ka limitet e veta, sepse ky autor nuk merr parasysh çmimet e ndryshme. Mungesa e rëndësisë së çmimeve tek Anderson motivoi një autor tjetër pohon Khan, Bergstrand (1985) i cili zhvillojë këtë teori duke përfshirë dhe indeksat e çmimeve²¹. Sipas Khan, Bergstrand zbuloi se indeksat e çmimeve do të ndikonin në tregtinë dypalëshe, ai supozoi se prodhuesit brenda vendit operonin në strukturën e tregut të konkurrencës monopolistike²² dhe në këtë mënyrë do të kishim diferencim produkti, jo vetëm ndërmjet vendeve, por edhe ndërmjet firmave. Pavarësisht nga këto kontribute, disa nga ekonomistët shfaqën mungesën e gadishmërisë për ta zhvilluar ekuacionin e gravitetit, sepse ata mendonin se ky ekuacion është derivat i teorive klasike.

Sipas Adeem Khan, deri në vitin 2003 ekonomistët bazoheshin vetëm tek gjetjet e Anderson (1979) dhe Bergstrand (1985) dhe shumica e këtyre studiuesve e injoronin rolin e çmimeve në tregtinë ndërkombëtare, siç dhe mund të përmendim punimin e Mc Callun (1995). Një kontribut të qenësishëm në zhvillimin e këtij modeli, ka dhënë Anderson dhe Wincoop në një punim ku nënvizohet rëndësia e kostove relative të tregtisë. Teoria e tyre jep një konkluzion se tregtia dypalëshe ndikohet nga kostot relative të tregtisë, prirjet e vendit “j” për të importuar nga vendi “i” ndikohen nga kostot e tregtisë ndërmjet “i” dhe “j”. Ekuacioni i tyre i gravitetit merr formën e mëposhtme:

Ekuacioni 2.3

$$X_{ij} = \left(\frac{t_{ij}^{1-\sigma}}{P_i^{1-\sigma} * P_j^{1-\sigma}} \right) * \left(\frac{GDP_i * GDP_j}{GDP_w} \right)$$

Ku σ përfaqëson elasticitetin e zëvendësimit ndërmjet të mirave ose shërbimeve, t_{ij} përfaqëson koston e tregtisë dypalëshe ndërmjet vendit “i” dhe “j”, “ P_i ” dhe “ P_j ” përfaqëson rezistencën multilaterale të brendshme dhe të jashtme, pra respektivisht rezistenca mesatare, që përballen eksportuesit dhe rezistenca mesatare, që përballen importuesit.

Dy rezultatet kryesore që dalin nga punimi i autoreve sipas Khan janë:

Së pari: hyrja e një indeksi të ri si MRS²³ ndihmon në shpjegimin e importeve dhe eksporteve.

Së dyti: për të matur sa më mirë ekuilibrin e përgjithshëm, kërkohet të llogaritet MRS për çdo vend apo rajon përpara dhe pas ndryshimit të t_{ij} .

Sidoqoftë “ p_i ” dhe “ p_j ”, janë të pamatshme dhe të vështira për t’u stimuluar në botën reale.

²¹ Shih ekuacionin 12, tek Bergstrand 1985.

²² Një strukturë tregu me shumë firma, produkt të diferencuar dhe që nuk ka pengesa të hyrjes në treg.

²³ Rezistenca multilaterale.

2.6.3 Zhvillimet e fundit të modelit të gravitetit.

Një çështje e rëndësishme, që ka marrë vëmendje të vazhdueshme në rezultatet empirike dhe teorike të modelit të gravitetit, është evidenca se rreth 50% e të gjithë vendeve nuk tregtojnë me njëri-tjetrin, gjithashtu tregtia dypalëshe nuk është simetrike²⁴.

Sipas Adeem Khan; në punimin e fundit të Helpman (2008) autori argumenton se duke mos marrë parasysh vendet të cilat nuk tregtojnë me të tjerët, ne marrim vlerësues të njëanshëm në rezultatet empirike. Që të korrigjohet ky problem është zhvilluar një teori e re që parashikon tregti pozitive ndërmjet vendeve. Ky model është një model i tregtisë së jashtme me produkt të diferencuar dhe me firma heterogjene, ku firmat përballen me kosto eksporti fikse dhe variabël²⁵.

Tregtia do të jetë zero ndërmjet vendit “i” dhe “j”, vetëm dhe vetëm, nëse produktiviteti i të gjitha firmave në vendin “i” është poshtë pragut që do ta bënte përfitues, nëse do të eksportonte me vendin “j”.

Adeem Khan (2011) eksploroj rolin e koeficientit të elasticitetit në modelin e gravitetit me firma heterogjene. Në këtë situatë modeli i gravitetit merr formën:

Ekuationi 2.4

$$X_{ij}^h = K * \left(\frac{GDP_i * GDP_j}{GDP_w} \right) * \left(\frac{t_{ij}}{P_j} \right)^{-\gamma} * f_{ij}^{-\left(\frac{\gamma}{\sigma-1}\right)}$$

ku x_{ij}^h përfaqëson eksportin nga vendi “i” drejt vendit “j” me sektor “h”

k është një konstante

f_{ij} kostot fikse të tregtisë

γ përfaqëson inversin e heterogjenitetit në sektorin “h”.

2.6.4 Aplikimi i modelit të gravitetit.

Modeli i gravitetit mbetet ende një nga mjetet më të përdorura në studimet empirike të tregtisë së jashtme me disa limitime. Modelet e gravitetit janë ekstremisht të suksesshme në modelet empirike gjykuar nga aftësia e këtij modeli për të shpjeguar variancat në tregtinë bilateral, Deardorff (1984)²⁶. Modeli i gravitetit ka mundur të shpjegojë , marrëveshjeve të tregtisë së lire, impaktit të kufijve të përbashkët, kurseve të këmbimit, distancës ndërmjet vendeve, masës ekonomike në flukset tregtare dhe variablave të tjerë që ndikojnë në tregëtinë dypalëshe.

²⁴ Shiko: Adeem Khan, Empirical Investigation of International Trade Using Gravity Models with Gravitas, 2011, faqe 19

²⁵ Flitet për një model ekonomik ku firmat në një industri nuk janë të njëjta, shiko Melitz (2003).

²⁶ p.468

2.6.5 Ndikimet e integritit.

Çdo lloj marrëveshje bilaterale ose multilaterale në të cilën vendet bien dakort të koordinojnë politikat e tyre monetare fiskale apo tregëtare, mund të konsiderohet si një marrëveshje të integritit ekonomik. Format e integritit janë:

- Marrëveshjet tregtare preferenciale (MTP²⁷),
- Zona e tregtisë së lirë (ZTL)²⁸,
- Bashkimi Doganor²⁹,
- Tregu i përbashkët³⁰,
- Bashkimi Ekonomik³¹
- dhe Bashkimi Monetar³².

Ekuacioni i gravitetit është përdorur për të parë impaktin e këtyre elementeve.

Janë disa autorë që kanë shpjeguar me anë të këtij modeli, impaktin e këtyre elementëve:

- Bayoumi dhe Eichengreen (1995),
- Frankel (1997),
- Sapir (1981),
- Bergstrand (1985),
- Brada dhe Mendez (1985),
- Bayoumi dhe Eichengreen (1995),
- Frankel (1997),
- Soloaga dhe Winters (2001).
- Soloaga dhe Winters (2001).
- Tinbergen (1962),
- Linnemann (1966),

Se si përfshihen keto variabla në model është pjesë e metodologjisë që do të trajtojmë në kapitujt në vijim.

2.6.6 Ndikimet e kurseve reale të këmbimit

Kursi i këmbimit konsiderohet si një nga konceptet më të rëndësishme ekonomike. Kursi i këmbimit shihet si tregues kyç i konkurrueshmërisë së një vendi, madje ai është konsideruar si treguesi më i besueshëm i konkurrueshmërisë në kontekstin Shqipëtar (FMN)³³. Humbja e konkurrueshmërisë, për shkak të një kursi të mbivlerësuar mund të ndikojë kërkesën agregate brenda vendit. Një kurs i këmbimit i mbivlerësuar mund të rrisë importet dhe e kundërta, duke ndikuar në strukturën e kërkesës agregate të vendit

²⁷ Në një MTP, vendet mund të aplikojnë reduktime tarifore, edhe pse jo eliminim të tyre, kundrejt një grupi vendesh partnere, në disa kategori produktesh.

²⁸ (FTA) Një zonë e tregtisë së lirë, ka si tipar kryesor eliminimin e pengesave tregtare midis vendeve anëtare, ndërkohë që secili prej këtyre vendeve zbaton një politikë të vetën të kufizimeve tregtare ndaj vendeve të treta

²⁹ Një bashkim doganor, ndodh kur një grup vendesh bien dakort të eliminojnë tarifatat ndërmjet tyre dhe të vendosin dhe zbatojnë një politikë të përbashkët tregtare ndaj vendeve të treta.

³⁰ Ka si tipar bazë, lirinë e plotë të lëvizjes së faktorëve (punës dhe kapitalit), midis vendeve anëtare.

³¹ Unifikimi i plotë i të gjitha politikave ekonomike të vendeve anëtare, si ato monetare, fiskale, tregtare, të migrimit të faktorëve të prodhimit.

³² Ka të bëjë me vendosjen dhe aplikimin e një monedhe të përbashkët përkrah një grup shtetesh.

³³ Raporti, 2003, fq.5

dhe ekonomia do të përballlet me problemin e defiçitit të llogarisë korrente, sepse eksportet neto do të bien.

2.6.7 Infrastruktura.

Disa autore nënvizojnë rëndësinë e infrastrukturës në tregtinë ndërkombëtare, ata dalin në përfundimin se duke ulur renditjen e infrastrukturës kjo sjell rritjen e kostove të tregtisë dhe redukton volumin tregtar. Gjithashtu është trajtuar gjerësisht rolin e kohës³⁴ si pengesë për tregtinë. Autorë të tjerë, të cilët mbështesin infrastrukturën si një faktor që ndikon në flukset tregtare, janë:

- Donaldson (2009),
- Francois dhe Manchin (2007),
- Grigoriou (2007),
- Shepherd dhe Wilson (2007)

2.6.8 Tregtia dhe rritja ekonomike.

Sipas Adeem Khan³⁵, modelet e gravitetit kanë gjetur përdorim, gjithashtu, për të egzaminuar efektet e tregtisë në rritjen ekonomike. Duhet vënë në dukje se tregtia dhe të ardhurat për frymë janë të vendosur në të njëjtën kohë dhe të vlerësosh koeficientet bazuar në të ardhurat për frymë dhe potencialit tregtar, na shfaq problemin e endogjenitetit³⁶. Problemin e endogjenitetit e vërtetuan Frankel dhe Romer (1999).

Badinger (2008) në vazhden e punimeve të Frankel dhe Romer, vërtetuan se tregtia e lirë ndikon në të ardhurat për frymë.

2.6.9 Të tjera.

Përveç aplikimeve të modelit të gravitetit të përmendura më sipër, është përdorur për të ekzaminuar efektet në probleme të tjera, në tregtinë ndërkombëtare.

Që nga 1960 modeli i gravitetit ka evoluar. Kjo nënkupton se së bashku me variablat “bazë” të përmendura më sipër, janë përdorur faktorë të tjerë duke përfshirë: afërsinë, lidhjet e përbashkëta koloniale, monedhën e përbashkët, fazën e integritetit (zonën e tregtisë së lirë, marrëveshjet e konkurrencës, etj), treguesit institucionale si efektiviteti i qeverisë, indeksi i korrupsionit, indeksi i edukimit dhe ai fiskal, monetar, treguesi i biznesit ose i tregtisë së lire.

Ekuacioni gravitetit është përdorur gjerësisht nga autoret. Summary (1987), Pollins (1989), Van Bergijk dhe Oldersma (1990), Gowa dhe Mansfield (1993) të cilët kanë aplikuar modelin e gravitetit në politikë.

Kufiri i përbashkët (shtete fqinje) ato tregtojnë më shumë ndërmjet tyre, kryesisht kostot e shitblerjeve midis tyre mund të reduktohen për shkak të afërsisë fizike.

³⁴ Koha e qëndrimit të mallrave në porte, aeroporte, dogana etj.

³⁵, Empirical Investigation of International Trade Using Gravity Models with Gravitas, 2011: faqe 35

³⁶ Në modelet statistikore, një parametër ose variabël është e thënë të jetë e endogjen kur ekziston një korrelacion midis parametrit apo variablit me termin e gabimit.

Nëse shtetet kanë qënë pjesë e të njëjtit territor politiko- administrativ (si për shembull ish-Çekosllovakia apo ish-Jugosllavia) ka gjasa që përgjatë historisë së tyre të përbashkët këto vende të kenë ndërtuar lidhje tregtare, të cilat stimulojnë flukse të larta tregtare ndërmjet tyre.

Gjuha e përbashkët është gjithashtu një variabël që përdoret gjerësisht në këto modele si variabël dummy. Shtetet me gjuhë të përbashkët janë të prirura të tregëtojnë më shumë se të tjerat për shkak të lehtësisë në komunikim.

Këto janë përfshirë me qëllim për të përcaktuar një rang më të gjerë të barrierave tregtare ose kostove të transaksionit. Në modelin e kapitujve në vijim do të përfshihen disa variabla shtesë.

2.7 Studimet e fundit të tregtisë së jashtme në Shqipëri duke përdorur modelin e gravitetit.

- Alban Pllaha ne studimin e tij *“Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë dhe Integrimi Tregtar midis Vendeve të Evropës Juglindore; Vlerësime të Modelit të Gravitetit”* 2012, ka bërë një vlerësim të flukseve tregtare ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore (EJL-9), duke përfshirë dinamikën në një model graviteti të të dhënave në panel.

Sipas tij modeli prodhoi rezultate të qëndrueshme (në terma të diagnostikimit statistikor), duke nënvizuar se tregtia në të kaluarën kontribuon pozitivisht në flukset tregtare aktuale dhe të ardhshme. Në përputhje me literaturën mbi modelet e gravitetit për tregtinë, Pllaha sugjeron se tregtia ndikohet pozitivisht nga GDP-ja, MTL-të, Lidhjet Koloniale dhe nga Fqinjësia. Flukset tregtare rezultojnë se ndikohen negativisht nga distanca fizike ndërmjet vendeve. Gjetjet e tij sugjerojnë se MTL-të kanë kontribuar pozitivisht në integrimin tregtar rajonal, edhe pse materiali del në përfundimin se pjesa më e madhe e vendeve të EJL-9 tregtojnë nën potencialin e tyre.

- Endrit Yzeiraj ne studimin e tij *“Ndikimi i tregtisë mbi rritjen ekonomike: Një model i bazuar në instrumentet e gravitetit për Europën post- komuniste”* 2013, ka përdorur modelin e gravitetit për të parashikuar tregtinë dhe për të analizuar efektin e saj në rritjen ekonomike. Në këtë punim Yzeiraj arrin në përfundimin se në vendet komuniste hapja e kufijëve bën më të rëndësishëm efektin e distancës, gjithashtu vendet me fqinjët e pasur mund të përfitonin më shumë.
- Soana Jakupllari ne studimin e saj *“Tregtia e jashtme dhe zhvillimi ekonomik në ndikimin e proceseve liberalizuese. Rasti i Shqipërisë”* ka përdorur modelin e gravitetit për të vlerësuar ndikimin e liberalizimit tregtar dhe faktorëve të tjerë, në flukset e importeve të Shqipërisë. Sipas Jakupllarit impakti i politikës së liberalizimit tregtar në importet tona është i ndjeshëm. Kërkesa për importe në rastin tonë, reagon fort ndaj uljes së tarifës mesatare, pra shkallës së liberalizimit tregtar.
- Pranvera Kastrati në studimin e saj *“Sfidat tregtare të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin European”* 2015, ka bërë një vlerësim të ndikimit që anëtarësimi në

Bashkimin Evropian ka në politikën tregtare shqiptare, flukset tregtare dhe transformimin e rolit të institucioneve.

2.8 Tregtia e jashtme e Shqipërisë.

Zhvillimet e tregtisë së jashtme përbejnë një komponent të rëndësishëm të zhvillimeve të përgjithshme ekonomike në tërësi dhe të sektorit të jashtëm në veçanti. Tregtia e jashtme është, veçanërisht, me rëndësi kritike për ekonominë e dimensioneve të vogla si vendi ynë.

Tregtia e jashtme e Shqipërisë në vitet e fundit është karakterizuar, në përgjithësi, nga ndryshime thelbësore, duke shkuar drejt liberalizimit, për rrjedhojë, duke sjellë ndryshime edhe në treguesit kryesorë të saj. Ekonomia shqipëtare vitet e fundit ka mundur të sigurojë stabilitet nga pikëpamja e treguesve makro-ekonomikë edhe gjatë periudhës së krizës ekonomike globale.

Ecuria e mirë e eksporteve dhe importeve luan një rol të rëndësishëm në prespektivën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së vendit, si dhe në bilancin tregtar, me qëllim që t'i bëjë ballë edhe konkurrencës ndërkombëtare. Ritmi i rritjes së eksporteve në vite është një tregues i rëndësishëm, mbi ecurinë e të cilit mund të gjykojmë për stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e ekonomisë në përgjithësi, si dhe të aftësisë së saj për të konkurruar në tregjet ndërkombëtare, por që reflekton në mënyrë direkte dhe shumë të ngushtë edhe konjunkturën ndërkombëtare.

Në vijim të kësaj çështje analiza e eksporteve dhe importeve shqipëtare është e bazuar në të dhënat nga INSTAT me të dhëna që përfshijnë periudhën 2000-2014.

2.8.1 Vështrim i përgjithshëm.

Shqipëria, nga një shtet me ekonomi të centralizuar, është në fazën e një tranzicioni të vështirë drejt një ekonomie moderne. Shqipëria arriti të menaxhonte në kohë valët e para të krizës financiare globale, por, së fundmi, efektet e saj negative kanë vënë nën presion ekonominë shqipëtare. Ndërkohë që qeveria është fokusuar në vendosjen e një klime të favorshme për bizneset përmes thjeshtimit të kërkesave të liçensimit dhe kodeve të taksave, ajo ka nënshkruar një marrëveshje të re me FMN³⁷ mbështetje financiare dhe teknike. Remitancat³⁸, një katalizator i rëndësishëm për rritjen ekonomike, ranë nga 12-15% e GDP para krizës financiare të 2008 në 7% të GDP në 2012, shumica nga shqiptarët që banojnë në Greqi dhe Itali. INSTAT (2000-2014.)

Sektori agrikulturor, i cili numëron të paktën gjysmën e punësimit, por vetëm 1/5 e GDP, është i limituar kryesisht tek familjet e vogla dhe bujqesia ekzistenciale, për shkak të mungesës së pajisjeve moderne, të drejtat pronësore të paqarta dhe prevalenca e vogël, parcelat e tokës joefikase. INSTAT (2000-2014.)

Kodet komplekse të taksave dhe kërkesat për liçensime, një sistem juridik i dobët, zbatimi i dobët i kontratave dhe çështjeve pronësore dhe infrastruktura e vjetëruar të kontribuojnë në mjedisin e dobët të biznesit në Shqipëri dhe e bën tërheqjen e

³⁷ FMN, Fondi Monetar Ndërkombëtar

³⁸ Të ardhurat e emigrantëve

investimeve të huaja më të vështira. IHD e brendëshme është ndër më të ultat në rajon, por qeveria ka nisur një program ambicioz për të përmirësuar klimën e biznesit nëpërmjet reformave fiskale dhe legislative. Furnizimi me energji i Shqipërisë është përmirësuar në vitet e fundit, kryesisht për shkak të kapaciteteve transmetuese të rinovuara që Shqipëria ka zhvilluar me vendet fqinje. Megjithatë humbjet teknike dhe joteknike duke përfshirë vjedhje të energjisë dhe mospagesës, vazhdojnë të jenë një kërcënim për qëndrueshmërinë financiare të të gjithë sistemit. Gjithashtu, me ndihmën e donatorëve ndërkombëtarë, qeveria po ndërmerr hapa për të përmirësuar rrjetin e dobët kombëtar rrugor dhe hekurudhor, një barrierë e gjatë në këmbë për rritje të qëndrueshme ekonomike. Vendi do të vazhdojë të përballët me sfida nga rritja e borxhit publik, duke tejkaluar ish kufirin e saj ligjor prej 60% të GDP-së në vitin 2013. Tregti të fortë, remitancat dhe lidhjet e sektorit bankar me Greqinë dhe Italinë e bëjnë Shqipërinë të ndjeshme ndaj efekteve të përhapjes së krizave të borxhit dhe të dobët nga rritja në zonën e euros. INSTAT (2000-2014.)

Në tabelat e mëposhtme paraqiten disa tregues kryesorë makroekonomikë të Shqipërisë në disa vite.

Tabela 2.1: Pariteti i fuqisë blerëse për periudhat 2011, 2012 dhe 2013

GDP – pariteti i fuqisë blerëse	\$28.34 billion (2013)
	\$28.14 billion (2012)
	\$27.78 billion (2011)

Burimi: Albania Economy Profile 2014 - IndexMundi³⁹

Tabela 2.2: Rritja reale për periudhat 2011, 2012 dhe 2013

GDP – rritja reale	0.7% (2013)
	1.3% (2012)
	3.1% (2011)

Burimi: Albania Economy Profile 2014 - IndexMundi

Tabela 2.3: GDP per fryme për periudhat 2011, 2012 dhe 2013

GDP – për frymë	\$10,700 (2013)
	\$10,400 (2012)
	\$9,900 (2011)

Burimi: Albania Economy Profile 2014 - IndexMundi

Tabela 2.4: Norma e papunësisë për periudhat 2012 dhe 2013

³⁹ http://www.indexmundi.com/albania/economy_profile.html

Norma e papunësisë	16.9% (2013.) 14.4% (2012.)
--------------------	--------------------------------

Burimi: Albania Economy Profile 2014 - IndexMundi

Tabela 2.5: Buxheti për vitin 2013

Buxheti	Të ardhurat: \$3.074 billion Shpenzimet : \$3.858 billion (2013)
---------	---

Burimi: Albania Economy Profile 2014 - IndexMundi

Tabela 2.6: Borxhi publik për periudhat 2012 dhe 2013

Borxhi publik	70.5% e GDP (2013) 62.5% e GDP (2012)
---------------	--

Burimi: Albania Economy Profile 2014 - IndexMundi

Tabela 2.7: Inflacioni për periudhat 2011, 2012 dhe 2013

Inflacioni	1.7% (2013) 2.1% (2012)
------------	----------------------------

Burimi: Albania Economy Profile 2014 - IndexMundi

Zhvillimet në tregtinë e jashtme mund të kenë implikime mjaft të rëndësishme, veçanërisht për ekonominë e vogla dhe ato të liberalizuara relativisht vonë. Për këtë arsye tendencat e tyre ndiqen me vëmendje nga politikëbërësit në fushën e ekonomisë.

Për vetë rolin që ka sektori i jashtëm në zhvillimin e ekonomisë së vendit, reformimi i politikës tregtare përbënte që në fillim të tranzicionit një aspekt të rëndësishëm të kuadrit të politikave ekonomike të Shqipërisë.

Ky reformim synonte liberalizimin e tregtisë dhe përafrimin e legjislacionit të tregtisë me jashtë me normat e standartet ndërkombëtare. Evoluimi i politikave tregtare përgjatë gjithë periudhës së tranzicionit shënon edhe një riorientim të saj nga një politikë tregtare me dimension fiskal në një politikë ku spikat dimension i zhvillimit.

Një nga tiparet thelbësore të politikës tregtare konsistoi në reduktimin gradual të niveleve të tarifave doganore. Që nga viti 1994 niveli i tarifave për mallrat e importuara është ulur vazhdimisht, duke treguar edhe një herë se Shqipëria aktualisht aplikon një regjim tregtar të hapur dhe liberal. Për më tepër, zhvillimet në politikën e regjimit tregtar këto vitet e fundit, janë bërë më dinamike edhe si pasojë e intensifikimit të procesit të integritetit tregtar dhe ekonomik, parë në të gjitha këndvështrimet (multilateral, europian dhe rajonal).

2.8.2 Tregtia e mallrave për periudhën 2000 – 2014

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave janë një instrument shumë i rëndësishëm për marrësit e vendimeve në sektorët publik dhe privat. Ato ndihmojnë në përgatitjen e bisedimeve bilaterale dhe multilaterale në kuadrin e politikave tregtare dhe për vlerësimin e ekonomive të tregut. Ato ndihmojnë gjithashtu kompanitë në studimin e tregut dhe në përcaktimin e strategjive të tyre tregtare.

Sipas INSTAT Gjatë periudhës 14-vjeçare (2000-2014) vihet re që trendi ka qënë në rritje për eksportet, ndërsa për importet ka qënë me luhatje (ulje dhe ngritje). Vërehet një rritje mesatare vjetore e eksporteve me 15.53 %. Në rastin e importeve kemi një ritëm rënës në vitet 2009, 2012-2013 dhe rritës në vitet e tjera. Për periudhën 2000-2014, Rritja mesatare vjetore është 9.71 %. Defiçiti tregtar është përmirësuar, duke shënuar ulje mesatare vjetore me 7.24 %.




Figura 2.2: Exuria e eksporteve, importeve dhe bilancit tregtar në million lekë për periudhën 2000-2014.

Burimi: INSTAT,

Në vitin 2014 vërehet një rritje vjetore prej 3,8 % në eksporte, 6,7 % në importe dhe defiçiti tregtar u rrit rreth 9,4 %. Eksportet mbuluan 46,3 % të importeve, ndërsa një vit më parë ky tregues ishte 47,6 %. Nga figura 2.2 ne shohim se kemi një rënie të defiçitit tregtar vetëm në periudhat 2009-2010 dhe 2012-2013. Eksportet mbuluan për këto periudha 24.4%, 33.8% dhe 40.3%, 47.6% të importeve duke bërë kështu të mundur rënien e defiçitit tregtar (shih figurën 2.3 dhe tabelën 2.8).

Vitet 2009, 2010, 2012 dhe 2013 janë të vetmet vite në periudhën kohore 2000-2014 të cilat kontribuojnë në rënien e defiçitit tregtar. Për tu theksuar është fakti se në vitin 2013 kemi një rënie të defiçitit tregtar me 14.1%, e cila pasohet me një rritje 9.4% në vitin 2014.




Figura 2.3: Exuria e eksporteve, importeve dhe bilancit tregtar në përqindje për periudhën 2000-2014.

Burimi: INSTAT, llogaritjet e autorit

Tabela 2.8 Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme në million lekë

	Eksporte	Importe	Bilanci tregtar	Përqindja e mbulimit
2000	37,037	157,109	-120,072	23.6
2001	44,096	190,155	-146,059	23.2
2002	47,490	210,368	-162,877	22.6
2003	54,487	225,983	-171,496	24.1
2004	62,121	236,072	-173,951	26.3
2005	65,818	262,191	-196,373	25.1
2006	77,405	299,147	-221,742	25.9
2007	97,171	376,194	-279,023	25.8
2008	112,572	439,894	-327,322	25.6
2009	104,515	428,839	-324,324	24.4
2010	161,548	477,768	-316,220	33.8
2011	196,897	544,004	-347,107	36.2
2012	213,030	528,490	-315,460	40.3
2013	246,391	517,378	-270,987	47.6
2014	255,759	552,279	-296,520	46.3

Burimi: INSTAT,

2.8.3 Eksporti i mallrave sipas vendeve kryesore.

Në periudhën 2000-2014 harta e eksporteve shqipëtare duket se është diversifikuar ndjeshëm.

Nga tabela 2.9 ne shohim se në vitin 2000 partnerët kryesorë të eksporteve shqipëtare janë Italia me 71.34%, Greqia me 12.76% dhe Gjermania me 6.47%. Më tej, në strukturën e eksporteve në vitin 2000 për nga pesha, vijnë Serbia dhe Mali i zi, Danimarka etj.

Në vitin 2005 partneri me peshën më të madhe në eksportet me Shqipërinë është Italia e cila zë 72.44 %. Partneri i dytë tregtar në eksporte për vitin 2005, është Greqia e cila zë 10.46 % të eksporteve. Eksportet me Kosovën gjatë vitit 2005 zënë 4.12 % të eksporteve. Partneri i katërt tregtar për nga pesha e eksporteve është Gjermania e cila zë 3,32 % të eksporteve gjithsej në vitin 2005. Më tej, në strukturën e eksporteve në vitin 2005 për nga pesha, vijnë Turqia, Maqedonia etj.

Gjatë periudhës 2010-2014, eksportet në vlerë kanë shënuar rritje të konsiderueshme drejt Italisë, Greqisë, Kosovës dhe Turqisë. Në vitin 2014 eksportet me Italinë zunë 52 % të eksporteve nga 50,8 % që zinin në vitin 2010; me Kosovën zunë 7,3 % të eksporteve nga 6,2 % që zinin në vitin 2010; me Spanjën zunë 6,5 % të eksporteve nga 3,5 % që zinin në vitin 2010; me Greqinë zunë 3,5 % të eksporteve nga 5,4 % që zinin në 2010.

Gjatë kësaj periudhe eksportet me Italinë janë rritur pothuajse në të gjitha grupet e mallrave. Peshën më të madhe e zënë grupet: “Tekstile dhe këpucë” dhe “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike”. Eksportet shqipëtare drejt Kosovës janë përqëndruar në grupmallrat “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” dhe “Materiale ndërtimi dhe metale”. Eksportet drejt Spanjës janë gjithashtu të dominuara nga “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike”. Eksportet drejt Greqisë janë të përqëndruara tek grupet: “Tekstile dhe këpucë”, “Ushqim, pije dhe duhan” dhe “Materiale ndërtimi dhe metale”.

Tabela 2.9: Partnerët kryesorë të eksporteve shqipëtare për periudhat 2000, 2005, 2010 dhe 2014.

2000		2005		2010		2014	
Partnerët e	% e eksporteve	Partnerët e	% e eksporteve	Partnerët e	% e eksporteve	Partnerët e	% e eksporteve

Italia	71.34%	Italia	72.44%	Italia	50.83%	Italia	52.02%
Greqia	12.76%	Greqia	10.46%	Kosovë	6.20%	Kosovë	7.34%
Gjermania	6.47%	Kosovë	4.12%	Turqia	5.93%	Spanja	6.52%
Serbi & Mali i zi	2.11%	Gjermania	3.32%	Greqia	5.41%	Malta	6.22%
Danimarka	1.04%	Turqia	1.72%	Zvicra	4.14%	Turqia	3.95%
SHBA	0.90%	Maqedonia	1.57%	Spanja	3.46%	Greqia	3.46%
Maqedonia	0.87%	SHBA	1.00%	Gjermania	2.75%	Gjermania	2.82%
Franca	0.76%	Serbi & Mali i zi	0.84%	Maqedonia	1.65%	Maqedonia	2.07%
Austria	0.69%	Franca	0.69%	SHBA	1.47%	Mali I Zi	1.38%
Turqia	0.66%	Të tjera	0.57%	Serbi	1.21%	Franca	1.08%

Burimi: INSTAT,

Ndërsa për sa i përket grup vendeve në vitin 2014 eksportet me vendet e BE zënë 77,4 % të eksporteve duke u rritur 4,8 %, krahasuar me një vit më parë; ndërsa eksportet me vendet e CEFTA (Maqedonia, Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina, Serbia, Kosova dhe Moldavia) zënë 11,6 % të eksporteve duke u rritur 12,3 % krahasuar me një vit më parë.

2.8.4 Importi i mallrave sipas vendeve kryesore.

Në vitin 2014, partneri që zë peshën më të madhe në importe është Italia me 29,8 % të importeve, nga 32,9 % që ishte në vitin 2013. Partneri i dytë në importe është Greqia me 9,4 % të importeve, nga 8,8 % që ishte në vitin 2013. Kina, është partneri i tretë tregtar për sa i përket peshës në importe me 7,3 % të totalit në vitin 2014 nga 6,8 % që ishte në vitin 2013 e ndjekur nga Turqia me 7,1 % të importeve në vitin 2014 nga 6,4 % që ishte në vitin 2013. Në strukturën e importeve në vitin 2014, partnerët me peshën më të madhe vijojnë, Gjermania me 6 %, Serbia me 4,3 %, Zvicra me 3,1 %, SHBA me 2,4 % etj.

Sipas tabelës 2.10. Italia, Greqia, Gjermania dhe Turqia mbeten partneret kryesore të importeve shqipëtare për periudhën 2000-2014.

Pesha e importeve nga Italia ka vijuar të rritet përgjatë këtij harku kohor 2010-2014, duke arritur në 29,8 % më 2014 nga 28,2 % e importeve gjithsej që ishte në vitin 2010. Kurse importet nga Greqia kanë ardhur duke u ulur nga 13,1 % që ishte në vitin 2010, në 9,4 % në vitin 2014.

Tabela 2.10: Partnerët kryesorë të importeve shqipëtare për periudhat 2000, 2004, 2008 dhe 2014.

2000		2005		2010		2014	
partnerët	% e importeve	partnerët	% e importeve	partnerët	% e importeve	partnerët	% e importeve
Italia	35.16%	Italia	29.28%	Italia	28.17%	Italia	29.77%
Greqia	26.41%	Greqia	16.43%	Greqia	13.11%	Greqia	9.43%
Gjermania	6.09%	Turqia	7.48%	Turqia	5.66%	Turqia	7.06%
Turqia	5.35%	Gjermania	5.46%	Gjermania	5.60%	Gjermania	5.97%
Bullgaria	2.38%	Rusia	4.03%	Serbi	3.71%	Serbi	4.28%
Maqedonia	2.18%	Ukraina	2.86%	Rusia	2.19%	Zvicra	3.05%
Rusia	1.76%	Bullgaria	2.80%	Franca	2.18%	SHBA	2.42%
Franca	1.50%	Austria	1.74%	Kroacia	1.92%	Rusia	2.11%
SHBA	1.46%	Spanja	1.69%	Bullgaria	1.78%	Franca	1.94%
Sllovenia	1.25%	SHBA	1.43%	Austria	1.60%	Spanja	1.74%

Burimi: INSTAT

Në vitin 2014 importet nga vendet e BE zënë 61,1 % të importeve duke u rritur 1,4 %, krahasuar me një vit më parë; ndërsa importet nga vendet e CEFTA zënë 7,9 % të importeve duke u rritur 25 %, krahasuar me një vit më parë.

2.8.5 Grupmallrat më të eksportuar.

Katër produktet që dominonin më tepër eksportet shqipëtare për vitin 2000 ishin të mirat e konsumit, tekstile dhe veshje, mallrat e ndërmjetme dhe këpucë. Ndërsa për vitin 2013 më të eksportuara janë grupet e produkteve: “Produkte minerale” me 40,3 %, “Tekstilet dhe artikujt prej tyre” me 14,4 %, “Metale bazë dhe artikujt prej tyre” me 14,2 % dhe “Veshjet e këmbëve” me 13,7 % të eksporteve.⁴⁰

Produktet që dominonin më tepër eksportin shqipëtar për periudhën 2005-2009 ishin riekportet nga përpunimi aktiv i produkteve tekstile dhe këpucët. Në vendin tonë ka shumë ndërmarrje “fason”, gjë që shpjegon edhe sasinë e madhe të produkteve tekstile dhe të këpucëve që eksportoreshin në këto vite.

Produktet që dominojnë më tepër eksportet shqiptare për periudhën 2009-2011 janë eksportet nga përpunimi aktiv i produkteve tekstile dhe këpucët. Ndërsa në vitet 2012-2013 vihet re një ulje e eksporteve të këtyre produkteve, duke patur rritje në grupet e produkteve minerale për shkak të rritjes së eksportit të xeherorëve të kromit.

Tabela 2.11: Grupmallrat më të eksportuar për periudhat 2000, 2004, 2008 dhe 2013

2000		2004		2008		2013	
Eksporti FOB	në përqindje ndaj totalit	Eksporti FOB	në përqindje ndaj totalit	Eksporti FOB	në përqindje ndaj totalit	Eksporti FOB	në përqindje ndaj totalit
Tekstile dhe këpucë	64.99	Tekstile dhe këpucë	60.94	Tekstile dhe këpucë	43.36	Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	40.35
Ushqime, pije, duhan	10.32	Materiale ndërtimi dhe metale	14.66	Materiale ndërtimi dhe metale	19.98	Tekstile dhe këpucë	28.15
Materiale ndërtimi dhe metale	8.62	Ushqime, pije, duhan	8.16	Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	18.07	Materiale ndërtimi dhe metale	14.69
Prodhime druri dhe letre	3.71	Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	4.10	Ushqime, pije, duhan	6.41	Ushqime, pije, duhan	5.95
Të tjera	3.59	Makineri, pajisje dhe pjesë	3.94	Makineri, pajisje dhe pjesë	4.07	Makineri, pajisje dhe pjesë	3.35

⁴⁰ INSTAT, tregtia e jashtme _2013

		këmbimi		këmbimi		këmbimi	
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	3.23	Prodhime druri dhe letre	2.75	Prodhime druri dhe letre	3.21	Prodhime druri dhe letre	3.25
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	2.70	Të tjera	2.56	Të tjera	2.31	Të tjera	1.80
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1.93	Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.21	Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.54	Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.30
Produkte kimike dhe plastike	0.91	Produkte kimike dhe plastike	0.69	Produkte kimike dhe plastike	1.05	Produkte kimike dhe plastike	1.17

Burimi: INSTAT

Për vitin 2014 më të eksportuara janë grupet e produkteve: “Produkte minerale” me 33,6 %, “Veshjet e këmbëve” me 16,9 % “, Tekstilet dhe artikujt prej tyre” me 16,7 % dhe “Metale bazë dhe artikujt prej tyre” me 14,2 % të eksporteve.

2.8.6 Grupmallrat më të importuar.

Në vitin 2000 importi është dominuar nga grupmallrat “ushqime, pije, duhan”, “minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” dhe “produkte kimike dhe plastike” duke zënë respektivisht 22.26%, 13.22% dhe 8.55%. Në vitin 2004 kemi një konfigurim të ri të grupmallrave të importuara në përqindje ndaj totalit ku dominojnë importet e makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi me 23.63% duke u rritur me 10.41% nga viti 2000. Në vitin 2009 importi është dominuar nga grupmallrat “makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” dhe “ushqim, pije duhan” duke zënë respektivisht 22.8 përqind dhe 17.3 përqind të importit gjithsej. Në importin e produkteve bujqësore vlera e importit të grupit të zarzavateve u rrit me 3.9 përqind në vitin 2009, krahasuar me një vit më parë. Ndërsa importi grupit të frutave u rrit me 21 përqind në vitin 2009, krahasuar me të njëjtën periudhë.

Në vitin 2011 importi është dominuar nga grupmallrat “makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” dhe “ushqim, pije, duhan” duke zënë respektivisht 20.2 përqind dhe 16.9 përqind të importit gjithësej. Në importin e produkteve bujqësore vlera e importit të grupit të zarzavateve u ul me 23.5 përqind në vitin 2011, krahasuar me një vit më parë. Ndërsa importi grupit të frutave u ul me 14 përqind në vitin 2011, krahasuar me të njëjtën periudhë.

Grup produktet që dominojnë më tepër importin gjithsej për periudhën 2013 janë: makineri, pajisje mekanike dhe elektrike”, “ushqime, pije, duhan” dhe “minerale, lëndë djegëse, energji elektrike. Për vitin 2013 këto grup produktesh zunë respektivisht 19,4 %, 18,06 % dhe 17,91 % të importit gjithsej. Grup-produktet më të importuara në vend për periudhën 2000-2013 janë: “ushqim, pije, duhan” dhe “makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi”.

Tabela 2.12: Grupmallrat më të importuar për periudhat 2000, 2004, 2008 dhe 2013.

Viti 2000		Viti 2004		Viti 2008		Viti 2013	
Importi CIF	në përqindje ndaj totalit	Importi CIF	në përqindje ndaj totalit	Importi CIF	në përqindje ndaj totalit	Importi CIF	në përqindje ndaj totalit
Ushqime , pije, duhan	22.26	Makineri , pajisje dhe pjesë këmbimi	23.63	Makineri , pajisje dhe pjesë këmbimi	22.06	Makineri , pajisje dhe pjesë këmbimi	19.04
Minerale , lëndë djegëse, energji elektrike	13.22	Ushqime , pije, duhan	19.48	Minerale , lëndë djegëse, energji elektrike	17.89	Ushqime , pije, duhan	18.06
Produkte kimike dhe plastike	8.55	Tekstile dhe këpucë	13.44	Ushqime , pije, duhan	16.63	Minerale , lëndë djegëse, energji elektrike	17.91
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.74	Material e ndërtimi dhe metale	12.99	Material e ndërtimi dhe metale	15.42	Produkte kimike dhe plastike	13.19
Prodhim e druri dhe letre	2.53	Minerale , lëndë djegëse, energji elektrike	10.61	Produkte kimike dhe plastike	10.34	Material e ndërtimi dhe metale	12.24
Tekstile dhe këpucë	14.39	Produkte kimike dhe plastike	9.61	Tekstile dhe këpucë	9.00	Tekstile dhe këpucë	10.46
Material e ndërtimi	11.76	Të tjera	4.37	Të tjera	3.67	Prodhim e druri dhe letre	3.92

dhe metale							
Makineri , pajisje dhe pjesë këmbimi	21.11	Prodhim e druri dhe letre	3.27	Prodhim e druri dhe letre	3.41	Të tjera	2.97
Të tjera	4.44	Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.61	Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.57	Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.20

Burimi: INSTAT

Grup-produktet që dominojnë më tepër importin gjithsej për 2014 janë: “Produkte minerale”, “Makineri, pajisje mekanike dhe elektrike” dhe “Metale bazë dhe artikujt prej tyre”. Për vitin 2014 këto grup produkte zunë respektivisht 16,3 %, 12,7 % dhe 10,4 % të importit gjithsej.

3. METODOLOGJIA E NDJEKUR DHE INSTRUMENTAT E PËRDORUR.

Qëllimi kryesor i këtij kapitulli është të prezantojë strategjinë empirike të përdorur në këtë studim ndaj arritjes së objektivave të studimit.

Kapitulli prezantohet në tre seksione kryesore. Në seksionin e parë bëhet specifikimi i modelit dhe struktura teorike e studimit. Çështjet lidhur me metodologjinë ekonometrike duke përfshirë vlerësuesit pooled, atë me efekte fikse dhe me efekte rastësore janë diskutuar në seksionin e dytë. Seksioni i fundit prezanton një përshkrim të shkurtër të variablave të përdorura në studim, si janë matur dhe burimet nga të cilat janë derivuar.

Për të arritur qëllimin kryesor të punimit, materiali përdor përfaqson e modelit të gravitetit, i cili në ditët e sotme është një nga modelet empirike më të përdorura në vlerësimin e tregtisë ndërkombëtare.

Sipas Edward Christie⁴¹, 2002, modeli i gravitetit për tregtinë është analog me ligjin e gravitetit të Njutonit në mekanikë: forca e gravitetit midis dy trupave fizikë është proporcionale me peshën e secilit prej trupave e ndarë nga katrori i distancës midis qendrave të gravitetit në metër.

Ekuacioni 3.1

$$F = G \frac{M_1 M_2}{D^2}$$

Analogjia për tregtinë është si më poshtë: flukset tregtare midis dy vendeve janë proporcionale për produktin e secilës “masë ekonomike” të vendeve, zakonisht e matur nga GDP, secila nga fuqitë e përmasave përcaktohet e ndarë nga distanca midis vendeve respektive “qendrave ekonomike të gravitetit”, zakonisht kryeqytetet e tyre. Që këtej e tutje do t'i referohemi bazës së modelit të gravitetit, eksponentët për masën dhe distancën nuk janë vendosur. (Edward Christie, 2002)

Ekuacioni 3.2

$$M = k Y_M^\beta Y_X^\gamma D^\delta$$

Ku M është rrjedhja e tregtisë në vendin “M” për tek vendi “X”, Y_M dhe Y_X janë GDP e vendeve “M” dhe “X” dhe “D” është distanca gjeografike midis kryeqyteteve të vendeve. Forma lineare e modelit është si më poshtë: (Edward Christie, 2002)

⁴¹ Edward Christie, 2002, Potential Trade in Southeast Europe: a Gravity Model Approach, faqe 1

Ekuacioni 3.3

$$\log(M) = \alpha + \beta \log(Y_M) + \gamma \log(Y_X) + \delta \log(D)$$

Sipas Edward Christie,(2002), ky model bazë, kur vlerësohet, jep relativisht rezultate të mira. Sidoqoftë, dimë se faktorë të tjerë ndikojnë nivelet e tregtisë. Si përfundim, mund të themi se ekziston një diversitet i madh në literaturë për tregtinë dhe efektet në të ardhurat, punësimin dhe bilancin e pagesave. Çështja kryesore që ngrihet në këto postulate teorike, është se si duhet të ndërveprojnë tregtia dhe zhvillimi ekonomik.

Studiues të fushës së integritimit ekonomik sugjerojnë se ekzistojnë mjaft argumente ekonomike që theksojnë se tregtia aktuale mund të ndikohet nga tregtia në të kaluarën. Për shembull, disa autorë argumentojnë se tregtia në të kaluarën ndikon mbi tregtinë aktuale përmes konceptit të “forcës së zakonit”. Me fjalë të tjera, nëse konsumatorët kanë përdorur gjatë viteve të fundit një produkt specifik, ata janë mësuar me këtë produkt. Kjo “forcë e zakonit” kontribuon në tregtinë aktuale dhe në atë në të ardhmen (Eichengreen dhe Irwin 1997; Bun dhe Klaassen 2002). Argumentet e mësipërme sugjerojnë se flukset tregtare në të kaluarën ndikojnë në flukset tregtare aktuale dhe në ato të ardhshme.

Megjithatë, pjesa më e madhe e studimeve në të kaluarën, përdorin përqasjen e modelit të gravitetit statik OLS, e cila nuk konsideron rëndësinë e një dinamike të tillë në shpjegimin e flukseve tregtare.

Literatura mbi integritimin tregtar të rajonit të Ballkanit është disi e kufizuar dhe e pamjaftueshme. Nga ana tjetër, dinamikat në modelet e gravitetit mbeten ende një fushë e pastudiuar mjaftueshëm në ekonometri.

Flukset tregtare të Shqipërisë me vendet e EUR32 do të jenë fokusi kryesor i këtij materiali. Vendet specifike që do të vlerësohen në material, janë: Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Polonia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicera, Serbia, Maqedonia, Turqia, dhe Britania.(EUR 32). Ndonëse Kosova është një partner i rëndësishëm tregtar për disa prej vendeve, ajo nuk përfshihet në vlerësimet e gravitetit, për shkak të të dhënave të pamjaftueshme.

Ky material përdor një grup të dhënash prej 448 obsevimesh dhe 14 vite të organizuara në të dhëna panel, (nga viti 2001 deri në vitin 2014).

3.1 Të dhënat panel.

Një *panel data* konsiston në një grup *cross-sectional* njësisish, të cilat observohen përgjatë disa viteve. Nëse kemi një numër njësisish “N” dhe seri kohore “T”, atëherë tipet e *panel data* janë:

- Tipi i parë, të gjata dhe të ngushta, “T”>”N”

- Tipi i dytë, të shkurtra dhe të gjera, “N”>”T”
- Tipi i tretë, të gjata dhe të gjera, “N” dhe “T” përmbajnë shumë informacion.

Në punimin tonë ne do të përdorim të dhëna *panel* të tipit të dytë. Kjo është metode tipike e përdorur në shumë studime ekonomike, të cilat përdorin një seri të gjerë me shumë njësi individuale. Në rastin e studimit tonë N=32 dhe T=14. Të dhënat vijnë nga burime të ndryshme si Banka Botërore (BB), Heritage found (HF), Eurostat , Instat dhe Centre d'Etudes Prospectives et d'Informations Internationales (CEPII), të cilat përbëjnë një numër prej 32*14=448 rreshta të dhënash.

Observimet e disa variablave për dy shtetet e para jepen në tabelën 3.1.

Tabela 3.1: Ekstrakt i tabelës së të dhënave.

viti	riso	vendet	iso	importet	eksport	distanca	pdgp	rgdp	...	...	...
2001	ALB	Austria	AUT	11840404	1781822	849	196421687857	3686649387	5305	38548	70.0
2002	ALB	Austria	AUT	10796436	728387	849	196953646532	4091020249	5730	38919	70.0
...	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...
2013	ALB	Austria	AUT	63631646	23868674	849	407575109733	12344529628	9811	44216	70.0
2014	ALB	Austria	AUT	58598613	11851454	849	428321937480	12916669736	9961	44059	70.0
2001	ALB	Belgium	BEL	2936268	266645	1609	237336465819	3686649387	5305	37404	70.0
2002	ALB	Belgium	BEL	52552	438201	1609	237397762864	4091020249	5730	37620	70.0
...	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...
2013	ALB	Belgium	BEL	19493263	5749639	1609	498746230594	12344529628	9811	40687	70.0
2014	ALB	Belgium	BEL	22695189	1825712	1609	524778837630	12916669736	9961	40607	70.0

Kollona e parë indentifikon vitin në të cilën këto të dhëna janë mbledhur, kollona e dytë shtetin dhe më pas variablat e varur dhe të pavarur. Kjo paraqitje e shkurtër e të dhënave bëhet për të identifikuar të dhënat *cross section* dhe *seritë kohore*.

Në panelin tonë ka disa të dhëna të munguara, ne i kemi hequr këto të dhëna duke mos i përfshirë në model, për shkak të shtrëmbërimeve që mund të na japin në vlerësime. Në disa raste në të dhënat *panel*, ndodh që çdo njësi individuale të mos i korespondojë e njëjta seri kohore, në këtë rast kemi të bëjmë me *panel data* të pa balancuar. Problemi bëhet evident edhe në të dhënat tona, për shkak të Malit të zi, i cili nuk ka të dhëna të plota për 14 vite.

Për të marrë një *panel data* të balancuar bashkojmë Serbinë dhe Malin e Zi bashkë si një shtet i vetëm. Duke bërë këto rregullime, ne marrim të dhëna panel të balancuara për çdo shtet.

Si model bazë materiali përdor modelin e gravitetit të Frankel, Stein dhe Wei (1997) për të ndërtuar më pas një model të ri ekonometrik tërësisht të specifikuar, i cili lejon përfshirjen e dinamikave në shpjegimin e flukseve tregtare.

Modeli do të jetë në formë log-log, në mënyrë që të marim koeficientin e elasticitetit të vlerësuar.. Megjithatë, një transformim i tillë logaritmik ka dy probleme të mëdha:

Së pari, ne nuk mund ta përdorim këtë ekuacion për të gjitha variablat, nëse në të dhënat e tyre ato kanë vlerën zero, sepse logaritmi i zeros nuk është i përcaktuar.

Së dyti, duke vlerësuar ekuacionin log-log me metoden OLS, kjo mund të na çojë në një paragjykim të konsiderueshëm.

Një sfidë e këtij punimi është si ti trajtojmë vlerat zero në model, sepse modeli që kemi zgjedhur, na kufizon në analizën tonë, kur kemi prezente vlerat zero në të dhëna.

Në vitet e fundit janë botuar shumë studime, në të cilat krahasohen metoda të ndryshme ekonometrike se si ta trajtojnë këtë çështje të “zero-tregtisë”. Megjithatë, konkluzionet teorike, rezultatet e tyre empirike dhe rekomandimet ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga një autor tek tjetri.

Shumë autorë propozojnë eliminimin e atyre variablave, të cilat kanë vlerën zero, por në modelin tonë të flukseve të tregtisë së jashtme të Shqipërisë me vendet EUR32 ekzistojnë disa vende që në periudha të caktuara, nuk kanë marrëdhënie tregtare me Shqipërinë, por në totalin e tyre në 14 vite, ku shtrihet studimi ynë, kanë një vlerë të konsiderueshme të import-eksportit me vendin tonë.

Në vazhdim të këtij punimi do të zëvendësojmë vlerat zero me vlerën 1\$, kjo do të na ndihmojë në modelin tonë për të eliminuar vlerat zero nga të dhënat e grumbulluara.

3.2 Inefiçenca.

Në rast se të dhënat panel kanë prezencë heteroskedasticiteti në terma gabimi, vlerësimet tona të ekuacionit të gravitetit log-log janë të njëanshme pra “log-log” i modelit empirik, të çon në vlerësime jo të qëndrueshme.

Testet e heteroskedasticitetit, si: Gold –Feld Quandt Test, LM testi, Park testi, Gleiser testi, White General Heteroscedasticity testi; Spearman's Rank Correlation test; Goldfeld – Quandt, mund të përdoren por ata kanë veçori të ndryshme.

Në rast se testet tona nuk e refuzojnë hipotezën zero, atëherë nuk kemi prova të dyshojmë për heteroskedasticitet. Në rast të kundërt, ne duhet të rishqyrtojmë modelin.

3.3 Metodat e vlerësimit.

Në këtë seksion do të përshkruajmë disa metoda kryesore vlerësimi të aplikueshme në të dhënat panel. Do të përmendim supozimet e tyre kyç, përdorimet e tyre dhe vështirësitë e mundshme.

Përdorimi vetëm të dhënat *cross sections* për vlerësimin e ekuacioneve të gravitetit ne fillim të viteve 60 ka qënë e zakonshme. Megjithatë, vetëm me një vëzhgim për njësi, nuk mund të marim rezultate të sakta.

Kjo është arsyeja pse do të përdorim të dhëna *panel*.

Të dhënat panel ndryshojnë në dy dimensione: në vende dhe në kohë, avantazh i tyre për mostrën e të dhënave *cross section* ose mostrën e të dhënave të serive kohore është se ato janë më efikente.

Nëse përdorim të dhënat panel, disa variabla të përshtatshme ndryshojnë në kohë sic është produkti i përgjithshëm bruto por distance nuk ndryshon. Si pasojë, metodat që do të përdorim në vlerësim marrin në llogaritje variancën, gjë e cila do të ishte e pamundur në rastin e të dhënave *cross-section*. Metodatat që do të përdorim janë, *pooled OLS*, me efekte fikse dhe të rastësishme të cilat përshkruhen me detaje, sepse më vonë këto janë aplikuar në pjesën empirike.

Për sa i përket metodës së përzgjedhur të vlerësimit do të përdorim testin Hausman për identifikimin e saj.

Që rezultatet tona të jenë të besueshme, ne duhet të sigurohemi që të dhënat nuk na japin rezultate të deformuara, për këtë arsye do të bëjmë disa teste: linearitetin në parametra, multikolinearitetin, heteroskedasticitetin, korrelacionin serial dhe stacionaritetin.

3.3.1 Pooled OLS.

Lucie Davidová,(2011)⁴², në punimin e tij të mikrotezës ka dhënë një përshkrim të kësaj metode. Ai shkruan se; Gomez dhe Milgram (2009) linearizuan dhe vlerësuan modelin multiplikativ të gravitetit duke përdorur teknikat OLS. Kjo mund të realizohet nën supozimin se: varianca e termit të gabimit është konstante tek vëzhgimet (homoskedasticiteti). Metoda e vlerësimit “Pooled OLS”, e përdorur në të dhënat pooled bazohet në OLS:

Ekuacioni 3.5

$$y_{it} = \beta_1 x_{it1} + \beta_2 x_{it2} + \dots + \beta_k x_{itk} + v_{it}, t = 1, \dots, T$$
$$v_{it} = a_i + u_{it}$$

Lucie Davidová,(2011), thekson se; edhe nëse supozojmë se përbërja e gabimit v_{it} nuk është e lidhur me X_{it} , teknika pooled OLS është e njëanshme dhe jo e qëndrueshme, nëse, a_i dhe X_{it} janë të lidhura. Rezultati i njëanshëm në teknikën pooled OLS, quhet edhe heterogjeniteti i njëanshëm ose i paragjykuar, por është vetëm një paragjykim i shkaktuar nga heqja e një variabli konstant në kohë. Për më tepër, duhet të kujtojmë se, nëse ai nuk është lidhur me të gjithë variablat shpjeguese në të gjitha periudhat kohore, gabimi

⁴² Lucie Davidová,(2011), Determinants of Austrian International Trade, faqe 10-11

standart i pooled OLS dhe testet statistikore, janë përgjithësisht të pavlefshëm, ata injorojnë korrelacionin substancial serial në gabimin e përbërë (Wooldridge, 2003). Teknika pooled OLS është një mënyrë e thjeshtë dhe e shpejtë e krahasimit të regresioneve të sofistikuara. Kjo metodë nuk bën ndonjë dallim midis të dhënave *cross section* dhe të *serive kohore*. Kështu, vetëm të dhënat panel nuk kompesojnë problemin e heterogjenitetit të pavëzhguar.

3.3.2 Efektet fikse. (FE)

Sipas Lucie Davidová,(2011)⁴³, vlerësuesi i efekteve fikse përdor një transformim për të zhvendosur efektin e pavëzhguar a_i , pas zbritjes së mesatares (3.7) nga vlerat aktuale (3.6) marrim ekuacionin përfundimtar të transformuar dhe vlerësoar (3.9).

$$y_{it} = \beta_1 x_{it1} + \beta_2 x_{it2} + \dots + \beta_k x_{itk} + a_i + u_{it}, \quad t = 1, \dots, T \quad (3.6)$$

$$\bar{y}_{it} = \beta_1 \bar{x}_{it1} + \beta_2 \bar{x}_{it2} + \dots + \beta_k \bar{x}_{itk} + a_i + \bar{u}_i, \quad (3.7)$$

$$\bar{y}_i = \frac{\sum_{t=1}^T y_{it}}{T} \quad (3.8)$$

$$y_{it} - \bar{y}_i = \beta_1 (x_{it1} - \bar{x}_{i1}) + \dots + \beta_k (x_{itk} - \bar{x}_{ik}) + (u_{it} - \bar{u}_i) \quad (3.9)$$

$i = 1, \dots, N$
 $t = 1, \dots, T$

Termi (a_i, u_{it}) në ekuacionin (3.6) është quajtur edhe gabim i përbërë dhe përbëhet nga dy terma: a_i është invariant-kohor dhe paraqet një efekt individual të pavëzhguar të çdo njësie interesi (vendi ose viti- varen nga struktura e të dhënave); u_{it} vazhdon të qëndrojë si term shqetësimi i quajtur gabim idiosinkretik, ai paraqet faktorët e pavëzhguar, të cilët ndryshojnë në kohë dhe ndikojnë në y_{it} (Lucie Davidová,2011).

Keficientët β , në ekuacionin (3.9), mund të vlerësohen nga OLS. Vlerësuesi FE lejon arbitraritet korrelacioni midis a_i dhe variablit shpjegues në ndonjë periudhë kohore, i cili është supozimi kyç dhe ndryshimi kryesor midis FE, pooled OLS dhe RE. (Lucie Davidová,2011).

Prandaj supozojmë se subjektet tona të interesit dhe variancat e tyre janë identike. Sidoqoftë, vlerësuesi FE nuk i përpunon variablat konstante në kohë (ose ndër një grupi individësh). Meqënëse mesatarja barazohet në secilin vëzhgim, variabli i kundërt është konstant zero dhe këto variabla hiqen nga transformimi më a_i . Për shembull, distanca nuk ndryshon në kohë dhe GDP-ja shqipëtare nuk ndryshon për individë, kështu nuk do të jemi të aftë të përfshijmë këto dy variabla, me qëllim përdorimin e strukturës së të dhënave. (Lucie Davidová,2011).

Për fat të keq,thekson Lucie Davidová, kur numri i subjekteve N është shumë i madh, metoda FE çon në një humbje të madhe të shkallëve të lirisë.

⁴³ Lucie Davidová,(2011), Determinants of Austrian International Trade, faqe 11

Për më tepër, inferenca në vlerësuesin FE është potencialisht më e ndjeshme ndaj jonormalitetit, heteroskedasticitetit dhe korrelacionit serial në gabimet idiosinkretike (Lucie Davidová,2011).

Me qëllim kuptueshmërine e normalitetit, homoskedasticitetit ose korrelacionit serial, citojmë supozimet kyçe më poshtë: (Lucie Davidová,2011).

Supozimet e teknikës me efekte fikse:

1. *Linearitet në parametra:*

Për çdo "i" modeli është:

$$y_{it} = \beta_1 x_{it1} + \beta_2 x_{it2} + \dots + \beta_k x_{itk} + a_i + u_{it}, \quad t = 1, \dots, T$$

Ku β_j janë parametra vlerësimi dhe a_i është efekt i pavëzhguar.

2. *Zgjedhje rastësore*

Kemi një mostër të rastësishme nga të dhënat cross section.

3. *Kolinaritet jo perfekt:*

Çdo variabël shpjeguese ndryshon në kohë (për të paktën çdo "i") dhe ekziston lidhje lineare jo perfekte midis variablave shpjeguese.

4. *Ekzogjene:*

Për secilën "t" vlera e pritur e gabimit idiosinkretik të dhënë, variablat shpjeguese në të gjitha periudhat kohore dhe efekti i pavëzhguar janë zero:

$$E(u_{it}|X_i, a_i) = 0.$$

5. *Homoskedasticiteti:*

$$Var(u_{it}|X_i, a_i) = Var(u_{it}) = \sigma_u^2 \text{ për të gjitha } t = 1, \dots, T.$$

6. *Korrelacion jo serial:*

Për të gjitha $t \neq s$ gabimet idiosinkretike nuk janë të lidhura (kusht për të gjitha variablat shpjeguese dhe a_i):

$$Var(u_{it}, u_{is}|X_i, a_i) = 0.$$

7. *Normaliteti:*

Kushti për X_i dhe a_i, u_{it} janë të pavarura dhe kanë shërndarje normale identike $(0, \sigma_u^2)$.

Nën supozimin FE 4. Vlerësuesi nuk është i njëanshëm, si dhe i qëndrueshëm për "T" të fiksuar dhe $N \rightarrow \infty$. Vlerësuesi FE është vlerësuesi më i mirë linear i paanshëm (BLUE), nën supozimin FE 6. Nëse shtojmë supozimin e normalitetit, vlerësuesit "t" dhe "F" kanë shpërndarje të saktë "t" dhe "F", kështu inferenca statistikore është e vlefshme.

Nga ana tjetër, duhet të mbështetemi në përafrimin për T të vogël dhe N të madhe, sidoqoftë, ekzogjeniteti çenohet, nëse kemi hequr një variabël të rëndësishme të ndryshueshmë në kohë, Lucie Davidová (2011).

Lucie Davidová,(2011), na sygjeron të përdorim vlerësuesin FE, kur mendojmë se mostra jonë nuk është rastësore, nëse subjektet tona i përkasin një njësie gjeografike të madhe (ky është rasti ynë aktual në pjesën empirike nën strukturën e të dhënave *cross-sectional*, ku efekti fiks a_i është i lidhur me setin tonë të variablave, me fjalë të tjera, a_i paraqet disa karakteristika tipike të pavëzhguara të secilit vend, gjë e cila nuk mund të arrihet nga variablat tona të vëzhguara.

Problemi i Mekanizmit FE është njësoj si lejimi i një intercepti të ndryshëm për secilën njësi *cross-sectional*.

Nëse $Corr(a_i, x_i) \neq 0$ modeli i vërtetë është FE, vlerësuesi pooled OLS është i njëanshëm dhe jo i qëndrueshëm. Megjithatë duhet që si fillim të testojmë ekzistencën e efekteve fikse. Sipas (Lucie Davidová, 2011), Gomez dhe Milgram (2009) përdorën LR dhe LM dhe efektet individuale. Gjithashtu mund të përdoret testi standart F për rëndësinë e individëve dhe variablat dummy.

Vlerësuesi FE është shumë i përdorur nga kërkuesit në bazë të përdorimit të tij të thjeshtë dhe fuqinë e lartë shpjeguese. Sidoqoftë, në rast të cënimit të ndonjërit nga supozimet e mësipërme, ai humbet qëndrueshmërinë e tij dhe nuk është më BLUE. Kështu do të testojmë me kujdes për cënime të mundëshme.

3.3.3 Efektet rastësore. (RE)

Disa autorë besojnë se efektet fikse në mostrën e tyre nuk janë të lidhura me setin e variablit x_i , nga e kundërta, ata mund të supozojnë se komponenti i pavëzhguar ka shpërndarje rastësore, për këtë arsye nuk mund të përdoret vlerësuesi FE, meqenëse nuk është eficient, Lucie Davidová, (2011).

Vlerësuesi RE i efekteve rastësore: bazohet në një tipar shumë të ngjashëm si FE. Dallimi qëndron se transformimi heq vetëm fraksionin " λ " të mesatares dhe ky fraksion varet nga numri i periudhave kohore, $Var(a_i)$ dhe $Var(u_{it})$. Ekuacioni i transformuar merr formën e mëposhtme: ,Lucie Davidová, (2011)

$$y_{it} - \lambda \bar{y}_i = \beta_0(1 - \lambda) + \beta_1(x_{it1} - \lambda \bar{x}_{i1}) + \dots + \beta_k(x_{itk} - \lambda \bar{x}_{ik}) + v_{it} - \lambda \bar{v}_i \quad (3.10)$$

$$t = 1, \dots, T$$

$$ku \ v_{it} - \lambda \bar{v}_i = (a_i + u_{it}) - \lambda(a_i + \bar{u}_i) = a_i(1 - \lambda) + (u_{it} - \lambda \bar{u}_i)$$

$$\hat{\lambda} = 1 -$$

$$\left[\frac{\hat{\sigma}_u^2}{\hat{\sigma}_u^2 + \hat{\sigma}_a^2 \cdot T} \right]^{\frac{1}{2}} \quad (3.11)$$

$$Var(a_i) = \hat{\sigma}_a^2 \quad dhe \quad Var(u_{it}) = \hat{\sigma}_u^2$$

Kështu mund të vlerësojmë ekuacionin (3.10) me metodën e katrorëve më të vegjël.

Një disavantazh i vlerësuesit RE është se, edhe pse parametri " λ " mund të vlerësohet gjithmonë (3.11), nuk mund të njihet në praktikë. Vlerësuesi RE nuk bëhet asnjëherë i njëanshëm. Lucie Davidová, (2011)

Sipas po të njëjtit autor vlera e parametrin të transformuar $\hat{\lambda}$ tregon se pse vlerësimet ka gjasa të jenë të përafërta me metodën pooled OLS ose vlerësuesin FE.

Është e qartë se për $\lambda=1$ vlerësuesi RE është identik me atë FE. Kjo ndodh, veçanërisht, për $T \rightarrow \infty$, kur $\hat{\lambda} \rightarrow 1$ dhe vlera e njëanshme shkon drejt zeros.

Nga ana tjetër, kur $\hat{\lambda} \rightarrow 0$ vlerësuesi RE do të jetë më i ngjashëm me vlerësuesin pooled OLS. Ky është rasti, kur efekti i pavëzhguar a_i është relativisht i parëndësishëm, sepse $Var(u_{it})$ dhe vlera e njëanshme e vlerësuesit RE rritet.

Ka faktorë specifike për secilin individ të vlerësuar (vend ose vit), të cilët ndikojnë në tregtinë bilateral, por nuk janë të lidhur me GDP, distancën ose ndonjë variabël tjetër të pavarur.

Në këtë rast, thekson Lucie Davidová, vlerësuesi FE do të jetë jo eficient (Wooldridge, 2003; Baltagi, 2005).

Supozimet e teknikës me efekte rastësore:

1. *Linearitet në parametra:*

2. *Mostra është rastësore*

3. *Kolinaritet joperfekt*

Nuk ka lidhje perfekte lineare në variablat shpjeguese.

4. *Ekzogjenitet.*

FE.4 dhe vlera e pritur a_i për të gjitha variablat shpjeguese është konstante:

$$E(a_i|x_i) = \beta_0$$

5. *Homoskedasticiteti.*

$$FE.5 \text{ dhe } Var(a_i|x_i) = \sigma_a^2$$

6. *Korrelacion jo serial*

7. *Normaliteti*

Duke konsideruar këto 7 supozime, Lucie Davidová,(2011) tregon se supozimi i katërt nuk implikon korrelacion midis efektit të pavëzhguar a_i dhe setit të variablave. Është dallimi kyç midis FE dhe RE, kjo është arsyeja pse lejohet për variablat konstante heqja e fraksionit të tyre " λ ", jo të gjithë mesataren.

Supozojmë se vlera e pritur a_i është jo zero, ekuacioni përmban një intercept β_0 .

Nëse seti i supozimeve RE qëndron, vlerësuesi RE është më eficient se vlerësuesi pooled OLS, ose FE (të gjitha janë të paanshme, të qëndrueshme dhe normale).

RE është më i preferuar se vlerësuesi pooled OLS, si rrjedhim, është dhe më efiçiente.

Nën supozimin RE 4, vlerësuesi RE është i qëndrueshëm dhe me shpërndarje normale me $N \rightarrow \infty$ për T fikse. Nëse shtojmë tre supozimet e tjera, gabimi standart dhe testet statistikore janë të vlefshëm dhe vlerësuesi është efiçient.

Nëse bashkohen të gjithë supozimet RE, vlerësuesi OLS është i njëanshëm. Arsyeja pse nuk punojmë me OLS është se gabimet standarte të saj janë të vogla. OLS është gjithmonë më pak efiçient krahasuar me RE. Lucie Davidová (2011)⁴⁴ tregon se vlerësuesi RE ka përdorim të gjerë në kërkime, për shembull Fratianni dhe HoonOH (2007) ose Kovallari (2008). Gjithashtu, ne do ta përdorim këtë teknikë vlerësimi në pjesën empirike.

Sipas Lucie Davidová (2011), është mjaft e zakonshme për autorët të aplikojnë të dyja teknikat RE dhe FE dhe të testojnë statistikisht ndryshimet e rëndësishme në koeficientët e tyre në variablat shpjeguese. Sidoqoftë, siç kemi parë, konfliktet në supozimet e tyre teorikisht nuk është e mundur të përdoren të dyja metodat.

⁴⁴ Lucie Davidová,(2011), Determinants of Austrian International Trade, faqe 17

3.4 Testi Hausman.

Lucie Davidová (2011), jep dhe një shpjegim për Testin Hausman i cili ndihmon në dallimin nëse RE ose FE është më bindëse.

Ky test gjithashtu aplikohet në pjesën empirike, në kapitullin 5.

Ngrihen hipotezat e mëposhtme:

$$H_0: Cov(a_i, x_{it}) = 0 \forall t$$

$$H_{Alt}: Cov(a_i, x_{it}) \neq 0 \text{ për të paktën një "t".}$$

Nën hipotezën null të dy vlerësuesit FE dhe RE janë të qëndrueshëm, por RE pranohet si teknika me forcë më të lartë shpjeguese. Nën hipotezën alternative vlerësuesi FE është më i qëndrueshëm sesa vlerësuesi RE. Megjithatë, nëse hedhim poshte H_0 , FE është më i preferueshëm dhe e anasjellta. Lucie Davidová (2011), na jep shembuj të zbatimit të këtij testi; Frantianni dhe HoonOH (2007) dhe Kavallari (2008) përfshijnë të dy vlerësuesit. Bazuar në testin Hausman, vlerësuesi RE u zgjodh si më i përshtatshmi, megjithatë mund të ketë raste kur p-value e testit Hausman është e paqartë.

Si Gomez dhe Milgram (2009) argumentuan se FE duhet të jetë më i preferueshëm, edhe pse ai akoma jep rezultate të qëndrueshme (megjithëse joeficiente).

3.5 Vlerësimi i potencialit të tregut

Vlerësimet e ekuacionit të gravitetit përdoren për të parashikuar tregtinë e Shqipërisë me të gjitha vendet në mostrën tonë. Raporti i potencialit tregtar (P) i parashikuar nga modeli dhe tregtia aktuale, (A) dmth (P / A) është përdorur pastaj për të analizuar drejtimin e ardhshëm të tregtisë për Shqipërinë. Nëse vlera e P / A kalon vlerën një ose 100%, nënkuptimi është në drejtim të zgjerimit të mundshëm të tregtisë me vendin përkatës.

Në varësi të vlerës së P / A, partnerët tregtarë të Shqipërisë ndahen në dy kategori: ata me të cilët potenciali për zgjerimin e tregtisë është i paraparë dhe vendet me të cilin Shqipëria e ka tejkaluar tashmë potencialin e saj të tregtisë. Diferenca absolute midis nivelit potencial dhe aktual të tregtisë, përkatësisht të vlerës së (A-P), përdoret gjithashtu për të klasifikuar vendet me potencial për zgjerimin e tregtisë me Shqipërinë. Një vlerë pozitive tregon mundësitë e ardhshme të zgjerimit të tregtisë, ndërsa një vlerë negative tregon se Shqipëria ka tejkaluar potencialin e saj të tregtisë me vendin partner.

3.6 Metodat e avancuara të vlerësimit.

Ka shumë teknika të tjera vlerësimi për ekuacionin e gravitetit. Secila metodë paraqet avantazhe dhe disavantazhe të rëndësishme. Disa prej tyre zgjidhin problemet e heteroskedasticitetit ose atë të zeros, por janë shumë të kushtueshme, kurse metodat e tjera më të thjeshta nuk janë të vlefshme, kur kemi prezencë të dy karakteristikave ose nuk marrin parasysh dimensionet e tregtisë multilateral, Lucie Davidová (2011)⁴⁵.

⁴⁵ Lucie Davidová, (2011), Determinants of Austrian International Trade, faqe 17.

Sipas Lucie Davidová (2011), teknika e vlerësimit Poisson është një vlerësues maksimal i gjasave, shumë popullor së fundmi. Vlerësuesi Poisson arrin të llogarisë shkaqet e anshmërisë nga forma logaritmike e ekuacionit të gravitetit në rastin e shfaqjes së heteroskedasticitetit në termat e gabimit (shpjeguar në seksionin 1.5, mësipër). Për më shumë, ai zgjidh edhe çështjen e flukseve zero të tregtisë midis dy vendeve.

Gjithashtu Santos Silva dhe Tenreyra (2006) testuan këtë vlerësues kundrejt metodave të tjera më të avancuara dhe arritën performancë të kënaqëshme, edhe pse me prani të gabimeve në matje. Lucie Davidová (2011)⁴⁶.

Avantazh tjetër i vlerësuesit Poisson është se ai lejon një variabël të varur të vazhdueshëm.

Mundet që vlerësuesi Tobit mund të përpunohet gjithashtu. Ai është një mundësi e përafërt e modelit me variabla të varura të limituara. Ky model i censuruar është i aftë të përpunojë mungesat në tregtinë e njëanëshme. Modeli Tobit performon më mirë krahasuar me vlerësuesin Poisson, proporcioni i flukseve të zero-tregtisë është i konsiderueshëm. Për më shumë, Santos Silva dhe Tenreyra (2010) thekasuan se në këtë rast të veçantë vlerësuesi maksimal i gjasave mund të dështojë në kovergjim. Lucie Davidová (2011)⁴⁷.

Sidoqoftë, modeli Tobit nuk rregullon asimetrinë e shkaktuar nga heteroskedasticiteti në modelet log-linear.

Metoda të tjera, të cilat mund t'ja vlejné për t'u marrë në konsideratë, janë, për shembull: vlerësuesi i variablave dummy të katrorëve më të vegjël, metoda klasike e distancës minimale, metoda e momenteve të përgjithsuara ose vlerësuesi Mundlak. Lucie Davidová (2011)⁴⁸.

Metodat që do të përdorim në këtë punim janë; FE, RE dhe Pool OLS

3.7 Përshkrimi i variablave.

Duke ju referuar modelit teorik të bërë pjesë e studimit ne kemi përdorur këtu variablat e mëposhtëm.

Tregtia totale është shuma e eksporteve dhe importeve bilaterale

Eksportet (exp) janë të barabarta me vlerën e të mirave të prodhimit të brendshëm, që u shiten të huajve.

⁴⁶ Lucie Davidová,(2011), Determinants of Austrian International Trade, faqe 17.

⁴⁷ Lucie Davidová,(2011), Determinants of Austrian International Trade, faqe 18.

⁴⁸ Lucie Davidová,(2011), Determinants of Austrian International Trade, faqe 18.

Vlerat e eksporteve shqipëtare do të jetë për 32 vendet e europës në dollarë dhe të dhënat do të meren nga faqja zyrtare e Bankës Botërore⁴⁹.

Importet (imp) janë të barabarta me vlerën e të mirave të prodhimit të jashtëm të blerë në vend.

Vlerat e importeve shqipëtare do të jetë për 32 vendet e Europës në dollarë dhe të dhënat do të meren nga faqja zyrtare e Bankës Botërore.

Produkti i brendshëm bruto (GDP) është vlera e tregut e të gjitha të mirave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara në një vënd për një periudhë kohe të dhënë.

“GDP është vlera e tregut...”

GDP bën mbledhjen në një vlerë vetme të llojeve të ndryshme të produkteve të aktivitetit ekonomik. Për këtë qëllim i referohet çmimeve të tregut. Duke mbledhur se sa janë të gatshëm të paguajnë individët për të mirat dhe shërbimet, çmimet e tregut pasqyrojnë vlerën e këtyre të mirave.

“...e të gjitha të mirave dhe shërbimeve....”

GDP-ja duhet të jetë gjithpërfshirës, domethënë duhet të përfshijë të gjitha të mirat dhe shërbimet e prodhuara në ekonomi dhe të shitura ligjërisht.

GDP-ja përfshin si të mirat e prekshme (ushqimet, veshjet, veturat) ashtu edhe shërbimet e pa prekshme (prerjen e flokëve, pastrimin e shtëpive, vizitat mjekësore).

“...përfundimtare....”

Që nënkupton se nuk kemi të bëjmë me të mira dhe shërbime të ndërmjetme por finale

“...të prodhuara.....”

GDP përfshin të mirat dhe shërbimet e prodhuara aktualisht dhe jo ato të prodhuara në të kaluarën.

“... në një vend.....”

GDP mat vlerën e prodhimit në kuadrin e kufijve gjeografik të një vendi.

“... në një periudhë kohe të dhënë....”

GDP mat vlerën e prodhimit që realizohet në një periudhë kohe të dhënë. Zakonisht, ky interval kohor i korespondon një viti diellor (kalendarik) ose tremujor. GDP mat fluksin e të ardhurave dhe të shpenzimeve që rezultohen në periudhën e dhënë.

Vlerat e GDP-së do të jenë për 32 vendet e europës në dollarë dhe të dhënat do të meren nga faqja zyrtare e Bankës Botërore.

Distanca (dist). Distanca gjeografike midis dy vendeve, përgjithësisht, është e lidhur me koston e transportit, distancë më e madhe kosto më e madhe. Kemi dy lloje distancash si më poshtë:

- *Distanca e thjeshtë (Simple distances)*, e cila përcaktohet duke përdorur ekuacionin e rrethit bazuar në distancën tokësore midis dy vendeve.
- *Distanca e ponderuar (Weighted distances)*, e cila bazohet në distancën midis dy qyteteve më të mëdha të dy shteteve, e ponderuar kjo me peshën që ka secili qytet në raport me numrin total të popullsisë së secilit shtet.

Vlerat e distancës do të meren nga faqja zyrtare e CEPPII⁵⁰ dhe në punimin tonë do të përdoret distanca e ponderuar.

⁴⁹ <http://data.worldbank.org/>

GDP-ja për frymë është llogaritur si vlera absolute e diferencës midis GDP-së për frymë të Shqipërisë dhe asaj të vendeve partnere, ku GDP-ja për frymë është produkti i brendshëm bruto i ndarë nga popullsia totale. Vlerat e GDP-së për frymë do të jenë për 32 vendet e Europës në dollarë dhe të dhënat do të meren nga faqja zyrtare e Bankës Botërore

Rritja ekonomike: Rritja ekonomike ndodh atëherë kur vlera e tregut të produkteve dhe shërbimeve në një ekonomi rritet në një periudhë krahasuar me një periudhë tjetër. Zakonisht, rritja ekonomike matet duke ekzaminuar GDP-në e një ekonomie. Megjithatë, për shkak të inflacionit, ekonomistët dhe analistët shpesh preferojnë të matin rritjen ekonomike nëpërmjet ndryshimit vjetor të GDP-së reale dhe ndryshimit në përqindje të GDP-së për frymë. Rritja e GDP-së reale tregon se sa shpejt po zgjerohet ekonomia, ndërsa GDP-ja për frymë tregon se sa është aftësia e popullsisë të blejë të mira dhe shërbime në atë vend. Efekti i inflacionit eliminohet në llogaritjen e rritjes ekonomike duke matur kështu sasinë e produkteve dhe shërbimeve të prodhuara në ekonomi gjatë periudhës së dhënë.

Vlerat e rritjes ekonomike do të jenë për 32 vendet e Europës në dollarë dhe të dhënat do të meren nga faqja zyrtare e Bankës Botërore.

Indeksi i Performancës së Logjistikës (LPI)

Indeksi i Performancës së Logjistikës është një indeks i zhvilluar nga Banka Botërore në vitin 2007, që shërben për të matur performancën logjistike të vendeve sipas disa kriterëve të përcaktuara dhe i rendit ato sipas kësaj performance. LPI ofron një pasqyrë krahasuese të strukturave logjistike të vendeve të botës. Kështu, ajo ofron informacion të vlefshëm për kompanitë që operojnë ose planifikojnë të operojnë në këto vende. Fillimisht LPI-ja përfshinte 150 vende, në vitin 2010 ajo përfshiu rreth 155 vende.

Marrëveshjet e tregtisë së lirë MTL (variabël dummy)

0= vendi nuk angazhohet në një MTL

1= vendi angazhohet në një MTL

MTL-ja është një dokument i negociuar dhe i rënë dakord mes palëve me objektiv liberalizimin e tregtisë. Liberalizimi është i menjëhershëm për produktet me avantazhe të qarta të krahasuara dhe graduale për produkte të ndjeshme ndaj importeve. Për këto të fundit, marrëveshjet parashikojnë reduktim të përkallëzuar të tarifave doganore dhe eliminimin e tyre përgjatë periudhës kohore deri në krijimin e zonës së lirë tregtare. Megjithëse në një MTL fiksohen objektiva të matshëm dhe konkretë, MTL-ja është fleksibël, në kuptimin që ajo është e pajisur me mekanizmat e përshtatjes ndaj evolucioneve në raport me periudhën e paranegocimit.⁵¹

Burimi i përdorur: Komisioni European

Vendi i Bashkimit European BE (variabël dummy)

0= vendi nuk bën pjesë në BE

⁵⁰ <http://www.cepii.fr/CEPII/fr/cepil/cepil.asp>

⁵¹ Soana Jakupllari në studimin e saj “*Tregtia e jashtme dhe zhvillimi ekonomik në ndikimin e proceseve liberalizuese*.”

1= vendi bën pjesë në BE

Bashkimi Europian (European Union) është një ent ndërkombëtar dhe ndërqeveritar i cili është i përbërë nga 27 shtete anëtare, independente nga njëra tjetra dhe demokratike.

Burimi i përdorur: Komisioni Europian

Vend kufitar, është një variabël dummy, i cili tregon pozicionin gjeografik të vendit partner në tregti. Me “1” do të shënojmë ato vende me të cilat kemi kufij të përbashkët dhe me “0” vendet e tjera.

Lidhje detare, është një variabël dummy, i cili tregon nëse vendi partner ka lidhje detare (e shënojmë me “1”) ose jo (e shënojmë me “0”)

Treguesi i Lirisë Ekonomike.⁵²

Tre parimet e lirisë ekonomike⁵³

1. Në një shoqëri ekonomikisht të lirë, çdo person kontrollon frytet e punës dhe iniciativës së tij. Individët janë të fuqizuar, në të vërtetë, të vendosur, për të ndjekur ëndërrat e tyre me anë të zgjedhjes së tyre të lirë.
2. Në një shoqëri ekonomikisht të lirë, individët mund të kenë sukses ose të dështojnë bazuar në përpjekjet dhe aftësitë e tyre individuale. Institucionet e një shoqërie të lirë dhe të hapur të tregut nuk diskriminojnë as kundër as në favor të individëve në bazë të racës, përkatësisë etnike, gjinisë, klasës, lidhjet familjare, ose ndonjë faktor tjetër që nuk lidhen me merita individuale. Vendimmarrja qeverisëse karakterizohet me hapjen dhe transparencën, e cila ndriçon hijet ku diskriminimi mund të lulëzojë dhe promovon mundësi të barabarta për të gjithë.
3. Në një shoqëri ekonomikisht të lirë, fuqia e vendimmarrjes ekonomike është shpërndarë gjerësisht, dhe alokimi i burimeve për prodhimin dhe konsumin është në bazë të konkurrencës së hapur në mënyrë që çdo individ apo firmë ka një shans të barabartë të ketë sukses.

Këto tri parime themelore të lirisë ekonomike – fuqizimi i individit, mosdiskriminimi, dhe konkurrenca e lirë –që mbështet çdo matje dhe ide të politikave të paraqitura në treguesin e Lirisë Ekonomike.

Treguesi i Lirisë Ekonomike merr një pamje të gjerë dhe të plotë të lirisë ekonomike, duke matur performancën e vendit në 10 zona të veçanta. Disa nga aspektet e lirisë ekonomike që vlerësohen janë të lidhura me ndërveprimet e një vendi me pjesën tjetër të botës për shembull, shkallën e hapjes së një ekonomie ndaj investimeve globale ose të tregtisë. Shumica, megjithatë, përqëndrohet në politikat brenda një vendi, duke vlerësuar lirinë e individëve për të përdorur punën e tyre apo financat pa përmbajtje të panevojshme dhe ndërhyrje të qeverisë.

Secili prej aspekteve të matura të lirisë ekonomike luan një rol jetik në zhvillimin dhe mbajtjen e zhvillimit personal dhe kombëtar. Të gjithë janë plotësuese në ndikimin e tyre,

⁵² <https://www.heritage.org/index/about>

⁵³ www.heritage.org/index/book/methodology

megjithatë, përparimi në një zonë shpesh është i mundshëm për të përforcuar apo edhe frymëzuar progres në një zonë tjetër. Në mënyrë të ngjashme, liria ekonomike e shtypur në një zone, mosrespektimi i të drejtave të pronësisë, për shembull, mund ta bëjë shumë më të vështirë për të arritur nivele të larta të lirisë në kategori të tjera.

10 Aspektet e matura të lirisë ekonomike mund të grupohen në katër kategori të gjera:

- *Shteti i së drejtës* (të drejtave të pronësisë, lirisë nga korrupsioni);
- *Madhësia e Qeverisë* (liria fiskale, shpenzimet qeveritare);
- *Efikasiteti Rregullator* (liria e biznesit, liria e punës, liria monetare); dhe
- *Hapja e tregjeve* (liria e tregtisë, liria e investimeve, liria financiare).

Shteti i së drejtës.⁵⁴

E Drejta e pronësisë⁵⁵.

Komponenti i të drejtave pronësore është një vlerësim cilësor i masës në të cilën kuadri ligjor i një vendi lejon individët për të akumuluar lirisht pronën private, të siguruar nga ligje të qarta që zbatohen në mënyrë efektive nga qeveria. Ai mat shkallën në të cilën ligjet e një vendi mbrojnë të drejtat private pronësore dhe shkallën në të cilën respektohen këto ligje. Ai, gjithashtu, vlerëson gjasat që ka prona private të shpronësohet nga shteti dhe analizon pavarësinë e gjyqësorit, ekzistenca e korrupsionit brenda gjyqësorit, si dhe aftësinë e individëve dhe bizneseve për të zbatuar kontratat.

Sa më efektive të jetë mbrojtja ligjore e pronës, aq më më i lartë do të jetë rezultati i një vendi. Në mënyrë të ngjashme, sa më të mëdha të jenë shanset e shpronësimit të pasurisë së qeverisë apo më pak të pavarur nga gjyqësorit, aq më i ulët do të jetë rezultati i një vendi.

Rezultati i të drejtës së pronësisë i secilit vend vlerësohet nga zero deri në 100 pikë.

0— Prona private është jashtë ligjit dhe e gjithë pasuria i takon shtetit. Njerëzit nuk kanë të drejtë të padisin të tjerët dhe nuk kanë qasje në gjykata. Korrupsioni është endemik.

Një rezultat i ndërmjetëm, të tilla si 75 ose 45 mund të caktohen në vende ku e drejta e pronës e të cilëve bie në mes të dy kategorive të njëpasnjëshme.

100- Prona private është e garantuar nga qeveria. Sistemi gjyqësor zbaton kontratat në mënyrë efikase dhe të shpejtë. Sistemi i drejtësisë ndëshkon ata që në mënyrë të paligjshme konfiskojnë pronën private. Nuk ka korrupsion apo shpronësim.

Liria nga korrupsioni⁵⁶.

⁵⁴ <https://www.heritage.org/index/about>

⁵⁵ www.heritage.org/index/book/methodology Indeksi mbështetet në burimet e mëposhtme për informacion mbi të drejtat e pronësisë, sipas përparësisë: Economist Intelligence Unit, ViewsWire; Freedom House, Liria në Botë, 2011-2014; Departamenti Amerikan i Tregtisë, Guida Tregtare e Vendit 2011-2014; Departamenti Amerikan i Shtetit, Pasqyrat e klimës së Investimeve 2011-2014; Departamenti Amerikan i Shtetit, Raportet e Vendit mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut 2010-2013; dhe lajme, revista e artikuj të ndryshëm.

⁵⁶ www.heritage.org/index/book/methodology Indeksi mbështetet në burimet e mëposhtme për informacion mbi aktivitetet e tregut joformal, në mënyrë prioritare: Transparenca Ndërkombëtare, Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2011-2013; Departamenti Amerikan i Tregtisë, Vendi Tregtare Guide 2011-2014;

Korrupsioni shkatërron lirinë ekonomike, duke futur pasiguri dhe paqartësi në marrëdhëniet ekonomike. Ajo, gjithashtu, redukton vitalitetin ekonomik, duke rritur kostot dhe zhvendosjen e burimeve në aktivitete joproduktive.

Rezultati për këtë komponent rrjedh direkt nga Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (CPI) të Transparencës Ndërkombëtare, i cili mat nivelin e korrupsionit të perceptuar në 177 vende.

Për vendet që nuk janë të mbuluara në CPI, liria nga rezultati i korrupsionit përcaktohet duke përdorur informacionin cilësor nga burime të njohura dhe të besueshme ndërkombëtare. Kjo procedurë konsideron masën në të cilën korrupsioni mbizotëron në një vend.

Madhësia e qeverisë.⁵⁷

Liria fiskale⁵⁸.

Komponenti "Liria fiskale" është një masë e përbërë nga barra e taksave që reflekton dy normat e tatimit marginal dhe niveli i përgjithshëm i tatimeve, duke përfshirë taksat direkte dhe indirekte të vendosura nga të gjitha nivelet e qeverisjes, si: përqindje e GDP-së (GDP).

Rezultati komponent rrjedh nga tri nënfaktorë sasiore:

- Shkalla më e lartë marginale e tatimit mbi të ardhurat individuale,
- Shkalla më e lartë marginale e tatimit mbi të ardhurat e korporatave dhe
- Barra totale e taksave si përqindje e GDP-së.

Secila prej këtyre variablave numerike është peshuar në mënyrë të barabartë si një e treta e rezultatit komponent.

Për informacion mbi barrën e taksave si përqindje e GDP-së, burimet kryesore janë të Organizatës, për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim të të dhënave; Eurostat; Banka Afrikane për Zhvillim dhe Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Paraqitja ekonomike e Afrikës 2014; Fondi Monetar Ndërkombëtar, Stafi Raporti "Çështje të zgjedhura" dhe Raporti i stafit të Shtetit, konsultimet për Artikullin IV" 2011-2014; Banka Aziatike për Zhvillim, Treguesit kyç për Azinë dhe Paqësorin 2011-2014; Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Amerikën Latine, Anketa Ekonomike

Departamenti Amerikan i Shtetit, Deklarata e Investimeve Klima 2011-2014; Economist Intelligence Unit, ViewsWire and Risk Briefing; Freedom House, Liria në Botë 2011-2014; Zyra e Përfaqësuesit të Tregtisë së SHBA, 2014 National Raport Tregtisë vlerësim për Barrierat e Tregtisë së Jashtme; lajme, revista e artikuj të ndryshëm; dhe botimet qeveritare zyrtare të çdo vendi.

⁵⁷ <https://www.heritage.org/index/about>

⁵⁸ www.heritage.org/index/book/methodology Indeksi mbështetet në burimet e mëposhtme për informacion mbi të dhënat e normës së taksave, sipas përparësisë: Deloitte, Pikat Biznesit ndërkombëtare tatimore dhe udhëzues; Fondi Monetar Ndërkombëtar, Stafi Raporti "çështjeve të përzgjedhura dhe Shtojca Statistikore" dhe Stafi Raporti "Konsultimi neni IV", 2011-2014;

PricewaterhouseCoopers, Përmbledhjet e taksave në mbarë botën, 2011-2014; Agjencitë e investimeve të vendeve; autoritetet e tjera qeveritare (konfirmimet e ambasadave dhe / ose thesari ose autoriteti tatimor i Vendit); dhe Njësia E Inteligjencës E Ekonomistit (Economist Intelligent Unit), Tregtia e Vendit, 2010-2014.

e Amerikës Latine dhe Karaibeve 2011-2014 dhe kontaktet individuale nga agjensitë qeveritare dhe organizatat shumëkombëshe të tilla, si: FMN dhe Banka Botërore.

*Shpenzimet e Qeverisë*⁵⁹.

Komponenti “shpenzimet qeveritare” mat barrën e vënë nga shpenzimet qeveritare, e cila përfshin konsumin nga shteti dhe të gjitha pagesat e transferimit që kanë të bëjnë me programe të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me njohjen e të drejtave.

Asnjë përpjekje nuk është bërë për të identifikuar një nivel optimal të shpenzimeve të qeverisë. Niveli ideal do të ndryshojë nga vendi në vend, në varësi të faktorëve që variojnë nga kultura dhe gjeografia për nivelin e zhvillimit ekonomik. Megjithatë, shpenzimet qeveritare bëhen një barrë e pashmangshme në një pikë të caktuar, kur qeveria rritet në fushëveprim dhe madhësi, duke rezultuar në dy ndarje të burimeve dhe humbjen e efikasitetit ekonomik. Vëllimet e hulumtimit kanë treguar se shpenzimet e tepërta të qeverisë që shkaktojnë defiqet buxhetore kronike dhe akumulimi i borxhit publik, është një nga zvarritjet më serioze në dinamizëm ekonomik.

Shpenzimet e qeverisë kanë një ndikim të madh në lirinë ekonomike, por kjo është vetëm një nga shumë komponentë të rëndësishëm.

Në shumicën e rasteve indeksi përdor të dhënat e shpenzimeve qeveritare të përgjithshme që përfshijnë të gjitha nivelet e qeverisjes, si: federale, shtetërore dhe lokale. Në rastet kur të dhënat mbi shpenzimet e qeverisë së përgjithshme nuk janë në dispozicion, të dhënat mbi shpenzimet e qeverisë qëndrore janë përdorur në vend të tyre.

Efikasiteti rregullator.⁶⁰

*Liria e biznesit*⁶¹.

Liria e biznesit është një tregues i përgjithshëm i efikasitetit të rregullimit qeveritar të biznesit. Rezultati sasior rrjedh nga një grup matjesh të lehtësisë së fillimit, veprimt dhe mbylljes së një biznesi. Rezultati “Liria e biznesit” për çdo vend është një numër mes 0 dhe 100, me 100 tregohet mjedisi më i lirë i biznesit. Rezultati është i bazuar në 10 nënfaktorë, të gjithë të peshuar në mënyrë të barabartë, duke përdorur të dhëna nga raporti i Bankës Botërore të biznesit:

⁵⁹ www.heritage.org/index/book/methodology, Indeksi mbështetet në burimet e mëposhtme për informacion mbi ndërhyrjen e qeverisë në ekonomi, në mënyrë të përparësisë: Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillimit të të Dhënave; Të Dhënat e Eurostat; Banka Afrikane për Zhvillim dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, Pasqyra Ekonomike e Afrikës 2014; Fondi Monetar Ndërkombëtar, dhe World Economic Outlook Baza e të dhënave 2014; Banka Aziatike për Zhvillim, Treguesit Kyç për Azinë dhe Paqësorin, 2011-2014; Banka për Zhvillim të Afrikës, Libri i Statistikave të ADB 2014; Botime Qeveritare Zyrtare të çdo vendi; dhe Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Amerikën Latine, Anketa Ekonomike e Amerikës Latine dhe Karaibeve, 2011-2014.

⁶⁰ <https://www.heritage.org/index/about>

⁶¹ www.heritage.org/index/book/methodology Indeksi mbështetet në burimet e mëposhtme në përcaktimin rezultatet e lirisë së biznesit, sipas përparësisë: Banka Botërore, Doing Business 2015; Economist Intelligence Unit, Tregtia e Vendit, 2011-2014; Departamenti Amerikan i Tregtisë, Guida Tregtare e Vendit, 2011-2014; dhe Botimet Qeveritare Zyrtare të çdo vendi.

- Nisja e një biznesi-procedurat (numër);
- Nisja e një biznesi- koha (ditë);
- Nisja e një biznesi - kosto (% e të ardhurave për frymë);
- Nisja e një biznesi - kapitali minimal (% e të ardhurave për frymë);
- Marrja e licencës-procedurat (numër); 2
- Marrja e licencës - kohë (ditë);
- Marrja e licencës - kosto (% e të ardhurave për frymë);
- Mbyllja e biznesit - kohë (vjet); dhe
- Mbyllja e një biznesi - kosto (% e pasurisë).

*Liria e Punës*⁶².

Komponenti “liria e punës” është një masë sasiore, që shqyrton aspekte të ndryshme të kuadrit ligjor dhe rregullator të tregut të punës së vendit, duke përfshirë rregullat lidhur me pagat minimale, ligjet që pengojnë pushime nga puna, kërkesat për largimin nga puna, kufizimeve të matshme rregullatore mbi punësimin si edhe orët e punës.

*Liria monetare*⁶³.

Liria monetare kombinon një masë të stabilitetit të çmimeve me vlerësimin e kontrolleve të çmimeve. Si inflacioni dhe kontrolli i çmimeve shtrembërojnë veprimtarinë e tregut. Stabiliteti i çmimeve, pa ndërhyrjen e mikroekonomise është gjendja ideale për tregun e lirë.

Rezultati për komponentin e lirisë monetare është bazuar në dy nënfaktorë:

- Norma mesatare e ponderuar e inflacionit për tre vitet e fundit dhe
- Kontrollat e çmimeve.

Norma mesatare e ponderuar e inflacionit për tre vitet e fundit shërben si input kryesor në një ekuacion që gjeneron rezultatin bazë për lirinë monetare.

Liria e tregtisë është një matje e përbërë nga masa e shtrirjes së barrierave tarifore dhe jotarifore, që ndikojnë në importet dhe eksportet e mallrave dhe shërbimeve. Rezultati i lirisë tregtare është bazuar në dy inpute:

- Norma tarifa mesatare e ponderuar e tregtisë dhe
- Barrierat jotarifore (NTB)

⁶² www.heritage.org/index/book/methodology Indeksi mbështetet në burimet e mëposhtme për të dhënat mbi lirinë e punës, sipas përparësisë: Banka Botërore, Doing Business 2015; Economist Intelligence Unit, Tregtia e Vendi, 2011-2014; Departamenti Amerikan i Tregtisë, Guida Tregtare e Shtetit 2011-2014; dhe Publikimet Zyrtare Qeveritare të secilit vend.

⁶³ www.heritage.org/index/book/methodology Indeksi mbështetet në burimet e mëposhtme për të dhënat mbi politikën monetare, sipas përparësisë: Fondit Monetar Ndërkombëtar, Statistikave Financiare Ndërkombëtare Online; Fondi Monetar Ndërkombëtar, World Economic Outlook 2014, dhe Raporti i Stafit "Konsultimi neni IV", 2011-2014; Economist Intelligence Unit, ViewsWire; Administrata e Informacionit të Energjisë SHBA (VNM), Informon i Analizës së Shtetit; dhe botimet qeveritare zyrtare të çdo vendi.

Tregjet e hapura.⁶⁴

Liria tregtisë⁶⁵.

Importet e ndryshme që hyjnë në një vend mundet dhe shpesh të përballen me tarifa të ndryshme. Tarifa mesatare e ponderuar përdor peshën për çdo tarifë, bazuar në pjesën e importeve për çdo të mirë/mall.

Për të ruajtur qëndrueshmërinë në matjen e komponentit të lirisë së tregtisë, indeksi përdor normën tarifore mesatare të ponderuar më të fundit të një vendi nga burimi ynë primar.

Banka Botërore publikon të dhëna të plota dhe në përputhje me normat mesatare të ponderuara të tarifave.

Liria e Investimeve⁶⁶.

Në një vend ekonomikisht të lirë nuk do të ketë kufizime mbi rrjedhjen e kapitalit investues. Individët dhe firmat do të lejohen të lëvizin burimet e tyre brenda dhe jashtë aktiviteteve specifike, si edhe brenda dhe përtej kufijve të vendit, pa kufizim. Një vend i tillë ideal do të marrë rezultatin 100 në komponentin e lirisë së investimeve të indeksit.

Megjithatë, në praktikë, shumica e vendeve kanë një shumëllojshmëri të kufizimeve në investime. Disa kanë rregullat e ndryshme për investimet e huaja dhe të brendshme; disa të kufizojnë aksesin në valutën e huaj; disa vendosin kufizime mbi pagesat, transferimet, dhe transaksionet e kapitalit; në disa industri të caktuara janë të mbyllura për investime të huaja.

⁶⁴ <https://www.heritage.org/index/about>

⁶⁵ www.heritage.org/index/book/methodology Indeksi mbështetet në burimet e mëposhtme për të përcaktuar rezultatet për politikën e tregtisë, sipas përparësisë: Banka Botërore, Treguesit e Zhvillimit Botëror 2014; Organizata Botërore e Tregtisë, Trade Policy Review, 1995-2014; Zyra e Përfaqësuesit të Tregtisë të SHBA, 2014 Raporti Kombëtar i Vlerësimit të Tregtisë për Barrierat e Tregtisë së Jashtme; Banka Botërore, Doing Business 2013 dhe 2014; Departamenti Amerikan i Tregtisë, Guida e Gjendjes Tregtare, 2009-2014; Economist Intelligence Unit, Tregtia e Vendit, 2014; Forumi Ekonomik Botëror, Raporti Global i Mundësisimit të Tregtisë 2014; dhe botimet e qeverisë zyrtare të çdo vendi.

⁶⁶ www.heritage.org/index/book/methodology Indeksi mbështetet në burimet e mëposhtme për të dhënat mbi flukset e kapitalit dhe investimeve të huaja, sipas përparësisë: botimeve zyrtare të qeverisë të secilit vend; Departamenti Amerikan i Shtetit, Deklarata e Investimeve Klima 2014; Economist Intelligence Unit, Tregtia e Vendit, 2011-2014; Zyra e Përfaqësuesit të Tregtisë të SHBA, Vlerësimi i Raportit Kombëtar të Tregtisë për Barrierat Tregtisë me Jashtë 2014; Banka Botërore, Investimi Përtej Kufijve, 2012; Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Indeksi i Kufizimit të Tregtisë së Shërbimeve; dhe Departamenti Amerikan i Tregtisë, Guida tregtare e vendit, 2011-2014.

Indeksi vlerëson një shumëllojshmëri të kufizimeve rregullatore, të cilat janë zakonisht të aplikuara në investime.

*Liria financiare*⁶⁷.

Liria financiare është një tregues i efikasitetit bankar, si dhe një masë e pavarësisë nga kontrolli i qeverisë dhe ndërhyrje në sektorin financiar. Pronësia shtetërore e bankave dhe institucioneve të tjera financiare, si siguruesit dhe tregjet e kapitalit, redukton konkurrencën dhe në përgjithësi ul nivelin e marrjes së kredisë.

Në një mjedis ideal bankar dhe financiar, ku ekziston një nivel minimal i ndërhyrjes qeveritare, mbikëqyrja e pavarur qëndrore bankare dhe rregullimi i institucioneve financiare janë të kufizuara për zbatimin e detyrimeve kontraktuale dhe parandalimin e mashtrimit. Kredia ndahet sipas kushteve të tregut dhe qeveria nuk zotëron institucione financiare. Institucionet financiare, ofrojnë lloje të ndryshme të shërbimeve financiare për individët dhe kompanitë. Bankat janë të lira të japin kredi, të pranojnë depozita dhe të kryejnë operacione në monedhë të huaj. Institucionet e huaja financiare veprojnë lirshëm dhe trajtohen ashtu sikurse institucionet vendase.

Për indeksin e tanishëm të “Lirisë Ekonomike”, rezultatet janë zakonisht të bazuara mbi të dhënat për periudhën që mbulon gjysmën e dytë të vitit 2013, përmes gjysmës së parë të vitit 2014. Në masën e mundshme, informacioni aktual i menduar për secilin variabël ishte si ai i 30 qershorit 2014.

⁶⁷ www.heritage.org/index/book/methodology Përveç rasteve kur tregohet ndryshe, indeksi mbështetet në burimet e mëposhtme për të dhënat mbi bankën dhe financën, në mënyrë prioritare: Njësinë e Inteligjencës së Ekonomistëve, Tregtinë Vendase dhe Shërbimet Financiare, 2011-2014; Fondi Monetar Ndërkombëtar, Raporti i Stafit Vendas "çështja e përzgjedhur," Raporti i Stafit Vendas ", Konsultimet për Artikullin IV", 2010-2014; Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Anketimi Ekonomik; botimet zyrtare të qeverisë së çdo vendi; Dhoma e Tregëtisë Amerikane, Udhëzuesi Tregtar Vendas, 2011-2014; Përfaqësuesit të Dhomës së Tregtisë të SHBA, 2014 Raporti Vlerësues i Tregëtisë Kombëtare mbi Pengesat e Tregtisë së Jashtme ; Departamenti Amerikan i Shtetit, Deklarata e Investimeve Klimatike, 2011-2014; Banka Botërore, Treguesit e Zhvillimit Botëror 2014; si dhe lajme të ndryshme apo artikuj të revistave mbi bankat dhe financat.

Në tabelën e mëposhtëme paraqiten të përmbledhura variablat, të cilat do të konsiderohen në studim.

Tabela 3.2: Tabela e variablave.

VARIABLI	VARIABLI I TRASFORMUAR	KODI
TREGTIA TOTALE	LNTT	Y1
IMPORTET	LNIMPORTE	Y2
EKSPORTET	LNEKSPORTE	Y3
DISTANCA	LNDISTANCA	X1
GDP E SHQIPËRISË	LNRGDP	X2
GDP E VENDEVE PARTNERE	LNPGDP	X3
GDP PËR FRYMË	RGDP-PGDP	X4
RRITJE EKONOMIKE	-	X5
INDEKSI I PERFORMANCËS SË LOGJISTIKËS	LNLPI	X6
MARRËVESHJET E TREGTISË SË LIRË	-	X7
VEND ANETAR I BASHKIMIT EUROPIAN	-	X8
VEND KUFITAR	-	X9
DALJE NË DET	-	X10
SHTETI LIGJOR	LN [(E DREJTA E PRONESISE+LIRIA NGÄ KORRUPSIONI)/2]	X11
MADHËSIA E QEVERISË	LN [(LIRIA FISKALE+SHPENZIMET QEVERTARE)/2]	X12
EFIKASITETI RREGULLATOR	LN [(LIRIA E BIZNESIT+LIRIA E PUNES+LIRIA MONETARE)/3]	X13

HAPJA E TREGJEVE	LN [(LIRIA E TREGTISE+LIRIA E INVESTIMEVE+LIRIA FINANCIARE)/3]	X14
------------------	--	-----

Modeli bazë i gravitetit shpjegon flukset tregtare ndërmjet dy vendeve “*i*” dhe “*j*”, (variabli i varur) si një funksion i dy përbërësve kryesorë: masat ekonomike të të dy vendeve (variabli shpjegues) dhe distanca e ponderuar ndërmjet qendrave të tyre ekonomike (variabla shpjegues). Frankel, Stein dhe Wei (1997) kanë kryer një studim gjithëpërfshirës dhe bindës për të matur efektet e marrëveshjeve tregtare dypalëshe dhe shumëpalëshe. Ky material përdor modelin e gravitetit të Frankel, Stein dhe Wei (1997) si një model bazë për të ndërtuar më pas një model të ri ekonometrik që lejon përfshirjen e dinamikave për të shpjeguar flukset tregtare.

Modeli i tyre mund të shkruhet si vijon:

Ekuacioni 3.19

$$\ln tregtia_{ijt} = +a_1 \ln(PBB_{it} * PBB_{jt}) \\ + a_2 \ln(PBBPF_{it} * PBBPF_{jt}) + a_3 \ln(distnanca_{ij})$$

ku: $tregtia_{ijt}$ përfaqëson variablin për t’u shpjeguar, logaritmi i flukseve tregtare reale dypalëshe midis vendeve “*i*” dhe “*j*” në vitin “*t*” ($i, j = 1, \dots, N, i \neq j, t = 1, \dots, T$). Ndërkohë që variablat shpjegues janë si vijon: GDP përfaqëson Prodhimin e Brendshëm Bruto (masa ekonomike e të dy vendeve), GDPPF, përfaqëson Prodhimin e Brendshëm Bruto për Frymë (të ardhura), $Distanca_{ij}$ përfaqëson distancën në kilometra midis qendrave ekonomike të partnerëve tregtarë. Variabli i distancës supozohet si përafrues i koston të transportit midis dy partnerëve tregtarë. a_0 është konstante; a_1, a_2 dhe a_3 , janë koeficientët që do të vlerësohen. Tregtia, GDP, GDPPF dhe Distanca shprehen në terma logaritmi natyrorë. Modeli i gravitetit, i shpjeguar më lart, është i përcaktuar për t’u aplikuar në një model *cross-section* OLS. Për të arritur një rezultat më të mirë pra për të administruar më mirë variablat që kemi marrë në studim, ne do të përdorim të dhëna *panel*.

Në këtë situatë, modeli i modifikuar për tregtinë, importet dhe eksportet, rezulton të jetë:

Ekuacioni 3.20

$$Y1_{ijt} = \beta_0 + \beta_1 X1_{ij} + \beta_2 X2_{it} + \beta_3 X3_{jt} + \beta_4 X4_{ijt} + \beta_5 X5_{jt} + \beta_6 X6_{jt} + \beta_7 X7_{jt} \\ + \beta_8 X8_{jt} + \beta_9 X9_{jt} + \beta_{10} X11_{jt} + \beta_{12} X12_{jt} + \beta_{13} X13_{jt} + \beta_{14} X14_{jt}$$

Ekuacioni 3.21

$$Y2_{ijt} = \beta_0 + \beta_1 X1_{ij} + \beta_2 X2_{it} + \beta_3 X3_{jt} + \beta_4 X4_{ijt} + \beta_5 X5_{jt} + \beta_6 X6_{jt} + \beta_7 X7_{jt} \\ + \beta_8 X8_{jt} + \beta_9 X9_{jt} + \beta_{10} X11_{jt} + \beta_{12} X12_{jt} + \beta_{13} X13_{jt} + \beta_{14} X14_{jt}$$

Ekuacioni 3.22

$$Y3_{ijt} = \beta_0 + \beta_1 X1_{ij} + \beta_2 X2_{it} + \beta_3 X3_{jt} + \beta_4 X4_{ijt} + \beta_5 X5_{jt} + \beta_6 X6_{jt} + \beta_7 X7_{jt} \\ + \beta_8 X8_{jt} + \beta_9 X9_{jt} + \beta_{10} X11_{jt} + \beta_{12} X12_{jt} + \beta_{13} X13_{jt} + \beta_{14} X14_{jt}$$

3.8 Përfundime

Në këtë kapitull u trajtuan metodat më të mira për vlerësimin e modelit të gravitetit.

Përdorimi i të dhënave *panel* ka përparësi ndaj vlerësuesve të të dhënave *ndër-seksionale*, pasi të dhënat *panel* lejojnë vlerësimin e të dhënave në periudha të ndryshme kohore. Gjithashtu, pavarësisht kompleksitetit në trajtimin kompjuterik të tyre, të dhënat *panel* japin rezultate më konsistente për vlerësimin e modelit të gravitetit sesa OLS.

Të dhënat *panel* me efekte fikse, efekte të rastit dhe *pooled OLS* janë përdorur gjithashtu gjerësisht në vlerësimin e modelit të gravitetit. Gjithsesi, përdorimi i njërës apo tjetrës metodë duhet të zgjidhet me kujdes pasi të jenë vlerësuar kufizimet dhe përparësitë e secilës në lidhje me konsistencën dhe efikasitetin e vlerësuesve. Këto metoda dhe teste do të përdoren në kapitullin V për vlerësimin e modelit të gravitetit për një *panel* vendesh.

Gjithashtu në këtë kapitull është përshkruar metoda se si do të analizohet drejtimi i tregtisë dhe një përshkrim i shkurtër i variablave të cilët do të konsiderohen në model

Në figurën 3.1 paraqiten në mënyrë të përmbledhur hapat që do të ndjekim në kapitullin në vijim:




Figura 3.1: Paraqitja e “algoritmit” të metodologjisë
Burimi: llogaritjet e autorit

4. ANALIZA E REZULTATEVE DHE GJETJET.

Qëllimi kryesor i këtij kapitulli është të vlerësojë modelin e gravitetit për tregtinë dypalëshe dhe më pas të vlerësojë potencialin e tregut duke dhënë sygjerrime për drejtimin e tregtisë. Analiza empirike në këtë kapitull është e ndarë në tre seksione.

Në seksionin e parë ne japim rezultatet e analizës së importeve, eksporteve dhe totalit të tregtisë duke përdorur metodën Pooled OLS, (FE) metodën me efekte fikse dhe (RE) metodën me efekte rastësore.

Në seksionin e dytë do të vlerësojmë nëse teknika me efekte fikse apo teknika me efekte rastësore është më e qëndrueshme duke u bazuar në testin Hausman.

Rezultatet e testit Hausman do të na japin metodën më të përshtatshme, të cilën do të zgjedhim për të vlerësuar ekuacionin e gravitetit për eksportet importet dhe totalin e tregtisë.

Në seksionin e tretë do të bëjmë vlerësimin e potencialit të tregut të Shqipërisë me vendet e marra në shqyrtim duke bërë një analizë nëse jemi duke shfrytëzuar ose jo potencialin tonë tregtar.

Në mënyrë që rezultatet tona të jenë të besueshme, ne duhet të sigurohemi që të dhënat nuk na japin rezultate të deformuara, për këtë arsye do të kontrollojmë variablat tanë për: linearitetin në parametra, multikolinearitetin, heteroskedasticitetin, korrelacionin serial dhe stacionaritetin. Nëse të dhënat tona kanë problem, atëherë ne duhet t'i korrigjojmë këto probleme.

4.1 Lineariteti në parametra.

Mënyra më e lehtë për të parë për linearitetin në parametra është mënyra grafike. Siç edhe kemi supozuar në modelin tonë, lidhja ndërmjet variablave të varur dhe të pavarur duhet të jetë lineare. Në figurat 4.1 jepet marrdhënia ndërmjet eksportit-pgdp (figura 4.1,a) dhe import-pgdp (figura 4.1,b), siç edhe shohim nga tabela, kemi një marrdhënie lineare ndërmjet këtyre variablave.

Tabela 4.1,a: Testimi mbi linearitetin në parametra, (Y3-X3)

Dependent Variable: y3

Equation	Model Summary					Parameter Estimates			
	R Square	F	df1	df2	Sig.	Constant	b1	b2	b3
Linear	.196	104.990	1	432	.000	-19.760	1.263		

Quadratic	.203	54.763	2	431	.000	64.111	-5.319	.129	
Cubic	.203	54.755	2	431	.000	36.118	-2.028	.000	.002

The independent variable is x3.

Burimi: llogaritjet e autorit

Testi është kryer me programin SPSS 20.0

Tabela 4.1,b: Testimi mbi linearitetin në parametra, (Y2-X3)

Dependent Variable: y2

Equation	Model Summary					Parameter Estimates			
	R Square	F	df1	df2	Sig.	Constant	b1	b2	b3
Linear	.312	196.277	1	432	.000	-7.172	.912		
Quadratic	.315	98.920	2	431	.000	-33.863	3.007	-.041	
Cubic	.315	98.920	2	431	.000	-33.863	3.007	-.041	.000

The independent variable is x3.

Burimi: llogaritjet e autorit

Testi është kryer me programin SPSS 20.0




Figura 4.1: Lidhja lineare eksport-GDP dhe import-GDP

Burimi: llogaritjet e autorit

Nga figura 4.1 shohim se kemi një marrdhënie pozitive të eksporteve (figura 4.1,a) dhe importeve (figura 4.1,b) me rritjen e GDP së partnerëve, si dhe marrdhënia ndërmjet tyre është lineare (pvalue=0.000). Siç edhe shohim nga grafikët, ne konkludojmë se keta variabla kanë marrdhënie lineare ndërmjet tyre.

Në tabelën 4.2 janë përfshirë të gjithë variablat e marrë në studim dhe me anë të analizës RCE⁶⁸ është parë nëse marrdhënia e variablave Y (të varur) me X (të pavarur) janë lineare, kuadratik apo kubik.

Vlerat korresponduese në matricën e mëposhtme përfaqësojnë p-value për çdo lidhje lineare në çift të y_i me x_i

Tabela 4.2: Testimi mbi marrdhënien lineare, kuadratike apo kubike të variablave të pavarur me variablat e varur.

variablat e varur	y1			y2			y3		
variablat e pavarur	linear	kuadratik	kubik	linear	kuadratik	kubik	linear	kuadratik	kubik
x1	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
x2	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
x3	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
x4	0.002	0.007	0.007	0.000	0.001	0.001	0.001	0.006	0.006
x5	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
x6	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
x11	0.029	0.000	0.000	0.585	0.033	0.051	0.048	0.029	0.039
x12	0.058	0.059	0.067	0.070	0.005	0.005	0.003	0.014	0.014
x13	0.089	0.542	0.042	0.079	0.207	0.207	0.076	0.758	0.761
x14	0.029	0.000	0.000	0.009	0.000	0.000	0.030	0.002	0.002

Burimi: llogaritjet e autorit

Testi është kryer me programin SPSS 20.0

Vlerat e tabelës përfaqësojnë p-value, lidhja është e pranueshme nëse p-value<0.5

⁶⁸ Regression curve estimation

Për të parë rezultatet e variablave që përbëjnë bazën e ekuacionit të gravitetit shiko në apendiks.

4.2 Multikolineariteti

Multikolineariteti do të thotë se variablat e pavarur janë të lidhur me njëri-tjetrin. Kushti ynë është që variablat tanë të mos kenë një lidhje perfekte ndërmjet tyre. Këtë e shohim me anë të matricës së korrelacionit ose me anë të testit VIF⁶⁹.

Rregulli që duhet të njohim në këtë analizë është:

$VIF < 5$

Nëse VIF është më e vogël se vlera 5, nuk kemi prezencë të multikolinearitetit.

$10 \geq VIF \geq 5$

Nëse VIF është më e madhe se vlera 5 themi se kemi prezencë multikolineariteti, por nuk përbën problem të madh.

$VIF > 10$

Nëse VIF është më e madhe se vlera 10, themi se kemi multikolineariteti ndërmjet variablave dhe në këtë situatë duhet të ndërhyjmë duke hequr variablin që na shkakton problemin.

Nga tabela 4.3 ne shohim se nuk kemi prezencë të lartë të multikolinearitetit, të gjitha vlerat VIF janë nën vlerën 10.

Tabela 4.3: Testimi i multikolinearitetit.

Coefficients ^a			
Model		Collinearity Statistics	
		Tolerance	VIF
	X1	.452	2.210
	X2	.788	1.270
	X3	.811	1.233
	X4	.184	5.440
	X5	.175	5.716

⁶⁹ Variance inflation factor $VIF = \frac{1}{1-R^2}$

X6	.266	3.766
X7	.464	2.153
X8	.381	2.627
X9	.683	1.464
X10	.586	1.705
X11	.354	2.825
X12	.401	2.496
X13	.440	2.274
X14	.497	2.011

Burimi: llogaritjet e autorit

Testi është kryer me programin SPSS 20.0

Variablat e përfshirë në model nuk paraqesin problem multikolineariteti, sepse nuk janë të lidhura në mënyrë perfekte.

4.3 Homoskedasticiteti dhe korrelacioni serial në të dhëna.

Për të testuar për mundësinë e prezencës së heteroskedasticitetit mund të bëjmë një seri testesh statistikore, siç mund të jenë Cook-Weisberg, white test, breusch-pagan e të tjera. Përgjithsisht në analizat e tregtisë së jashtme heteroskedasticiteti është një problem që ekziston, por a kemi prezencë heteroskedasticiteti në modelin tonë?

Përdorim dy teste për të vlerësuar prezencën e heteroskedasticitetit Cook-Weisberg dhe white test. Në tabelën 4.4 ne shohim se dhe të dhënat tona kanë prezencë heteroskedasticiteti.

Tabela 4.4: Testimi për heteroskedasticitetin.

	Chi-Square	Sig.
White test	1721,08	0.000
Cook-Weisberg	1623,12	0.000

Burimi: llogaritjet e autorit

Testi është kryer me programin SPSS 20.0

Tre janë mënyrat për të zgjidhur këtë problem:

- Rispecifikim i modelit,
- Të përdorim metodën WLS (Weighted least square),
- Të përdorim metodën Huber-White's (robust standart error) për të korrigjuar shmangiet e termit të gabimit.

Mënyra e parë nuk është e papërshtatshme për modelin tonë, sepse ekuacioni na duhet i formës log-log për të marrë koeficientët e elasticitetit, mënyra e dytë nuk është e përshtatshme gjithashtu, sepse ne jemi duke përdorur teknikat me efekte fikse dhe rastësore (RE dhe FE), në këtë situatë mënyra e tretë është më e përshtatshme.

Me qëllim që të marrim vlerësime më të mira të pazhvendosura, na duhet që të dhënat tona të mos vuajnë nga korrelacioni serial në termat e gabimit, që do të thotë se: $cov(e_{it}, e_{js}) = E(e_{it}, e_{js}) = 0$ për $i \neq j$ ose $t \neq s$

Për të parë nëse vlerësimi ynë vuan nga korrelacioni serial në termat e gabimit, ne aplikojmë Wooldridge test.

$$H_0: \rho = 0 \text{ dhe Alt: } \rho \neq 0$$

p-value është e barabartë me 0.231 që do të thotë se pranohet H_0 dhe hidhet poshtë hipoteza Alt, në këtë situatë ne nuk duhet të shqetësohemi, sepse vlerësimi ynë nuk vuan nga korrelacioni serial në termat e gabimit.

4.4 Stacionariteti

Në mënyrë që të shohim nëse variablat janë stacionarë ose jo, do të përdorim Unit Root Test, duke përfshirë konstanten dhe trendin në ekuacionin që do të testohet.

$$\Delta \text{Exp}/\text{Im} = \alpha + \gamma \text{Exp}/\text{Im}_{t-1} + \lambda t + vt \quad (4.1)^{70}$$

Formalisht një seri kohore është stacionare, nëse mesatarja dhe varianca janë konstante përgjatë kohës si dhe $cov(y_t; y_{t+s}) = cov(y_t; y_{t-s}) = \gamma_s$.

Autoregresioni i rendit të parë (AR1) $y_t = \rho y_{t-1} + vt$ është stacionar nëse, $\rho \neq 1$ dhe kur $\rho = 1$ ai bëhet stacionar.

Testet për këtë qëllim njihen si “unit root tests”. Le të ndërtojmë hipotezën:

$$H_0: \rho = 1 \text{ dhe Alt: } \rho < 1$$

ose

$$H_0: \gamma = 0 \text{ dhe Alt: } \gamma < 0$$

Nëse p-value është më e vogël se alfa 0.05, ne hedhim poshtë hipotezën zero dhe pranojmë atë alternative që do të thotë se seria është stacionare. Vlerat kritike të testit ADF, si testi më i përdorshëm për të parë stacionaritetin në variabla, jepen në tabelën 4.5

⁷⁰ AR(1): $y_t = \rho y_{t-1} + vt \leftrightarrow y_t - y_{t-1} = \rho y_{t-1} - y_{t-1} + vt \leftrightarrow \Delta y_t = (\rho - 1)y_{t-1} + vt \leftrightarrow \Delta y_t = \gamma y_{t-1} + vt$

Tabela 4.5: Vlerat kritike të testit Dickey-Fuller.

Modeli \ Niveli rëndësisë	1%	5%	10%
Standarti	-2.33	-1.65	-1.28
$\Delta Exp/Im = \alpha + \gamma Exp/Im_{t-1} + \lambda t + vt$	-3.96	-3.41	-3.13

Burimi: R. Davidson and J.G. MacKinnon (1993), *estimation and inference in econometrics*, New York: Oxford University Press, p.708

Pesë testet e përdorura për këtë qëllim janë LLC, Breitung, IM, ADF, PP. Me supozimin se nëse një nga këto teste jep rezultate të pranueshme për qëllimin tonë, që seria është stacionare, ne serinë do e konsiderojmë të tillë.

Në tabelën 4.6 jepen rezultatet e të pestë testeve të kryera për të gjithë variablat e marrë në vlerësimin e modelit të gravitetit.

Tabela 4.6: Rezultatet e testeve LLC, Breitung, Im, ADF dhe PP për stacionaritetin.

Variablat	Levin, Lin & Chu t*		Breitung t-stat		Im, Pesaran and Shin F-stat		ADF-Fisher Chi-square		PP-Fisher Chi-square	
	Level	First Difference	Level	First Difference	Level	First Difference	Level	First Difference	Level	First Difference
lnTT	-5.7397 ***	-14.4274 ***	1.22839	-8.78410 ***	-1.0923	-9.4272 ***	84.9021 **	220.150 ***	93.654 ***	385.74 ***
lnimportet	-6.64570 ***	-13.5544 ***	1.69925	-7.9574 ***	-1.6413 **	-12.485 ***	95.3969 ***	238.753 ***	91.317 ***	365.77 ***
lneksportet	-10.705 ***	-16.4636 ***	1.01936	-8.3726 ***	-5.3836 ***	-13.132 ***	140.154 ***	251.059 ***	182.730 ***	360.97 ***
lnrgdp	0.95080	-22.5125 ***	7.32951	-8.7388 ***	10.276	-12.278 ***	1.45198	253.861 ***	0.0515	295.33 ***
lnpgdp	-0.6842	-19.1244 ***	4.63562	-9.313 ***	7.1498	-11.272	10.8674	231.075 ***	4.3651	344.67 ***

		***				***				
lnpgdp/fryme	-1.9656 **	-17.7326 ***	2.91246	-9.3818 ***	5.4829	-8.7414 ***	15.8579	188.763 ***	5.6161	249.17 ***
rritja ekonomike	-12.574 ***	-18.2531 ***	-9.0706	-12.5539 ***	-4.9251 ***	-9.729 ***	120.245 ***	200.748 ***	156.09 ***	425.309 ***
lnshtetiligjor	-7.6746 ***	-11.2396 ***	-0.6921	-5.5312 ***	-3.0739 ***	-5.8916 ***	103.255 ***	135.992 ***	103.25 ***	185.62 ***
lnmadhesiaeqeverise	-8.5371 ***	-17.4823 ***	0.59663	-3.1067 ***	-2.2403 ***	-11.181 ***	88.7993 ***	222.590 ***	96.344 ***	302.6 ***
lnefikasitetirregullator	-3.55 ***	-14.5524 ***	-0.83300	-8.7294 ***	0.5682	-8.5394 ***	53.4271	176.428 ***	61.78	258.18 ***
lnhapjaetregjeve	-15.449 ***	-20.8032 ***	-1.2288	-6.0067 ***	-6.8146 ***	-13.31 ***	142.823 ***	245.391 ***	149.03 ***	326.25 ***

Burimi: llogaritjet e autorit

*** tregon rëndësinë në 99%, ** tregon rëndësinë në 95% dhe * tregon rëndësinë në 90%

Testi është kryer me programin EVIEES 8

Në bazë të testit LLC, Breitung, IM, ADF dhe PP ne shohim se seritë *rgdp* dhe *pgdp* nuk janë stacionare në nivel, për t'i kthyer seritë në stacionare aplikojmë diferencën e parë. Duke aplikuar diferencën e parë shohim se të pestë testet për këto dy seri japin të njëjtin rezultat në nivel besueshmërie 99%, seritë janë stacionare.

Të gjithë variablat e tjerë si: hapja e tregjeve, efikasiteti rregullator, madhësia e qeverisë, shteti ligjor, inflacioni, indeksi i performancës së logistikës, rritja ekonomike, GDP për frymë, importet, eksportet dhe hapja e tregjeve, janë stacionarë në nivel.

Pasi pamë se nuk kemi ndonjë thyerje të supozimeve, ne mund të vlerësojmë modelin pa u shqetësuar se mund të gjenerojmë rezultate jo të sakta. Me anë të testit Hausman, ne do të dallojmë se cila teknike është më e përshtatshme.

4.5 Rezultatet sipas teknikes Pool OLS, me efekte fikse dhe rastësore.

Duke qenë se është më e pritshme që variablat tanë të ndryshojnë në përqindje, dhe që nga ana sasiore efektet të interpretohen si elasticitete, variabli i varur dhe variablat e pavarur të vazhdueshëm janë përfshirë në model të logaritmuar.

4.5.1 Metoda Pool OLS.

Teknika pooled OLS është një mënyrë e thjeshtë dhe e shpejtë e krahasimit të regresioneve të sofistikuara. Kjo metodë nuk bën ndonjë dallim midis të dhënave *cross section* dhe të *serive kohore*.

a- Vlerësimi i tregtisë.

Në tabelën 4.7 jepet vlerësimi i tregtisë së jashtme me variablat e varur si: GDP-ja e vendeve respektive, GDP-ja për frymë, rritja ekonomike, indeksi i performancës së

logjistikës, MTL-të, shteti ligjor, madhësia e qeverisë, efikasiteti rregullator dhe hapja e tregjeve duke përdorur teknikën pooled OLS.

Tabela 4.7: Rezultatet e vlerësimit të tregtisë me metodën pooled OLS.

Dependent Variable: Y1

Method: Panel Least Squares

Sample: 2001 2014

Periods included: 14

Cross-sections included: 32

Total panel (unbalanced) observations: 448

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
X1	-3.358941	0.172371	-19.48674	0.0000
X2	0.887111	0.162103	5.472513	0.0000
X3	0.993765	0.053964	18.41539	0.0000
X4	-0.103219	0.147386	-0.700330	0.4841
X5	-0.024624	0.015507	-1.587933	0.1131
X6	4.643910	0.875952	5.301557	0.0000
X7	0.567456	0.134592	4.216119	0.0000
X8	-0.039271	0.157951	-0.24862	0.8038
X9	0.002480	0.235722	0.010521	0.9916
X10	0.691286	0.125394	5.512929	0.0000
X11	1.305379	0.311101	4.196004	0.0000
X12	1.080445	0.208766	5.175380	0.0000
X13	1.267729	0.662303	1.914123	0.0563
X14	2.472526	0.649877	3.804607	0.0002
C	-4.274591	3.794749	-1.126449	0.2606
R-squared	0.819541	Mean dependent var	16.64545	
Adjusted R-squared	0.813453	S.D. dependent var	2.378496	
S.E. of regression	1.027298	Akaike info criterion	2.926001	
Sum squared resid	437.9663	Schwarz criterion	3.067761	
Log likelihood	-614.0903	Hannan-Quinn criter.	2.981978	
F-statistic	134.6209	Durbin-Watson stat	0.751310	
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: llogaritjet e autorit

Rezultatet janë gjeneruar duke përdorur EVIEWS 8

Siç mund të shihet nga Tabela 4.7 variablat e pavarur kanë fuqi shpjeguese, pasi testi i Fisher e ka vlerën 134.6209 dhe probabiliteti për të vëzhguar një vlerë sa kjo për një

variabël rasti me shpërndarje Fisheri është 0.000. Me përjashtim të variablave si: GDP-ja për frymë, rritja ekonomike, inflacioni, vend i BE dhe vend kufitar, të gjithë variablat e tjerë janë të rëndësishëm në nivelet 1 dhe 5 përqind.

Distanca, ashtu siç sygjeron dhe teoria ndikon negativisht në tregti dhe ka një koeficient elasticiteti të barabartë me 3.3. ky koeficient elasticiteti tregon se ky variabël është elastik në marrdhënie me tregtinë. Pra një rritje me 1% të distancës shoqërohet me uljen me 3.3% të tregtisë dypalëshe.

Masat ekonomike gjithashtu janë të rëndësishme dhe kanë një koeficient elasticiteti më të vogël se një, pra janë joelastik.

Indeksi i performancës së logjistikës është një variabël i rëndësishëm gjithashtu, me një rritje 1% të këtij variabli rritet tregtia me 4.6%. MTL-të janë gjithashtu të rëndësishme, pra pasja e një marrëveshje tregtare me vendet partnere rrit tregtinë dypalëshe. Dalja në det, me një p-value të barabartë 0.000, konsiderohet gjithashtu e rëndësishme.

Madhësia e qeverisë është një variabël që ndikon pozitivisht tek tregtia, kjo do të thotë se një përmirësim i këtij treguesi (barrave të taksave dhe shpenzimeve të tepërta qeveritare), do të ndikonin në intensifikimin e tregtisë së Shqipërisë me ato vende.

Së fundi hapja e tregjeve do të ndikonte në rritjen e tregtisë dypalëshe.

b- Vlerësimi i importeve.

Tabela 4.8 jep vlerësimin e importeve të vendit tonë duke përdorur teknikën Pooled OLS. Ashtu si më sipër modeli në tërësi është i rëndësishëm dhe këtë e shohim nga testi statistikor i Fisherit $F=88.60$ dhe një $p\text{-value}=0.000$. Sipas kësaj teknike importet ndikohen nga variablat si: distanca e ponderuar ndërmjet vendeve, GDP-të respektive, rritja ekonomike, indeksi i performancës së logjistikës në 0.1 nivel rëndësie, MTL-të, vend i BE në 0.1 nivel rëndësie, vend kufitar në 0.1 nivel rëndësie, dalja në det, shteti ligjor, madhësia e qeverisë dhe hapja e tregjeve.

Tabela 4.8: Rezultatet e vlerësimit të importeve me metodën pooled OLS.

Dependent Variable: Y2

Method: Panel Least Squares

Sample: 2001- 2014

Periods included: 14

Cross-sections included: 32

Total panel (balanced) observations: 448

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
X1	-3.727743	0.242453	-15.37509	0.0000
X2	0.884448	0.229722	3.850077	0.0001
X3	1.232009	0.076140	16.18080	0.0000
X4	0.073033	0.207498	0.351968	0.7250
X5	-0.045004	0.021964	-2.048972	0.0411
X6	2.367367	1.237963	1.912308	0.0565

X7	0.023719	0.010128	2.341923	0.0421
X8	-0.419438	0.223247	-1.878805	0.0610
X9	-0.573749	0.333473	-1.720527	0.0861
X10	0.483104	0.177578	2.720524	0.0068
X11	1.794292	0.439889	4.078962	0.0001
X12	0.774534	0.295396	2.622023	0.0091
X13	1.016395	0.937845	1.083756	0.2791
X14	3.649257	0.917632	3.976821	0.0001
C	-3.398490	5.379719	-0.631722	0.5279
R-squared	0.747520	Mean dependent var	16.29908	
Adjusted R-squared	0.739084	S.D. dependent var	2.856516	
S.E. of regression	1.459108	Akaike info criterion	3.627478	
Sum squared resid	892.0488	Schwarz criterion	3.768251	
Log likelihood	-772.1627	Hannan-Quinn criter.	3.683044	
F-statistic	88.60971	Durbin-Eaton stat	1.071851	
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: llogaritjet e autorit

Rezultatet janë gjeneruar duke përdorur EVIEWS 8

c- Vlerësimi i eksporteve.

Vlerësimi i fundit sipas kësaj teknike është ai i eksporteve i paraqitur në tabelën 4.9. Modeli në tërësi paraqitet statistikisht i rëndësishëm, $F=69.06$ me një $p\text{-value}=0.000<0.05$. Variablat që ndikojnë në eksporte sipas kësaj teknike janë: distanca e ponderuar ndërmjet vendeve, GDP-të respektive, rritja ekonomike, indeksi i performancës së logjistikës, MTL-të, dalja në det, shteti ligjor në 0.1 nivel rëndësie dhe efikasiteti rregullator.

Tabela 4.9: Rezultatet e vlerësimit të eksporteve me metodën pooled OLS.

Dependent Variable: Y3				
Method: Panel Least Squares				
Sample: 2001 2014				
Periods included: 14				
Cross-sections included: 31				
Total panel (balanced) observations: 448				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
X1	-7.422696	0.464157	-15.99179	0.0000
X2	2.819068	0.439784	6.410119	0.0000
X3	1.467151	0.145764	10.06525	0.0000
X4	-0.387059	0.397238	-0.974375	0.3304

X5	-0.089522	0.042049	-2.129008	0.0338
X6	9.852208	2.369976	4.157091	0.0000
X7	0.118821	0.030875	3.848453	0.5425
X8	0.385361	0.427388	0.901665	0.3678
X9	-1.044177	0.638406	-1.635600	0.1027
X10	1.665339	0.339957	4.898672	0.0000
X11	1.650704	0.842131	1.960151	0.0506
X12	0.501082	0.565510	0.886071	0.3761
X13	3.947110	1.795426	2.198426	0.0285
X14	1.024585	1.756729	0.583235	0.5600
C	-39.09014	10.29902	-3.795520	0.0002
R-squared	0.697665	Mean dependent var	12.72396	
Adjusted R-squared	0.687563	S.D. dependent var	4.997379	
S.E. of regression	2.793339	Akaike info criterion	4.926303	
Sum squared resid	3269.349	Schwarz criterion	5.067077	
Log likelihood	-1054.008	Hannan-Quinn criter.	4.981869	
F-statistic	69.06278	Durbin-Watson stat	1.223173	
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: llogaritjet e autorit

Rezultatet janë gjeneruar duke përdorur EVIEWS 8

4.5.2 Metoda me efekte fikse.

Modeli me efekte fikse përdoret kur interesi qëndron në analizimin e efekteve të variablave që ndryshojnë në kohë, dhe performanca e modelit çënohet sa herë që në të përfshihen të dhëna për të cilat variacioni brenda grupit është minimal apo për variabla që ndryshojnë pak në kohë. Për këtë arsye, nga lista potenciale e variablave shpjegues janë hequr variablat dummy dhe ai i distancës mes vendeve. Përdorimi i modelit me efekte fikse rekomandohet në rastet kur interesi qëndron në hulumtimin e shkaqeve të ndryshimit brenda njësisë së studimit, meqë karakteristikat që nuk ndryshojnë në kohë janë konstante për çdo njësi dhe, si të tilla, nuk mund të shkaktojnë ndryshime në variabla të tjerë (Kohler dhe Kreuter 2009).

a- Vlerësimi i tregtisë.

Në tabelën 4.10 jepet vlerësimi i tregtisë së jashtme me variablat e varur si: GDP-ja e vendeve respektive, GDP-ja për frymë, rritja ekonomike, indeksi i performancës së logjistikës, shteti ligjor, madhësia e qeverisë, efikasiteti rregullator dhe hapja e tregjeve.

Tabela 4.10: Rezultatet e vlerësimit të tregtisë me metodën e efekteve fikse.

Dependent Variable: Y1

Method: Panel Least Squares

Sample: 2001 2014
 Periods included: 14
 Cross-sections included: 32
 Total panel (unbalanced) observations: 448

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
X2	0.565362	0.319032	1.772115	0.0772
X3	1.510032	1.180936	1.278674	0.2018
X4	-0.260539	1.060011	-0.245789	0.8060
X5	-0.009692	0.012660	-0.765611	0.4444
X6	5.951400	0.906870	6.562571	0.0000
X11	1.335759	0.457530	2.919501	0.0037
X12	0.191408	0.415488	0.460682	0.6453
X13	2.933208	0.968526	3.028527	0.0026
X14	0.606296	0.771677	0.785686	0.4325
C	-30.82444	17.09865	-1.802741	0.0722
Effects Specification				
Cross-section fixed (dummy variables)				
R-squared	0.897715	Mean dependent var	16.64545	
Adjusted R-squared	0.887197	S.D. dependent var	2.378496	
S.E. of regression	0.798846	Akaike info criterion	2.479194	
Sum squared resid	248.2421	Schwarz criterion	2.866671	
Log likelihood	-492.0267	Hannan-Quinn criter.	2.632197	
F-statistic	85.35224	Durbin-Watson stat	1.237359	
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: llogaritjet e autorit
 Rezultatet janë gjeneruar duke përdorur EVIEWS 8

Siç shihet dhe nga tabela, variablat e pavarur kanë një fuqi të lartë shpjeguese duke marrë në konsideratë vlerën e testit Fisher $F=85.35224$, në një nivel rëndësie 1%. ($p\text{-value}=0.000<0.01$).

Variablat e rëndësishëm në këtë model janë: indeksi i performancës së logjistikës, shteti ligjor dhe efikasiteti rregullator. Në nivelin e rëndësisë 10%, GDP-ja e vendit tonë luan një rol të rëndësishëm në vlerësimin e tregtisë totale.

b- Vlerësimi i importeve.

Tabela 4.11 jep vlerësimin e importeve të vendit tonë duke përdorur teknikën me efekte fikse. Ashtu si më lartë modeli në tërësi është i rëndësishëm dhe këtë e shohim nga testi statistikor i Fisherit $F=56.67$ dhe një $p\text{-value}=0.000$. Sipas kësaj teknike importet ndikohen nga variablat si: gdp e vendeve partnere (në nivelin e rëndësisë $\alpha=0.1$), gdp

për frymë, indeksi i performancës së logjistikës, shteti ligjor, efikasiteti rregullator dhe hapja e tregjeve.

Tabela 4.11: Rezultatet e vlerësimit të importeve me metodën e efekteve fikse.

Dependent Variable: Y2
 Method: Panel Least Squares
 Sample: 2001 2014
 Periods included: 14
 Cross-sections included: 32
 Total panel (balanced) observations: 448

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
X2	0.547071	0.458128	1.194146	0.2331
X3	3.036662	1.694354	1.792224	0.0739
X4	5.357515	1.509947	3.548147	0.0004
X5	-0.017368	0.018217	-0.953395	0.3410
X6	3.093917	1.307943	2.365484	0.0185
X11	2.662988	0.656724	4.054959	0.0001
X12	0.072649	0.597745	0.121539	0.9033
X13	5.084803	1.383863	3.674355	0.0003
X14	2.825002	1.101470	2.564757	0.0107
C	48.72403	24.44231	1.993430	0.0469
Effects Specification				
Cross-section fixed (dummy variables)				
R-squared	0.852261	Mean dependent var	16.29908	
Adjusted R-squared	0.837224	S.D. dependent var	2.856516	
S.E. of regression	1.152474	Akaike info criterion	3.211405	
Sum squared resid	521.9814	Schwarz criterion	3.596185	
Log likelihood	-655.8748	Hannan-Quinn criter.	3.363286	
F-statistic	56.67763	Durbin-Watson stat	1.863768	
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: llogaritjet e autorit
 Rezultatet janë gjeneruar duke përdorur EVIEWS 8

c- Vlerësimi i eksporteve.

Tabela 4.12 jep vlerësimin e eksporteve të vendit tonë duke përdorur teknikën me efekte fikse. Ashtu si dhe vlerësimet e mësipërme, modeli në tërësi është i rëndësishëm dhe këtë e shohim nga testi statistikor i Fisherit $F=32.1164$ dhe një $p\text{-value}=0.000$. Siç e shohim

dhe nga tabela eksportet ndikohen nga variabla si: GDP-ja e vendeve partnere, GDP-ja për frymë, rritja ekonomike, indeksi i performancës së logjistikës, madhësia e qeverisë dhe efikasiteti rregullator.

Tabela 4.12: Rezultatet e vlerësimit të eksporteve me metodën e efekteve fikse.

Dependent Variable: Y3
Method: Panel Least Squares
Sample: 2001 2014
Periods included: 14
Cross-sections included: 32
Total panel (balanced) observations: 448

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
X2	0.423492	1.009230	0.419619	0.6750
X3	11.49056	3.732569	3.078458	0.0022
X4	-6.095044	3.326331	-1.832363	0.0677
X5	-0.118052	0.040131	-2.941666	0.0035
X6	3.702515	1.081325	3.424053	0.0009
X11	0.633584	1.446726	0.437944	0.6617
X12	2.905686	1.316800	2.206627	0.0279
X13	11.00705	3.048573	3.610558	0.0003
X14	0.181728	2.426477	0.074894	0.9403
C	-175.7445	53.84505	-3.263894	0.0012

Effects Specification

Cross-section fixed (dummy variables)

R-squared	0.765745	Mean dependent var	12.72396
Adjusted R-squared	0.741902	S.D. dependent var	4.997379
S.E. of regression	2.538837	Akaike info criterion	4.790994
Sum squared resid	2533.158	Schwarz criterion	5.175775
Log likelihood	-998.6458	Hannan-Quinn criter.	4.942876
F-statistic	32.11640	Durbin-Watson stat	1.546833
Prob(F-statistic)	0.000000		

Burimi: llogaritjet e autorit

Rezultatet janë gjeneruar duke përdorur EVIEWS 8

Në të tre analizat e mësipërme ne shohim se një variabël shpjegues është i rëndësishëm për të tre variablat e shpjeguar (tregtia totale, importet, eksportet), me një nivel rëndësie p-value=0.000. Variabli x_6 (indeksi LPI) është një variabël që ka një lidhje të drejtë me variablat y_1 (tregtia totale), y_2 (importet) dhe y_3 (eksportet). Një rritje e këtij variabli me 1% do të sillte rritjen e tregtisë totale me 5.9%, importeve me 3% dhe eksporteve me 3.7%.

4.5.3 Metoda me efektet te rastit.

Modelet me efekte të rastit përdoren kur kërkuesi ka arsye për të besuar se variabli i varur ndikohet nga ndryshimet mes njësive nën investigim. Këto modele kanë si avantazh faktin që në to mund të kontrollohet për variabla që nuk ndryshojnë në kohë, siç janë në rastin tonë treguesi I kufirit të përbashkët dhe distanca.

Rezultatet e vlerësimit të tregtisë totale, importeve dhe eksporteve janë paraqitur në Tabelat 4.13, 4.14 dhe 1.15 respektivisht dhe tregojnë se ky model performon më mirë në bazë të kriterit teorik të origjinës së modelit bazë të gravitetit.

a- Vlerësimi i tregtisë .

Modeli paraqitet përgjithësisht më mirë se në rastin me efekte fikse. Për më tepër, variablat e produktit të brendshëm bruto të Shqipërisë (X2) dhe vendit partner (X3) paraqiten me shenjë të duhur dhe të rëndësishëm. Variabli i distancës (X1) vlerësohet të ketë efekt negativ, një rezultat ky që është konsistent me teorinë.

Tabela 4.13: Rezultatet e vlerësimit të tregtisë me metodën e efekteve të rastit.

Dependent Variable: Y1

Method: Panel EGLS (Cross-section random effects)

Sample: 2001 2014

Periods included: 14

Cross-sections included: 32

Total panel (unbalanced) observations: 448

Swamy and Arora estimator of component variances

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
X1	-3.645236	0.390689	-9.330275	0.0000
X2	0.869322	0.195380	4.449390	0.0000
X3	0.959407	0.109672	8.748007	0.0000
X4	-0.116603	0.248060	-0.470060	0.6386
X5	-0.010330	0.012494	-0.826783	0.4088
X6	5.619011	0.866081	6.487856	0.0000
X7	0.156021	0.070500	2.213063	0.0236
X8	0.108308	0.403984	0.268100	0.7888
X9	0.056830	0.618208	0.091927	0.9268
X10	0.683803	0.314400	2.174948	0.0302
X11	1.250456	0.408926	3.057900	0.0024
X12	0.646679	0.322010	2.008260	0.0453
X13	2.704318	0.859143	3.147693	0.0018
X14	0.854367	0.726179	1.176525	0.2401

C	-0.840660	5.210832	-0.161329	0.8719
R-squared	0.627878	Mean dependent var	4.666019	
Adjusted R-squared	0.615324	S.D. dependent var	1.273675	
S.E. of regression	0.801282	Sum squared resid	266.4520	
F-statistic	50.01602	Durbin-Eatson stat	1.160556	
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: llogaritjet e autorit

Rezultatet janë gjeneruar duke përdorur EVIEWS 8

Rezultatet kanë një shpjgueshmëri të importeve me $R^2=38\%$, çka do të thotë se variablat e përzgjedhur e shpjgojnë modelin me rreth 40% dhe me një p-value < 0.05 më shumë se gjysma e variablave janë të rëndësishëm.

Modeli që kemi zgjedhur, është statistikisht i rëndësishëm në tërësi, kjo evidentohet nga statistika F, e cila është e rëndësishme me p-value = 0.0000<0.05.

b- Vlerësimi i importeve.

Në tabelën 4.14 janë vlerësuar importet me teknikën e efekteve të rastit. Edhe ky vlerësim përgjithësisht është më mirë se në rastin me efekte fikse.

Tabela 4.14: Rezultatet e vlerësimit të importeve me metodën e efekteve të rastit.

Dependent Variable: Y2

Method: Panel EGLS (Cross-section random effects)

Sample: 2001 2014

Periods included: 14

Cross-sections included: 32

Total panel (balanced) observations: 448

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
X1	-4.323961	0.557585	-7.754806	0.0000
X2	0.676410	0.280883	2.408155	0.0165
X3	1.190960	0.157111	7.580366	0.0000
X4	0.562370	0.352581	1.595007	0.1115
X5	-0.023417	0.017980	-1.302395	0.1935
X6	2.484211	1.247706	1.991023	0.0471
X7	0.023719	0.009128	2.598488	0.0176
X8	0.545879	0.578143	0.944194	0.3456
X9	0.872971	0.884271	0.987222	0.3241
X10	0.496223	0.450119	1.102426	0.2709
X11	2.133849	0.587859	3.629864	0.0003

X12	0.554357	0.462990	1.197341	0.2319
X13	3.706587	1.231212	3.010520	0.0028
X14	2.820567	1.038319	2.716474	0.0069
C	9.127611	7.438019	1.227156	0.2205

Weighted Statistics			
R-squared	0.485930	Mean dependent var	4.591312
Adjusted R-squared	0.468754	S.D. dependent var	1.605259
S.E. of regression	1.170020	Sum squared resid	573.5883
F-statistic	28.29030	Durbin-Watson stat	1.657628
Prob(F-statistic)	0.000000		

Burimi: llogaritjet e autorit

Rezultatet janë gjeneruar duke përdorur EVIEWS 8

Rezultatet në tabelën 4.14 japin një shpjegueshmëri të importeve me $R^2=48\%$, çka do të thotë se variablat e përzgjedhur e shpjegojnë modelin afersisht 50% dhe me një p-value < 0.05 tregon se gjysma e variablave janë të rëndësishëm.

Modeli që kemi zgjedhur, është statistikisht i rëndësishëm në tërësi, kjo evidentohet nga statistika F, e cila është e rëndësishme me p-value = $0.0000 < 0.05$.

c- Vlerësimi i eksporteve.

Vlerësimi i eksporteve me efekte rastësore është dhënë në tabelën 4.15. Modeli jep rezultate konsistente me teorinë duke theksuar se distanca ndërmjet vendeve është e rëndësishme dhe ka shenjë negative ndërsa masat ekonomike kanë shenjë pozitive dhe gjithashtu të rëndësishme.

Tabela 4.15: Rezultatet e vlerësimit të eksporteve me metodën e efekteve të rastit.

Dependent Variable: Y3

Method: Panel EGLS (Cross-section random effects)

Sample: 2001 2014

Periods included: 14

Cross-sections included: 32

Total panel (balanced) observations: 448

Swamy and Arora estimator of component variances

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
X1	-7.459637	0.779928	-9.564522	0.0000
X2	2.719136	0.521254	5.216527	0.0000
X3	1.290461	0.223173	5.782330	0.0000
X4	-0.059207	0.579087	-0.102241	0.9186
X5	-0.097129	0.039264	-2.473762	0.0138

X6	13.10232	2.597590	5.044031	0.0000
X7	0.118821	0.032075	3.848453	0.0001
X8	0.349320	0.763201	0.457704	0.6474
X9	0.985218	1.161248	0.848413	0.3967
X10	1.546894	0.598349	2.585271	0.0101
X11	0.872681	1.125532	0.775350	0.4386
X12	0.921053	0.815150	1.129918	0.2592
X13	7.365860	2.345629	3.140250	0.0018
X14	0.902082	2.097636	0.430047	0.6674
C	-18.97740	12.81667	-1.480681	0.1394
R-squared	0.540486	Mean dependent var	6.153509	
Adjusted R-squared	0.525132	S.D. dependent var	3.754539	
S.E. of regression	2.587277	Sum squared resid	2804.788	
F-statistic	35.20232	Durbin-Watson stat	1.406943	
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: llogaritjet e autorit

Rezultatet janë gjeneruar duke përdorur EVIEWS 8

Rreth 50% e variablave të pavarur janë të rëndësishëm duke bërë që modeli të performojë më mirë se ai me efekte fikse.

Me një $F=35.2$ modeli është i rëndësishëm në tërësi.

4.6 Testi Hausman

Procedura vijon me kryerjen e testit Hausman për të vendosur mes modeleve. Hipoteza zero e testit është se modeli i preferuar është modeli me efekte të rastit, ndërsa ajo alternative favorizon modelin me efekte fikse. Në parim, testi është një test korrelacioni i termit të gabimit idiosinkratik me variablat shpjegues, dhe nën hipotezën zero ky korrelacion është zero.

Hipoteza që ndërtojmë është:

H_0 : teknika RE është e përshtatshme

Alt: teknika FE është e përshtatshme

4.6.1. Testi Hausman për tregtinë dhe vlerësimi i ekuacionit të gravitetit.

Vlera $\text{Chi-Sq}=12.338284$ që i korrespondon një vlere p-value 0.2631, e cila është më e madhe se vlera 0.05 që do të thotë se teknika RE është më e përshtatshme.

Tabela 4.16: Rezultatet e testit Hausman për tregtinë.

Correlated Random Effects - Hausman Test		
Test cross-section random effects		
Test Summary	Chi-Sq. Statistic	Prob.
Cross-section random	12.338284	0.2631

Burimi: llogaritjet e autorit

Rezultatet janë gjeneruar duke përdorur EVIEWS 8

Duke bërë analizën hap pas hapi rivlerësohet edhe njëhere modeli me efekte të rastit vetëm për variablat sinjifikant dhe modeli ynë final për tregtinë merr formën e mëposhtme:

$$Y_1 = -0.442937 - 3.700411(x_1) + 0.775489(x_2) + 0.952920(x_3) + 5.365755(x_6) + 2.246766(x_7) + 0.679472(x_{10}) + 1.062005(x_{11}) + 0.636715(x_{12}) + 3.058497(x_{13})$$

Tabela 4.17: Rezultatet e rivlerësimit të tregtisë me metodën e efekteve të rastit.

Dependent Variable: Y1

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
X1	-3.700411	0.283046	-13.07354	0.0000
X2	0.775489	0.123404	6.284159	0.0000
X3	0.952920	0.097222	9.801476	0.0000
X6	5.365755	0.825729	6.498203	0.0000
X7	2.246766	0.558362	4.023851	0.0000
X10	0.679472	0.286782	2.369301	0.0183
X11	1.062005	0.342865	3.097439	0.0021
X12	0.636715	0.303600	2.097220	0.0366
X13	3.058497	0.724585	4.221034	0.0000
C	-0.442937	3.256793	-0.136004	0.8919
R-squared	0.630309	Mean dependent var	4.858746	
Adjusted R-squared	0.623284	S.D. dependent var	1.283928	
S.E. of regression	0.799995	Sum squared resid	269.4364	
F-statistic	89.72358	Durbin-Ėatson stat	1.140482	
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: llogaritjet e autorit

Rezultatet janë gjeneruar duke përdorur EVIEWS 8

Distanca dhe masat ekonomike në këtë model janë konsistente me teorinë e modelit të gravitetit. Një rritje e distancës me 1% do të shoqërohet me rënie të tregtisë me 3.7%. Ndërsa për sa i përket GDP-ve lidhja është pozitive por me një koeficient elasticiteti nën vlerën një.

Për sa i përket indeksit të performancës së logjistikës, ky koeficient është i rëndësishëm me një lidhje pozitive me tregtinë dhe me një koeficient elasticiteti më të madh se një, kjo do të thotë se përmirësimi i këtij indeksi do të jepte një efekt multiplikativ në tregti. Dalja në det gjithashtu është e rëndësishme me një koeficient elasticiteti $0.6 < 1$. MTL-të ndikojnë pozitivisht në tregti.

Shteti ligjor, madhësia e qeverisë dhe efikasiteti rregullator gjithashtu janë të rëndësishëm dhe me efekt pozitiv në tregti.

4.6.2 Testi Hausman për importet dhe vlerësimi i ekuacionit të gravitetit.

Vlera Chi-Sq=3.695405 që i korrespondon një vlere p-value 0.1576, e cila është më e madhe se vlera 0.05 që do të thotë se teknika RE është më e përshtatshme.

Tabela 4.18: Rezultatet e testit Hausman për importet.

Correlated Random Effects - Hausman Test		
Test cross-section random effects		
Test Summary	Chi-Sq. Statistic	Prob.
Cross-section random	3.695405	0.1576

Burimi: llogaritjet e autorit

Rezultatet janë gjeneruar duke përdorur EVIEWS 8

Duke bërë analizën hap pas hapi rivlerësohet edhe njëherë modeli me efekte të rastit vetëm për variablat sinjifikant dhe modeli ynë final për importet merr formën e mëposhtme:

$$Y_2 = -1.029023 - 3.898743(x_1) + 1.117160(x_2) + 1.183539(x_3) + 2.791392(x_6) + 0.199327(x_7) + 2.444812(x_{11}) + 3.706661(x_{13}) + 2.573389(x_{14})$$

Tabela 4.19: Rezultatet e rivlerësimit të importeve me metodën e efekteve të rastit.

Dependent Variable: Y2

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
X1	-3.898743	0.395887	-9.848125	0.0000
X2	1.117160	0.186859	5.978635	0.0000

X3	1.183539	0.140386	8.430636	0.0000
X6	2.791392	1.226626	2.275666	0.0234
X7	0.199327	0.028693	6.946799	0.0000
X11	2.444812	0.531707	4.598047	0.0000
X13	3.706661	1.072093	3.457406	0.0006
X14	2.573389	1.029537	2.499559	0.0128
C	1.029023	4.739247	0.217128	0.8282
R-squared	0.481399	Mean dependent var	4.770658	
Adjusted R-squared	0.472878	S.D. dependent var	1.617152	
S.E. of regression	1.174104	Sum squared resid	587.2497	
F-statistic	56.49164	Durbin-Watson stat	1.606791	
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: llogaritjet e autorit
Rezultatet janë gjeneruar duke përdorur EVIEWS 8

Edhe në vlerësimin e importeve distanca dhe masat ekonomike janë konsistente me teorinë. Distanca ka një efekt negative në importe dhe një koeficient elasticiteti të barabartë me 3.898743. Indeksi i performancës së logjistikës luan një rol të rëndësishëm në importe duke ndikuar pozitivisht dhe me një koeficient elasticiteti të lartë 2.791392 që do të thotë se një përmirësim sado i vogël në këtë indeks do të rriste importet në një nivel më të lartë. Shteti ligjor, efikasiteti rregullator dhe hapja e tregjeve ndikon pozitivisht në importe me një koeficient elasticiteti 2.4, 3.7 dhe 2.5 respektivisht.

4.6.3 Testi Hausman për eksportet dhe vlerësimi i ekuacionit të gravitetit.

Vlera Chi-Sq=21.775704 që i korrespondon një vlere p-value 0.0833, e cila është më e madhe se vlera 0.05, që do të thotë se teknika RE është më e përshtatshme.

Tabela 4.20: Rezultatet e testit Hausman për eksportet.

Correlated Random Effects - Hausman Test		
Test cross-section random effects		
Test Summary	Chi-Sq. Statistic	Prob.
Cross-section random	21.775704	0.0833

Burimi: llogaritjet e autorit
Rezultatet janë gjeneruar duke përdorur EVIEWS 8

Duke bërë analizën hap pas hapi rivlerësohet edhe njëherë modeli me efekte të rastit vetëm për variablat sinjifikant dhe modeli ynë final për eksportet merr formën e mëposhtme:

$$Y_3 = -23.01853 - 6.706197(x_1) + 2.579516(x_2) + 1.260373(x_3) - 0.107472(x_5) + 14.14606(x_6) + 2.235166(x_7) + 1.479247(x_{10}) + 6.192430(x_{13})$$

Tabela 4.21: Rezultatet e rivlerësimit të eksporteve me metodën e efekteve të rastit.

Dependent Variable: Y3

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
X1	-6.706197	0.508291	-13.19361	0.0000
X2	2.579516	0.331641	7.778033	0.0000
X3	1.260373	0.199592	6.314751	0.0000
X5	-0.107472	0.038582	-2.785545	0.0056
X6	14.14606	2.254497	6.274596	0.0000
X7	2.235166	0.538261	4.152569	0.0000
X10	1.479247	0.521051	2.838966	0.0047
X13	6.192430	2.022668	3.061515	0.0023
C	-23.01853	10.09856	-2.279388	0.0231
R-squared	0.543444	Mean dependent var	6.429859	
Adjusted R-squared	0.534850	S.D. dependent var	3.794933	
S.E. of regression	2.588218	Sum squared resid	2847.020	
F-statistic	63.23521	Durbin-Watson stat	1.398817	
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: llogaritjet e autorit

Rezultatet janë gjeneruar duke përdorur EVIEWS 8

Në vlerësimin e eksporteve variablat që ndikojnë negativisht janë distanca dhe rritja ekonomike, ndërsa ata që ndikojnë pozitivisht janë GDP-të e vendeve, indeksi i performancës së logjistikës, shteti ligjor dhe efikasiteti rregullator. Variabli i MTL-së edhe këtu është statistikisht i rëndësishëm (me një nivel rëndësie 1%).

4.7 Analizimi i potencialeve tregtare me vendet partnere.

Zbatimi i modelit të mësipërm na lejon gjenerimin e të dhënave për flukset tregtare potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë, ndër të cilët BE-ja si partneri tregtar kryesor edhe vendet e rajonit, ku përmendim Bosnje – Hercegovinën, Kroacinë, Maqedoninë dhe Serbinë. Kosova, edhe pse një partner tregtar rajonal i rëndësishëm, nuk është përfshirë në projeksionet e tregtisë potenciale për faktin se të dhënat për të janë të pamjaftueshme

Në këtë analizë do t'i ndajmë shtetet në tre grupe: ato që janë afër, mesatarisht afër dhe larg.




Figura 4.2. Harta e Europës e ndarë në tre grup shtete.

Figura 4.2 jep në mënyrë vizuale tre grup shtetet që eksportojnë Shqipëria, duke u kategorizuar sipas largësisë midis qendrave ekonomike. Ato shtete që kanë ngjyrë më të zbehtë konsiderohen afër duke shkuar te vendet më larg me ngjyrë më të errët.

Në këtë seksion, vlerësimet e ekuacionit të gravitetit përdoren për të parashikuar tregtinë e Shqipërisë me të gjitha vendet në mostrën tonë. Raporti i potencialit tregtar (P) i parashikuar nga modeli dhe tregtia aktuale, (A) dmth (P / A) është përdorur pastaj për të analizuar drejtimin e ardhshëm të tregtisë për Shqipërinë. Nëse vlera e P / A kalon vlerën

një ose 100%, nënkuptimi është në drejtim të zgjerimit të mundshëm të tregtisë me vendin përkatës.

Në varësi të vlerës së P / A , partnerët tregtarë të Shqipërisë ndahen në dy kategori: ata me të cilët potenciali për zgjerimin e tregtisë është i paraparë dhe vendet me të cilin Shqipëria e ka tejkaluar tashmë potencialin e saj të tregtisë. Diferenca absolute midis nivelit potencial dhe aktual të tregtisë, përkatësisht të vlerës së $(A-P)$, përdoret gjithashtu për të klasifikuar vendet me potencial për zgjerimin e tregtisë me Shqipërinë. Një vlerë pozitive tregon mundësitë e ardhshme të zgjerimit të tregtisë, ndërsa një vlerë negative tregon se Shqipëria ka tejkaluar potencialin e saj të tregtisë me vendin partner.

4.7.1 Analiza e grupit të parë.

Bazuar në karakteristikat dhe veçoritë që ka ky lloj modeli, duhet të themi se rezultatet e gjeneruara prej tij duhen interpretuar me kujdes. Ky fakt, më së tepërmi sugjeron se këto projeksione duhen konsideruar si tregues të mirë që rekomandojnë ndryshimet potenciale të tendencave.

Në këtë grup përfshihen shtete, si: Maqedonia, Bosnje dhe Hercegovina, Greqia, Bullgaria, Kroacia, Rumania, Sllovenia, Hungaria, Italia dhe Serbia.

Shohim se Italia, Bosnje, Greqia dhe Bullgaria janë mbi potencialin tregtar, Maqedonia, Greqia, Kroacia, Rumania, Sllovenia, Hungaria dhe Serbia janë nën potencialin tregtar.

Tabela 4.22: Analiza e raportit të grupit të parë të shteteve për vitin 2014.

Shtetet	A-P
Maqedonia	-
Bosnje dhe Hecegovina	+
Greqia	+
Bullgaria	+
Kroacia	-
Rumania	-
Sllovenia	-
Hungaria	-
Italia	+
Serbia	-

Burimi: llogaritjet e autorit


Bazuar në rezultatet e marra nga ky model mund të themi se: paraqitja grafike e flukseve tregtare reale drejt atyre potenciale me Bosnje-Hercegovinën, (shih Grafikon 4.3. a) nxjerr në pah faktin se me këtë shtet Shqipëria është mbi potencial. E njëjta gjë mund të thuhet për Bullgarinë (shih Grafikon 4.3. b), Greqinë (shih Grafikon 4.3.d) dhe Italinë (shih Grafikon 4.3. f) për vitin 2014.

Siç mund të vërehet në mënyrë të qartë nga grafiket flukset tregtare aktuale (reale) me Hungarinë, Kroacinë, Serbinë, Rumaninë, Slloveninë dhe Maqedoninë janë nën

potencialin tregtar për vitin 2014. Projektionet e modelit të gravitetit sugjerojnë se Shqipëria mund të intensifikojë volumet e flukseve tregtare me këto vende.

Afërsia fizike (si dy vende fqinjë) ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë, Shqipërisë dhe Italisë, mund të jetë njëra nga arsyt shpjeguese se pse shkëmbimet tregtare me to janë më intesive. Siç u nënvizua dhe më sipër, teoria e modeleve të gravitetit sugjeron se vendet fqinje janë të predispozuar të tregtojnë më shumë ndërmjet tyre.

Kostot tregtare ndërmjet shteteve fqinje tentojnë të ulen si pasoje e afërsisë fizike, ngjashmërisë kulturore dhe rrjeteve tregtare të ndërtuara përgjatë historisë.






Figura 4.3 : Raporti i tregtisë aktuale dhe tregtisë potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe grupit të parë të partnerëve të saj.
Burimi: llogaritjet e autorit

4.7.2 Analiza e grupit të dytë.

Në këtë grup përfshihen shtete, si: Malta, Sllovakia, Austria, Çekia, Turqia, Zvicra, Polonia, Qipro, Gjermania, Luksemburgu, Franca dhe Belgjika. Nga tabela 4.23 shohim se Austria, Belgjika, Franca, Gjermania, Luksemburgu, Sllovakia dhe Zvicra janë nën potencialin tregtar, Qipro, Çekia, Malta, Polonia dhe Turqia janë mbi potencial.


Tabela 4.23: Analiza e raportit për grupin e dytë të shteteve.





Shtetet	A-P
Austria	-
Belgjik	-
Qipro	+
Çeki	+
Francë	-

Gjermani	-
Luksemburg	-
Malta	+
Poloni	+
Sllovaki	-
Zviceër	-
Turqi	+

Burmi: Ilogarijet e autorit

Figura 4.4 ofron paraqitjen grafike të projeksioneve të modelit të gravitetit për flukset tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të përfshira në grupin e dytë. Projektionet e modelit të gravitetit për vitin 2014 sygjerojnë se shkëmbimet tregtare me Austrinë, Francën dhe Gjermaninë janë tepër të vogla të peshuara ndaj potencialit të flukseve tregtare.








Figura 4.4: Raporti i tregtisë aktuale dhe tregtisë potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe grupit të dytë të partnerëve të saj.

Burimi: Ilogarimet e autorit

4.7.3 Analiza e grupit të tretë.

Në këtë grup përfshihen shtete, si: Danimarka, Estonia, Finlanda, Irlanda, Lituania, Holanda, Portugalia, Spanja, Suedia, dhe Britania. Nga tabela 4.24 shohim se Danimarka, Irlanda, Suedia dhe Britania janë nën potencialin tregtar ndërsa Finlanda, Irlanda, Portugalia dhe Spanja janë mbi potencial.


Tabela 4.24: Analiza e raportit për grupin e tretë të shteteve.

Shtetet	A-P
Danimarka	-
Estonia	-
Finlanda	+
Irlanda	+
Lituania	-

Hollanda	-
Portugalia	+
Spanja	+
Suedia	-
Anglia	-

Burimi: llogaritjet e autorit

Figura 4.5 ofron paraqitjen grafike të projeksioneve të modelit të gravitetit për flukset tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të përfshira në grupin e tretë. Projektionet e modelit të gravitetit për vitin 2014 sygjerojnë se shkëmbimet tregtare me Hollandën dhe Anglinë janë thuajse inegzistente të peshuara ndaj potencialit. Kjo ka një shpjegim teorik dhe merr në konsideratë distancën ndërmjet vendeve. Në mënyrë të ngjashme flukset tregtare me Danimarkën, Estoninë, Lituanië dhe Suedinë për vitin 2014 janë nën potencial.






Figura 4.5: Raporti i tregtisë aktuale dhe tregtisë potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe grupit të tretë të partnerëve të saj.

Burimi: llogaritjet e autorit

Në të tre grupshtetet, që kategorizuam, ne shohim se në grupin e dytë dhe të tretë Shqipëria ka kapacitete të pashfrytëzuara në drejtim të eksporteve.

4.8 Përfundime

Në këtë kapitull ne bëmë një vlerësim të tregtisë së jashtme me anë të tre teknikave, pooled OLS, efektet fikse dhe efektet rastësore.

Problemi më i madh me teknikën e parë është se kjo teknikë nuk bën dallime ndërmjet shteteve, ndërsa modeli me efekte fikse lejon heterogjenitetin ose individualitetin ndërmjet vendeve. modelet me efekte rastësore kanë avantazhin e modeleve me efekte fikse sepse ato marrin në konsideratë edhe variabla që nuk ndryshojnë në kohë.

Pasi vlerësuam të tre modelet, testuam se cili model është më i përshtatshmi duke bërë testin Hausman. Nga rezultatet e gjeneruara nga ky test modeli me efekte të rastit dominon mbi dy modelet e tjera. Ky model u përdor për të vlerësuar potencialin e tregut në çështjen në vijim.

Bazuar në rezultatet e marra nga ky model për sa i përket partnereve kryesore tregtar të Shqipërisë mund të themi se: paraqitja grafike e flukseve tregtare reale drejt atyre potenciale me Gjermaninë, (shih Grafikun 4.3. f) nxjerr në pah disa fakte interesante. Siç mund të vërehet në mënyrë të qartë, flukset tregtare aktuale (reale) me Gjermaninë janë shumë poshtë atyre potenciale. Shkëmbimet tregtare reale me Gjermaninë në vitin 2014 janë rreth 2/3 e atyre potenciale. Edhe pse Gjermania është eksportuesi kryesor i BE-së, flukset tregtare me të mbeten nën nivelet potenciale. Projektionet e modelit të gravitetit sugjerojnë se Shqipëria dhe Gjermania mund të intensifikojnë volumet e flukseve tregtare me rreth 26% më shumë se ato aktuale.

Projektionet e modelit të gravitetit për potencialet e flukseve tregtare me Greqinë ofrojnë një tjetër tablo. Kështu, flukset tregtare me Greqinë për vitin 2014 përbëjnë rreth 4% më shumë se potenciali. Afërsia fizike (si dy vende fqinjë) ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë mund të jetë njëra nga arsyt shpjeguese sepse shkëmbimet tregtare me të janë më intensive se ato me Gjermaninë.

Siç u nënvizua dhe më sipër, teoria e modeleve të gravitetit sugjeron se vendet fqinje janë të predispozuar të tregtojnë më shumë ndërmjet tyre. Kostot tregtare ndërmjet shteteve fqinjë tentojnë të ulen si pasojë e afërsisë fizike, ngjashmërive kulturore dhe rrjeteve tregtare të ndërtuara përgjatë historisë. Modeli i gravitetit prodhon disa të dhëna interesante mbi flukset tregtare potenciale me Italinë.

Në dallim nga dy vendet e tjera të BE-së, të trajtuara më sipër (Gjermania dhe Greqia), flukset tregtare me Italinë janë mjaft më intensive. Për Shqipërinë, Italia përfaqëson partnerin tregtar kryesor. Kështu, gjatë 2014-ës eksportet Shqipëtare drejt Italisë arritën vlerën e 52.02% ndaj totalit të eksporteve Shqipëtare, dhe 29.8% të totalit të importeve të vendit. Gjetjet e modelit të gravitetit sugjerojnë se tregtia aktuale me Italinë është mbi atë potenciale.

Përveç faktorit të afërsisë fizike ndërmjet dy vendeve, duket se numri i lartë i emigrantëve Shqipëtar në Itali dhe Greqi, është faktori tjetër kryesor që shpjegon pse niveli i shkëmbimeve

tregtare me këto dy vende është mbi nivelet e ekuilibrit, ndryshe nga rasti i Gjermanisë. Një tjetër faktor që ndikon në nivelin e lartë të shkëmbimeve ndërmjet këtyre vendeve

është ratifikimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) (Marrëveshja e Stabilizim Asocimit u ratifikua në pranverë të 2009-ës).

Grafik-u 14.2.a.c.i.j, ofron paraqitjen grafike të projeksioneve të modelit të gravitetit për flukset tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe katër prej partnerëve të saj rajonalë (Bosnje – Hercegovina, Kroacia, Maqedonia dhe Serbia).

Projeksionet e modelit të gravitetit sugjerojnë se shkëmbimet tregtare me Bosnje – Hercegovinën janë më të ulta ndaj potencialit të flukseve tregtare, ato përbëjnë 75% të potencialit. Në mënyrë të ngjashme flukset tregtare me Kroacinë janë shumë më poshtë potencialeve të gjeneruara nga modeli i gravitetit.

Flukset tregtare me Kroacinë në vitin 2014, përbëjnë vetëm 81% të potencialit.

Edhe pse shkëmbimet tregtare me Serbinë janë rritur ndjeshëm gjatë pesë viteve të fundit, flukset tregtare aktuale me këtë vend mbeten nën potencialet e tyre. Gjatë 2014-ës flukset tregtare reale me Serbinë janë vetëm 45% të potencialit të tyre. Përsëri mund të arrijmë në përfundimin se ekziston një mundësi e pashfrytëzuar për përshtatëzimin e shkëmbimeve tregtare ndërmjet këtyre dy partnerëve tregtarë rajonalë. Duke patur parasysh se Shqipëria dhe Maqedonia janë vende fqinje, pritet që të kenë shkëmbime tregtare të konsiderueshme ndërmjet tyre. Megjithatë, vërehet se projeksionet e modelit të gravitetit në praktikë ofrojnë rezultate kontradiktore me sugjerimet e teorisë. Kështu, gjatë 2014-ës flukset tregtare aktuale me Maqedoninë përbënin vetëm 75% ndaj atyre potenciale. Projeksionet e modelit të gravitetit sugjerojnë se flukset e shkëmbimeve tregtare gjatë viteve paraardhës kanë qenë në raport akoma më të zhdrejtë ndaj potencialit tregtar.

Flukset tregtare reale ndërmjet Shqipërisë dhe Turqisë janë mbi nivelet potenciale të projektuara nga modeli i gravitetit, ato përbëjnë 109% të potencialit.

Supozohet se flukset tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe disa vendeve të rajonit janë mjaft më të ulta se potencialet e tyre, për arsye të radhitura më poshtë:

Së pari, gjatë regjimit komunist Shqipëria u shndërrua në një nga vendet më të izoluar, si e tillë nuk kishte lidhje tregtare me vendet e rajonit.

Së dyti, shërbimet doganore të korruptuara dhe taksat e larta doganore të disa produkteve, favorizojnë aktivitetin e kontrabandës midis vendeve të Ballkanit. Ata sugjerojnë se flukset tregtare reale ndërmjet vendeve të rajonit janë mjaft më të larta se të dhënat statistikore të raportuara zyrtarisht.

Së fundi, Shqipëria trashëgoi një infrastrukturë transporti të dobët me vendet e rajonit. Ne e pamë dhe më lartë nga ekuacionet e gjeneruara, se një rrjet kaq i dobët transporti përbën një pengesë shumë të madhe për intensifikimin e tregtisë midis Shqipërisë dhe këtyre vendeve.

5. DISKUTIMI I REZULTATEVE, KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET.

Tregtia e jashtme e Shqipërise, në vitet e fundit është karakterizuar në përgjithësi nga ndryshime thelbësore, duke shkuar drejt liberalizimit për rrjedhojë, duke sjellë ndryshime edhe në treguesit kryesorë të saj.

Ekonomia shqipëtare, vitet e fundit ka mundur të sigurojë stabilitet nga pikëpamja e treguesve makro-ekonomikë, edhe gjatë periudhës së krizës ekonomike globale. Konkretisht, për vitin 2013 rritja reale e GDP-së është vlerësuar 0.7%.

Gjatë periudhës 5-vjeçare (2010-2014) vihet re që trendi ka qënë në rritje për eksportet, ndërsa për importet ka qënë me luhatje (ulje dhe ngritje). Vërehet një rritje mesatare vjetore e eksporteve me 20,8 %. Në rastin e importeve kemi një ritëm rënës në vitet 2012-2013 dhe rritës në vitet e tjera. Për periudhën 2010-2014, rritja mesatare vjetore është 5,4 %. Defiçiti tregtar është përmirësuar, duke shënuar ulje mesatare vjetore me 1,3 %.

Ecuria e eksporteve luan një rol të rëndësishëm në prespektivën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së vendit, si dhe në bilancin tregtar me qëllim që t'i bëj ballë edhe konkurrencës ndërkombëtare. Ritmi i rritjes së eksporteve në vite është një tregues i rëndësishëm, mbi ecurinë e të cilit mund të gjykojmë për stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e ekonomisë në përgjithësi, si dhe të aftësisë së saj për të konkurruar në tregjet ndërkombëtare por që reflekton në mënyrë direkte dhe shumë të ngushtë edhe konjunkturën ndërkombëtare.

Politikat liberalizuese dhe reformat e shumta ekonomike të ndërmarra mund të ndryshojnë ritmin nga negativ në pozitiv të cilat tregojnë ecurinë e ekonomisë së vendit tonë por dhe ndikimin e saj nga faktorë të jashtëm.

Tashmë ekonomia e vendit tonë është bërë pjesë përbërëse e nismave për liberalizimin dhe lehtësimin e tregtisë në nivel rajonal dhe më gjerë. Pjesëmarrja aktive në këto nisma shton mundësitë e ekonomisë sonë për t'u specializuar dhe njëkohësisht kërkon angazhime në drejtim të rritjes së konkurrueshmërisë. Treguesit e tregtisë së jashtme, për çdo vend shprehin shkallën e zhvillimit ekonomik dhe të përfitimit të ndërsjellë, për këtë arsye analiza dhe vlerësimi i treguesve të shkëmbimeve tregtare merr një rëndësi të veçantë.

Synimi i këtij kapitulli është të prezantojë konkluzionet e studimit dhe për qëllime të politikë-bërjes të japë disa rekomandime duke u bazuar në këto konkluzione.

Konkluzionet

Ky studim analizon faktorët që ndikojnë në tregtinë dypalëshe të Shqipërisë me vendet e EUR32. Vlerësimi i tregtisë së jashtme u bë me anë të tre metodave dhe me anë të testit Hausman u zgjodh metoda më e përshtatshme. Pasi u vlerësua modeli me metodën më të përshtatshme u përdor ekuacioni i gravitetit për tregtinë për të vlerësuar potencialin e tregut. Zbatimi i ekuacionit të rivlerësuar na lejoi gjenerimin e të dhënave për flukset tregtare potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj EUR32. Kosova si një

partner i rëndësishëm rajonal nuk është përfshirë në projeksionet e tregtisë potenciale për faktin se të dhënat janë të pamjaftueshme.

Faktorët që influencojnë tregtinë e jashtme duke u bazuar në ekuacionin e vlerësuar të gravitetit.

- Rezultatet empirike tregojnë se modeli i gravitetit shpjegon në mënyrë të suksesshme tregtinë bilaterale të Shqipërisë. Kjo vihet në dukje sepse koeficientet e variablave standarte të gravitetit janë sinjifikant dhe konsistent me teorinë. Specifikisht eksportet, importet dhe tregtia totale kanë një marrdhënie negative me distancën e ponderuar që do të thotë se variabli i distancës (kostot e transportit) rezulton se ndikon negativisht mbi flukset tregtare. Megjithatë, shkurtimi i distancës fizike (ndërtimi i rrugëve, autostradave, porteve, hekurudhave, etj.) nuk është mënyra e vetme për të ulur kostot e transportit (ndonëse është mjaft e rëndësishme). Qeveritë mund të ulin kostot e transportit edhe përmes integritetit më të thellë dhe krijimit të kërkesave të ngjashme për dokumentacion, shmangies së kontrolleve të dyfishta/trefishta kufitare, krijimit të kërkesave të ngjashme për standardet në tregun rajonal, dhe europian.

Njëkohësisht krahas distancës si një nga faktorët tradicional të modelit të gravitetit janë dhe masat ekonomike (GDPi) të cilat japin një kontribut të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e modelit bazë.

Nga modelimi i flukseve të eksportit rezultatet tregojnë se, në kushtet kur faktorët e tjerë mbahen të pandryshuar, rritja e GDP-së së Shqipërisë dhe vendit partner sjell rritjen e eksportit, importit dhe rrjedhimisht të tregtisë totale.

Ndikimi i variablave tradicional si GDP-ja dhe distanca është e vërtetë për të tre modelet e aplikuara në punim (Pool OLS, FE dhe RE) gjithashtu dhe tek modeli final i sugjeruar nga testi Haustman dhe i rivlerësuar hap pas hapi.

- Hipoteza Linder nuk dominon përkundrejt hipotezës H-O në tregtinë dypalëshe të Shqipërisë me vendet e EUR32. Kjo bazohet në faktin se koeficienti i diferencës së GDP-së për frymë ka një shenjë negative por nuk është statistikisht i rëndësishëm. Kjo del në përfundimin se tregtia e jashtme e Shqipërisë nuk është më intensive me vendet që janë të ngjashme në të ardhurat për frymë.
- Një evidencë e fortë shihet në marrdhënien që ka indeksi i performancës së logjistikës në tregtinë dypalëshe. Indeksi LPI në të tre modelet e aplikuar për importet, eksportet dhe tregtinë totale është statistikisht i rëndësishëm me një p-value=0.000 dhe ka një lidhje të drejtë me variablat e varur. Me një koeficient elasticiteti më të madh se një, ky përfundim sugjeron përmirësimin e këtij indeksi për rritjen e shkëmbimeve tregtare.
- Dalja në det gjithashtu është një tregues tepër i rëndësishëm për tregtinë dypalëshe. Me një p-value>0.05 ky tregues ndikon pozitivisht në tregti.

- Sundimi i ligjit shihet si një variabël që ndikon pozitivisht tek importet dhe eksportet. Kjo nënkupton se aftësia për të grumbulluar pronën dhe pasurinë, njohja e të drejtave të pronësisë private dhe një sundim ligji efikas janë karakteristika jetike të një ekonomie tregu rrjedhimisht dhe tregtisë së jashtme. Kjo sepse të drejtat e sigurta të pronësisë i japin qytetarëve besimin për të ndërmarrë veprimtari sipërmarrëse në drejtim të import-eksportit dhe të bëjnë plane afatgjata sepse ato e dinë se të ardhurat e tyre, kursimet, dhe prona private janë të sigurta nga shpronësimet e padrejta ose vjedhja.
Korrupsioni gjithashtu mund të infektoje të gjitha pjesët e një ekonomie në mënyrë sistematike sepse ai shtrëmbëron integritetin e sistemit ekonomik, një shtrëmbërim mbi të cilët individët janë në gjendje për të fituar në kurriz të së tërës.
- Madhësia e qeverisë është një tjetër variabël i lidhur pozitivisht me tregtinë dhe që nënkupton se sa më e lartë të jetë performanca në lirinë fiskale dhe shpenzimet qeveritare aq më shumë rritet tregtia dypalëshe. Liria fiskale është një masë e drejtpërdrejtë për shkallën në të cilën qeveria i lejon individet dhe bizneset për të mbajtur dhe menaxhuar të ardhurat dhe pasuritë e tyre. Një qeveri mund të imponojë barra fiskale mbi aktivitetin ekonomik nëpërmjet taksimit ose duke krijuar borxh publik i cili prap shlyhet nëpërmjet taksimit.
Kjo do të thotë se sa më mirë të performojë qeveria në këtë indeks aq më shumë rritet tregtia dypalëshe. Gjithashtu dhe shpenzimet e tepruara të qeverisë mbartin një rrezik për aktivitetin tregtar sepse një rritje e borxhit publik imponon taksa të larta për bizneset. Pra sa më lartë të vlerësohet ky variabël aq më të prirur jemi për të vlerësuar aktivitetin tregtar.
- Hapja me tregjet është gjithashtu një variabël që ndihmon pozitivisht tregtinë dypalëshe. Që do të thotë se heqja e barrierave tarifore dhe jotarifore do të ndihmonte në intensifikimin e tregtisë dypalëshe.
- Gjetjet sugjerojnë se MTL-të kanë kontribuar pozitivisht në integrimin tregtar rajonal, edhe pse materiali del në përfundimin se pjesa më e madhe e vendeve të rajonit tregtojnë nën potencialin e tyre.

Përfundimet nga zbatimi i ekuacionit të gravitetit.

Më poshtë trajtohen shkurtimisht vendet e ndara në tre grup shtete:

Grupi i parë.

Bazuar në rezultatet e këtij grupi, paraqitja grafike e flukseve reale drejt atyre potenciale në Itali, Bosnje, Greqi dhe Bullgari janë mbi potencialin tregtar dhe Maqedonia, Greqia, Kroacia, Rumania, Sllovenia, Hungaria dhe Serbia janë nën potencialin tregtar.

Siç mund të vërehet në mënyrë të qartë nga grafikët, flukset tregtare aktuale (reale) me Hungarinë, Kroacinë, Serbinë, Rumaninë, Slloveninë dhe Maqedoninë janë nën potencialin tregtar për vitin 2014.

Afërsia fizike (si dy vende fqinj) ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë, Shqipërisë dhe Italisë, mund të jetë njëra nga arsyt shpjeguese se pse shkëmbimet tregtare me to janë më intensive. Tregtia e Shqipërisë me vendet e tjera të rajonit është mjaft e ulët. Tregtia e Shqipërisë është kryesisht e orientuar nga BE. Shifrat e ulta dhe defiçiti i lartë me vendet e rajonit, dëshmojnë për një efektivitet të ulët të MTL-ve. Sidoqoftë, së fundi është vënë re një tendencë për rritjen e tregtisë me vendet e EJL dhe Kosova është aktualisht vendi i vetëm me të cilin Shqipëria ka një bilanc tregtar pozitiv. Efektet pozitive të MTL-vë shkojnë përtej shifrave. Duke bërë efektive MTL-të shkurtohet rruga për në BE.

Grupi i dytë.

Bazuar në rezultatet e këtij grupi, paraqitja grafike e flukseve reale drejt atyre potenciale në Austri, Belgjik, France, Gjermani, Luksemburg, Sllovaki dhe Zvicra janë nën potencialin tregtar, Qipro, Çekia, Malta, Polonia dhe Turqia janë mbi potencial.

Grupi i tretë.

Bazuar në rezultatet e këtij grupi, paraqitja grafike e flukseve reale drejt atyre potenciale me: Danimarkën, Irlandën, Suedinë dhe Britaninë tregojnë se me këto vende jemi nën potencialin tregtar ndërsa me Finlandën, Irlandën, Portugalin dhe Spanjën jemi mbi potencial. Projektionet e modelit të gravitetit sugjerojnë se Shqipëria mund të intensifikojë volumet e flukseve tregtare me Danimarkën, Irlandën, Suedinë dhe Britaninë.

Rekomandimet.

Projektionet e modelit të gravitetit sugjerojnë se Shqipëria duhet të intensifikojë volumet e flukseve tregtare me vende të cilat kanë një performancë të lartë në treguesit e lirisë ekonomike sepse në një shoqëri ekonomisht të lirë, fuqia e vendimmarrjes ekonomike është shpërndarë gjerësisht, dhe alokimi i burimeve për prodhimin dhe konsumin është në bazë të konkurrencës së hapur në mënyrë që çdo individ apo firmë ka një shans të barabartë të ketë sukses.

Projektionet e modelit të gravitetit sugjerojnë se Shqipëria mund të intensifikojë volumet e flukseve tregtare me disa vende të grupit të parë si: Hungarinë, Kroacinë, Serbinë, Rumaninë, Slloveninë dhe Maqedoninë.

Për grupin e dytë të shteteve projektionet e modelit të gravitetit sugjerojnë se Shqipëria mund të intensifikojë volumet e flukseve tregtare me Austrin, Belgjikën, Francën, Gjermaninë, Luksemburgun, Sllovakin dhe Zvicrën.

Për grupin e tretë të shteteve projektionet e modelit të gravitetit sugjerojnë se Shqipëria mund të intensifikojë volumet e flukseve tregtare me Danimarkën, Irlandën, Suedinë dhe Britaninë.

Pavaresisht nga niveli relativisht i lartë i liberalizimit tregtar, indikatorët e Shqipërisë në lidhje me hapjen e tregut dhe të ekonomisë mbeten të ulët dhe defiçitet tregtare janë mjaft

të lartë, krahasuar me vende të tjera të rajonit. Reformat strukturore dhe institucionale, mbeten të nevojshme në mënyrë që të rriten potencialet tregtare të vendit.

Siç u nënvizua dhe më sipër, për arsye të afërsisë me tregjet, teoria e modeleve të gravitetit rekomandon që Shqipëria të intensifikojë marrëdhëniet tregtare me vendet fqinje.

Për të hartuar politika të përshtatshme të integritit rajonal dhe për bërjen efektive të tyre, rëndësi të veçantë kanë:

1. mbështetja e tyre me studime dhe analiza të thella;
2. shpërndarja e informacioneve të rëndësishme sidomos tek njerezit e biznesit;
3. përmirësimi i legjislacionit dhe institucioneve përkatëse;
4. përmirësimi i infrastrukturës.

Limitimet dhe sygjërimet për studime të mëtejshme.

Në këtë punim konsiderohen të gjithë produktet dhe sektorët njësoj kontribues në tregti. Do të ishte me interes që të studioheshin flukset tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve partnere duke marrë në konsideratë grup-produktet dhe sektorët në veçanti.

Krahas përdorimit të faktoreve që kemi marrë, puna kërkimore në të ardhmen mund të përqendrohet në tregtinë rajonale, mund të kontribuojë në këtë çështje përmes hulumtimit të mëtejshëm mbi mënyra të tjera të matjes së kostove të transportit. Në modelin e gravitetit mund të përfshihen variabla të tjerë shpjegues (për shembull, kursi i këmbimit në të dy vendet).

Analiza dhe gjetjet e punimit janë fokusuar në një grup të vogël vendesh EUR32 të shtrira në 14 vite. Përfshirja e më shumë vendeve dhe me një seri më të gjerë do të na gjeneronte një rezultat më efektiv në parashikimin e tregtisë së jashtme.

Në këtë punim zero-tregtisë nuk i jepet ndonjë vëmendje e veçantë, ajo thjesht është zëvendësuar me vlerën një për efekt llogaritje të logaritmit natyror. Do të ishte me interes të analizohej në mënyrë të detajuar problem i zero-tregtisë.

Projeksionet e modelit të gravitetit mbi tregtinë aktuale dhe potenciale japin sygjërimet për rritje të tregtisë në rast se $P-A > 0$ por është i pafuqishëm për të na drejtuar drejt atij vend ku Shqipëria mund të maksimizonte përfitimet e saj.

Ndryshimet në teknologji ndikojnë në mënyrë direkte në rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare, duke ndikuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë në flukset tregtare. Ndryshimet në teknologji nuk janë marrë në analizë në vlerësimin e flukseve tregtare të ardhshme dhe kjo mund të jetë një tjetër mundësi kërkimi.

Ndikimi që tregtia ka mbi rritjen ekonomike është një nga pyetjet më të rëndësishme, më të debatuar, dhe më të hulumtuara për ekonomistët në qarqet akademike por edhe për politikë-bërësit. Institucionet ndërkombëtare si FMN-ja, OECD-ja, dhe Banka Botërore

janë përpjekur ti ndihmojnë vendet në zhvillim duke ofruar këshilla të bazuara në besimin se hapja ekonomike ka një ndikim pozitiv në rritje. Një raport i OECD-së mbi këtë temë (1998, fq 36.) thekson se: "Ekonomitë më të hapura dhe të orientuar nga tregtia me jashtë në vazhdimësi performojnë më mirë se vendet me kufizime ndaj tregtisë dhe investimeve të huaja." FMN-ja ndan të njëjtin mendim teksa thekson se (1997, fq 84.): "Politikat drejt tregtisë së jashtme janë ndër faktorët më të rëndësishëm që promovojnë rritjen ekonomike dhe konvergjencën në vendet në zhvillim."

Vlerësimi i ndikimit që tregtia ka mbi rritjen ekonomike mund të përbëjë një fushë për studime dhe kërkime të mëvonshme.

Kritika ndaj kesaj lidhje vë në dukje se ato vuajnë nga i njëjti problem. Tregtia dhe rritja mendohet të jenë të lidhura ngushtë, ndaj, kauzaliteti (shkakësia) i kundërt mund të përbëjë problem

BIBLIOGRAFIA

Acemoglu, Daron, Simon Johnson, and James A. Robinson, "The Colonial Origins of Comparative Development: An Empirical Investigation," *American Economic Review*, December 2001, pp.1369–1401.

A.Demeti. (2014), *Rritja e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare*, p 24-26.

Adeem Khan, (2011) *Empirical Investigation of International Trade Using Gravity Models with Gravitas*, p 1-27

Afonso, Óscar, "Working Papers Investigação - Trabalhos em curso- The Impact Of International Trade on Economic Growth" no 106, May 2001

Anderson, J. E. and E. van Wincoop (2003). "Gravity with Gravitas: A Solution to the Border Puzzle," *American Economic Review* 93: 170–92. (2004). "Trade Costs," *Journal of Economic Literature* 42(3): 691–751.

Anderson, J. E. 1979. A Theoretical Foundation for the Gravity Equation. *American Economic Review*, March, pp.106-116.

Baier, S. L. and J. H. Bergstrand (2001). "The Growth of World Trade: Tariffs, Transport Costs, and Income Similarity," *Journal of International Economics* 53: 1–27. (2009). "Bonus VetusOLS: A Simple Method for Approximating International Trade-Costs Effects Using the Gravity Equation," *Journal of International Economics* 77: 77–85.

BABECKÁ KUCHARČUKOVÁ, O., J. BABECKÝ, and M. RAISER. 2010. Gravity approach for modelling international trade in south-eastern europe and the commonwealth of independent states: The role of geography, policy and institutions. *Open Economies Review*.

Baier, S L and Bergstrand, H (2001), 'The growth of world trade: tariffs, transport costs, and income similarity', *Journal of International Economics*, Vol. 53, pages 1–27.

Baldwin, R., R. Forslid, P. Martin, G. Ottaviano and F. Robert-Nicoud (2003). "The Core-Periphery Model: Key Features and Effects," Chapter 2 of *Economic Geography and Public Policy*, Princeton University Press.

Balassa, B (1964), 'The purchasing-power parity doctrine', *Journal of Political Economy*, pages 584–96.

Balistreri, E. J. and R. H. Hillberry (2007). "Structural Estimation and the Border Puzzle," *Journal of International Economics* 72(2): 451–63.

Bergeijk, P. A. G. van (1992). "Diplomatic Barriers to Trade," *De Economist* 140: 44–63. (2009). *Economic Diplomacy and the Geography of International Trade*, Cheltenham, UK: Edward Elgar.

Bergeijk, Van Peter A. G. and S. Brakman. 1984. *The gravity model in international trade: advances and applications*. New York: Cambridge University Press.

Bergstrand, J. H. 1985. The Gravity Equation in International Trade: some Microeconomic Foundations and Empirical Evidence. *Review of Economics and Statistics*, 67, August, pp.474-481.

Bergstrand, J. H. 1989. The Generalised Gravity Equation Monopolistic Competition, and the Factor-Proportions Theory in International Trade. *Review of Economics and Statistics* (71), February, pp.143-153.

Bobkova, B. 2012. Gravity model estimation using panel data - is logarithmic transformation advisable? Prague: Charles University, Institute of Economic Studies, master thesis.

Bruderl, J. 2005. *Panel Data Analysis*. University of Mannheim.

Bussiere et al., (2005) *Trade Integration of Central and Eastern European Countries: Lessons from a Gravity Model*

Cheng, I-H. and H. J. Wall (2005). "Controlling for heterogeneity in gravity models of trade and integration." *Federal Reserve Bank of St. Louis Review*, 87, 1, 49-63.

CIESLIK, A. 2009. Bilateral Trade Volumes, the Gravity Equation and Factor Proportions. *The Journal of International Trade & Economic Development* 18 (1), p.37–59.

Davis, D R and Weinstein, D E (2001), 'What role for empirics in international trade?', NBER Working Paper no. 8543.

De Benedictis, L. and C. Vicarelli. 2005. Trade Potentials in Gravity Panel Data Models. *Topics in Economic Analysis and Policy - Berkeley Electronic Press* 5 (1).

Edward Christie, 2002, *Potential Trade in Southeast Europe: a Gravity Model Approach*

Egger, P. 2000. A Note on the Proper Econometric Specification of the Gravity Equation. *WIFO Working Papers*:108.

Egger, P. and M. Pfaffermayr. 2003. The proper panel econometric specification of the gravity equation: A three-way model with bilateral interaction effects. *Empirical Economics*, 28.

Feenstra, R C (1998), 'Integration of trade and disintegration of production in the global economy', *Journal of Economic Perspectives*, Fall, 12(4), pages 31–50.

Feyrer, James. "Trade and Income – Exploiting Time Series in Geography," NBER Working Paper 14910, April 2009.

Feyrer, James. "Distance, Trade, and Income – The 1967 to 1975 Closing of the Suez Canal as a Natural Experiment", NBER Working Paper, September 2009

Fratianni, M. 2007. The gravity equation in international trade. *Handbook of international trade*, Oxford University Press, 2nd edition.

Frankel, J., Stein E. and Wei S., (1997), *Regional Trading Blocs in the World Economy*, Institute of International Economics, Washington D.C., October

Hamilton, Carl B. and Alan L. Winters (1992), 'Trade with Eastern Europe', *Economic Policy*, April.

Helpman, E (1999), 'The structure of foreign trade', *The Journal of Economic Perspectives*, Vol. 13, Issue 2, pages 121–44.

Hummels, H, Ishii, J and Yi, K (2001), 'The nature and growth of vertical specialization in world trade', *Journal of International Economics*, Vol. 54, pages 75–96.

Im, K S, Pesaran, M H and Shin, Y (1997), 'Testing for unit roots in heterogeneous panels', revised version of University of Cambridge, DAE Working Paper No. 9526.

Im, K S, Pesaran, M H and Smith, R (1996), 'Dynamic linear models for heterogeneous panel', in Matyas, L and Sevestre, P (eds), *The Econometrics of Panel Data*, Kluwer Academic Publishers.

INSTAT. (2015). "Tregtia e jashtme e mallrave 2010-2014".

INSTAT. (2010). "Tregtia e jashtme e mallrave 2005-2009".

Feyrer, James. "Trade and Income – Exploiting Time Series in Geography," NBER Working Paper 14910, April 2009.

Linnemann, H., 1966. "An Econometric Study of International Trade Flows". Amsterdam: NorthHollan

